

---

Pse mu gratë janë duke u kthyer në islam? .....	3
Shembulli më i lartë.....	6
Kush e blenë gjuhën e kritikuesit? .....	7
Përshkrimi i Ditës së Gjykimit .....	13
Madhërimi i All-llahut.....	18
Në prag të pushimeve verore .....	27
Cilësitë e gjykatësit në islam .....	33
Mësime nga surja El-Fatiha.....	36
Qypi me lira .....	40
Sukseset dhe arritjet e grave të para muslimane .....	41
Përzjerja mes burrave dhe grave.....	44
Gratë dhe urdhërimi për mirë dhe ndalimi i të keqes .....	49
Imam Ibën Shihab Ez Zuhri .....	52
Salih ibën Abdul Aziz Alu Shejh .....	53
Imam Hammad ibën Zejd El Ezdi .....	54
Ibrahim ibën Ed'hemi .....	56
Obliqueshmëria e përvetësimit të shkencës së hadithit .....	60
24. Këshilla.....	62

## Parapagimi për revistën

Ofrojmë mundësinë që të parapaguheni me parapagim vjetor në revistën Albislam. Parapagimi kushton gjithsej **10 euro** (dhjetë) për Europë, (përfshirë edhe Shqipërinë, Kosovën, Turqinë dhe ish republikat Jugosllave) dhe vetëm **310 denarë** për parapaguesit nga Maqedonia. Me këtë parapagim brenda një viti juve ju dërgojmë 12 numra të revistës, prej numrit aktual kur ju parapaguheni. Në këtë çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare për dërgim të thjeshtë.

Për parapagim mjafton që të dërgoni pajtimin tuaj me emrin dhe adresën e plotë në:

email: [albislam@albislam.com](mailto:albislam@albislam.com)

sms: +389 70 445 725

fax: +389 2 3290 408

tel: +389 2 3290 408 (çdo ditë, përveç të xhumasë dhe të dielës, prej 9 deri 16)

ose me postë në: rr.386 nr.11, Q.T. Mavrovka lok.44, 1000 Shkup, Maqedoni

---

edicion i botuar / viti i dytë / nr: 24

[www.albislam.com](http://www.albislam.com)

redaksia: Ramadan Ramadani (kryeredaktor)

[albislam@albislam.com](mailto:albislam@albislam.com)

Agim Bekiri (ndihmës kryeredaktor) str: 386 no: 11 lokal: 44, 1000 Shkup

Bekir Halimi, Talha Kurtishi, fax: +389 2 3290 408

Alajdin Idriz, Fatmir Zaimi, Ali Shabani

Del në fillim të muajit, kalendari i hixhretit, takvimi i Türkiye Diyanet Vakfi. Numri i ardhshëm: 06 08 2005

Boton: NUN-R DOOEL

Xhiorlogaria: 300000001759616 Komercijalna Banka A.D.- Skopje (denar)

Xhiorlogaria: 0270100209184 Komercijalna Banka A.D.- Skopje (euro)

rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T. : KOBSSMK2X

IBAN MK07300701002091869

Numri tatimor: 4030003487017

ISSN: 1409-6250

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2.

Shtypur në: Cetus Print DOOEL-Shkup

## Pse mu gratë janë duke u kthyer në islam?

Në një kohë kur islami është i përballur me ashpërsinë e mediave veçanërisht kur statusi i grave në islam diskutohet, mund të duket e habitshme të mësohet se islami është feja më në rritje në botë dhe madje më ironike është që statistikisht tregojnë që maxhoranca e të konvertuarve (në fenë islame) janë gra.

Statusi i grave në shoqëri nuk është një çështje e re e as e vendosur plotësisht dhe ku islami përmendet, për shumë vetë termi “grua muslimane” krijon imazhet e nënave të lodhura të lidhura në zingjir pas tavolinës, “viktima” të shtypura të indoktrinimit, të tërbuara për tu evropianizuar dhe kështu me radhë. Të tjerët flasin gjatë për të shpjeguar hixhabin si një pengesë, duke e turbulluar mendjen dhe duke komentuar që femrat e konvertuara ose janë të laratrushë, të trasha apo tradhtarë të gjinisë së tyre. Unë i refuzoi të tilla akuza dhe i ofroi atyre këtë pyetje: “Pse ka kaq shumë gra të cilat kanë lindur dhe janë rritur në ashtu quajturën shoqëri të “civilizuar” të Evropës dhe Amerikës, me dëshirë janë duke refuzuar “lirinë” dhe “pavarësinë” për të pranuar një fe që gjoja i shtyp ato dhe e cila është gjerësisht e supozuar se është paragjykuese ndaj tyre?”

Si një e krishtere e konvertuar në islam, Unë vetëm të prezantoi eksperiencën time personale dhe arsyet për refuzimin e “lirisë” që gratë thonë se kanë në këtë shoqëri në favor të fesë së vetme që me të vërtetë çlirojnë gratë nga të dhënit në një status dhe

pozicioni i cili është tërësisht unik kur krahasohet me atë që palët jo-muslimane kanë.

Përpara se të bëhesha muslimane, unë kisha tendenca të forta feministe dhe kam njohur që ku gratë viheshin në pyetje, shumë zvarritje ndodhnin, ende pa qenë e aftë për ta parë atë në hartën shoqërore. Problemi ishte duke u bërë i ri “çështjet e grave” u ngritën pa u zgjidhur ato të mëparshmet në një mënyrë të kënaqshme. Si shumë gra të cilat ndaj të njëjtin nivel me mua. Unë do ta akuzoja islamin si një fe seksiste, diskriminuese, shtypëse dhe duke i dhënë burrave më shumë privilegje. Të gjitha këto vinin nga një person i cili nuk ka ditur për islamin, një i cili ka qenë i verbër dhe në injorancë (ndaj kësaj feje) dhe i kishte pranuar këtë përkufizim të shpërfytyruar të islamin.

Megjithatë, për kundër kritikimit tim të islamit, për brenda unë nuk isha e kënaqur me vetë statusin tim si një grua në këtë shoqëri. Më dukej mua që shoqëria do t'i përkufizonte termat si “liri” dhe “çlirim” dhe pastaj këto përkufizime u pranonin nga gratë pa u përpjekur për t'i vënë në pyetje ose për t'i përballur ato. Kjo ishte një kontradiktë e madhe midis asaj çfarë grave i është treguar në teori dhe çfarë aktualisht ndodh në praktikë.

Sa më shumë që të meditoja, unë ndjeja një zbrazëti të madhe. Unë isha me ngadalë duke filluar të arrija një etapë-pakënaqësia ime me vetë shoqërinë. Çdo gjë dukej se po degjenerohej mbrapsht, për kundër të

gjitha thirrjeve që ishin duke u përhapur në 1990, sikur kjo dekadë do të ishte dekada e suksesit dhe prosperitetit. Diçka vitale dukej se mungonte në jetën time dhe asgjë nuk do ta mbushte këtë boshllëk. Të qënurit një e krishterë nuk bëri asgjë për mua dhe unë fillova ta merrja në pyetje autenticitetin e vetëm të përkujtuarit të Zotit vetëm në një ditë, të dielave! Ashtu siç ndodhi edhe me shumë të krishterë të tjerë, u isha pështjellur nga hipokrizia e Kishës dhe isha duke u bërë e shqetësuar me konceptin e Trinitetit dhe hyznizimin e Jezusit. Si rrjedhim, unë fillova të shikoja në islam. Së pari unë isha duke u interesuar në shikimin e atyre çështjeve të cilat veçanërisht trajtonin gratë. Unë isha e habitur. Çfarë lexova dhe mësova për veten time më tregoj shumë për veten time si një grua dhe gjithashtu rreth asaj se ku mbështetet shtypja ndaj grave, në çdo sistem tjetër dhe mënyrë jetese jashtë islamit. Grave muslimane ju janë dhënë të drejtat e tyre në çdo aspekt me përkufizimin e rolit të tyre në shoqërinë e tyre, ashtu siç e kanë edhe burrat, pa padrejtësira ndaj asnjërit prej tyre.

Ashtu siç Allahu thotë: “Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtarë, të tillët hyjnë në xhennet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie”. [el-Nisa:124]

Kështu pasi i hoqa keqkuptimet e mija rreth statusit të vërtetë të gruas në islam, unë tani e hodha shikimin më tutje. Unë dëshiroja të gjeja atë gjënë që do të mbushte boshllëkun në jetën time. Vëmendja ime ju drejtua besimeve dhe praktikave të islamit. Ishte vetëm pas vendosjes së themeleve, që unë do të filloja të kuptoja ku të kthehesha dhe kë të vija prioritetet. Këto janë shpesh zona që kanë shumë pak vëmendje ose kundërshtim në shoqëri dhe kur studiova besimin islam, u bë e qartë pse ky është rasti, kaq i prerë, pa gabime dhe gjerësisht i

kuptueshëm me detaje që nuk mund të gjenden askund tjetër.

Themeli i besimit islam është teuhidi i cili është një mesazh i thjeshtë “La ilahe ill-Allah”. Është njohja që Allahu i vetëm e meriton të adhurohet dhe pastaj drejtimi i të gjitha adhurimeve vetëm Atij, rrënja e besimit e cila godet të gjitha adhurimet false dhe është ajo prej ku secili person i cili dëshiron seriozisht të studiojë për islamin, duhet të fillojë.

Deri kur arrita në këtë pikë unë isha të takohesha me gra muslimane që e praktikonin fenë dhe nuk imagjinohej se sa e sigurve u ndjeva dhe e mirëpritur në shoqërinë e tyre. Kishte një sens qetësie dhe thjeshtësie midis tyre dhe unë dëshiroja ta ndaja me to. Këto motra, unë nuk i shikoja si shoqe, por si këshilltare dhe mbështetëse gjithashtu dhe bukuria e shoqërisë së tyre ishte që secili ishte i lidhur për të njëjtën arsye, për ta ndihmuar njëri-tjetrin në adhurimin e Allahut. Kjo është çfarë i bashkoi zemrat e tyre së bashku.

Allahu thotë: “Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzosh gjithë ata që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë”. [el-Enfal-63]

Elhamdulillah, e kam pranuar islamin me dëshirë.

Përmes leximit, kërkimit dhe pjesëmarrjes në ligjërata, unë kam arritur ta njoh Zotin tim. Unë jam njohur me Emrat (Esma) dhe Atributet (Sifatet) e Tij të bukur dhe perfekte. Kjo më ka ndihmuar shumë për të kuptuar tërë fenë. Për të ditur për shembull që midis Emrave të Allahut është që Ai është më i Urti (el-Hakim) dhe më i drejti (El-Adl) dhe si rezultat Ai urdhëron vetëm atë që është e urtë dhe e drejtë, kjo do të jetë si

mbështetje për një person sesa të kërkojë justifikime për ligjet e Allahut ose të fillojë të dyshojë rreth drejtësisë së ligjeve të Allahut. Tani, elhamdulillah, e kuptoi më mirë pse disa dijetarë musliman e theksojnë aq shumë që muslimanët duhet të mësojnë rreth Emrave dhe Atributeve të Allahut, përpara se të fillojnë të arsyetojnë me ligjet e Allahut. Nëse unë do të isha bazuar tek qëndrimi se "Islami jep trajtimin më të mirë për gratë" dhe ta kisha bërë këtë si arsyen time për të hyrë në islam atëherë besimi im herët apo vonë do të vihej përballë disa ligjeve që janë të urdhëruara nga Allahu por nuk mund të kuptohet në mënyrë racionale dhe logjike ose të shikohet ndonjë urtësi prapa tyre. Sikur të mos i kisha studiuar themelet e besimit, të quajtur Teuhid dhe të mos e kisha parë sesi Allahu e përshkruan Vetën e Tij në Librin e Tij, ndoshta unë do të kisha qenë ende në errësirë. Dhe të gjitha falënderimet

dhe lavdërimet i takojnë Allahut i cili më udhëzoi tek e vërteta, është sikurse Ai ka thënë: "All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë". [el-Maide:16]

Arsyeja pse gratë janë duke u kthyer në islam duhet patjetër të ketë të bëjë me nderin që islami i jep atyre dhe barazinë me të cilën i trajton njerëzit, jo vetëm në termat e gjinive por gjithashtu në tremat e racave, nacionaliteteve, klasave etj... Megjithatë, arsyeja mbizotëruese pse unë dhe shumë si puna ime janë tërhequr nga islami është sepse islami i përgjigjet pyetjeve më të rëndësishme për të cilat gjithmonë kam pyetur: "Pse jam unë në këtë botë?" Kështu unë e kapërceva pengesën (paragjykimet) dhe pashë se çfarë ka në anën tjetër... elhamdulillah, unë zgjodha islamin.

Hanife Ashavi  
Marrë nga: Dava ila Allah vol. 1 nr. 3  
Përktheu: Ammar Ardit Kraja  
24.6.2005l

## Shembulli më i lartë

All-llahu i Madhërishtëm thotë: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërbimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.” [Ahzab: 21].

Musliman të nderuar! All-llahu na krijoi dhe na formësoi, e Ai nuk na lenë të humbur e pa udhëzim, përkundrazi Ai është që e dërgoi të dërguarin e tij - Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, me udhëzim dhe fe të qartë, për të na nxjerrë prej errësirave në dritë, prej errësirave të kufirit dhe mëkateve, në dritën e besimit dhe veprave të mira. Me këtë All-llahu e tregon kujdesin që Ai e ka për robërit e Tij.

Ajo që duhet të dimë është se feja islame s’është fe e fjalëve boshe dhe sterile, por fe e punës dhe aktivitetit, fe që na nxitë që atë që e themi ta praktikojmë. Në natyrën njerëzore është e ngulitur që mos ta dëgjojnë atë njeri i cili flet, mirëpo nuk e praktikon atë që vet e flet. Bile kjo cilësi shkakton neveri tek njerëzit. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kur i thërriste njerëzit për një vepër, ishte i pari që e vepronte, e kur i ndalonte nga një vepër, ishte i pari që largohej prej saj. Ai është shembull i vërtetë se si muslimanët duhet të veprojnë.

Ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është shembull në adhurimin e All-llahut, është shembull në jetën private dhe shoqërore, është shembull se si duhet të sillemi me familjen dhe të afërmit tanë, është shembull se si duhet të

sillemi me shokët dhe popullin tonë, është shembull se çka duhet të synojmë dhe për çka duhet të luftojmë.

Prandaj All-llahu e begatoi me thirrje të beqetshme, e begatoi me pasues të sinqertë dhe shokë të vërtetë, të cilët e pasonin shembullin e tij të lartë. Për vetëm 23 vjet, aq sa zgjati misioni i tij, arriti që të bëjë ndryshime rrënjësore në shoqërinë njerëzore.

Musliman të nderuar! Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është mësuesi ynë dhe mësuesi i mbarë njerëzimit, shembulli ynë se si duhet të veprojmë. Atë All-llahu e bëri shkak për të na udhëzuar në rrugën e drejtë.

Prandaj ne e kemi obligim që të lexojmë për jetën e këtij njeriu fisnik dhe të urtë, që ta njohim atë dhe cilësitë e tija, në mënyrë që ai të jetë shembulli ynë. Ai dhe vetëm ai është shembull që meriton të pasohet, e asnjë njeri tjetër. Këtë na e obligon All-llahu fuqiptotë.

Ja se çka thotë All-llahu i Lartësuar: “Thuaj: “Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë.” [Ali Imran: 31].

Nuk është dashuria ndaj All-llahut me pretendime dhe fjalë boshe, po me punë dhe vepër, edhe atë ajo vepër duhet të jetë ashtu si na ka mësuar! Dërguari i Tij, e jo si të na kujtohet neve. Hasan el-Basri, rahimehull-llah, në lidhje me këtë ajet thotë: “Njerëzit pretendonin se e duan All-llahun, e All-llahu i sprovoi me këtë ajet.”

Obligimi jonë ndaj Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është:

1. Ta besojmë atë si Pejgamber, pas të cilit nuk do të ketë Pejgamber tjetër.
2. Ta duam atë më shumë se vetveten tonë dhe më shumë se çdo krijesë tjetër.
3. Ta njohim historinë e tij dhe sunnetin e tij.
4. Ta kemi atë shembull të cilin e pasojmë, imam pas të cilit shkojmë, në të gjitha aspektet e jetës sonë, sepse këtë e kemi obligim nga Zoti, dhe sepse në këtë mënyrë do të jemi në rrugën e drejtë.
5. T'i çojmë në vend urdhrat e tij dhe të largohemi nga ndalesat e tij.

6. T'ua transmetojmë njerëzve diturinë që na dha ai, t'u tregojmë për cilësitë e mira të tij, t'i kundërshtojmë shpifjet dhe sharjet që ia bëjnë atij dhe sunnetit të tij.

7. T'i kundërshtojmë bidatet që i kanë shpikur ata që janë larguar nga sunneti i tij, dhe t'ua sqarojmë njerëzve se kjo fe është e përsosur, s'ka nevojë për shtim e as për pakësim.

Ai që i plotëson këto, bi idhnil-lah do të jetë prej pasuesve të tij, në ditën e gjykimit do të pijë nga Keutheri i tij dhe do të kënaqet me takimin dhe ndërmjetësimin e tij. All-lahu na i mundësoftë të gjitha këto.

Omer Islami,  
10.6.2005

## Kush e blenë gjuhën e kritikuesit?

Këta janë disa rreshta që burojnë nga ndjenja e dëlirësisë dhe sinqeritetit. Është ky aksion i meremetimit të asaj që ka filluar të ndryshket në konstruktin e terbijes. Nëse do, thuaj se këto janë pëshpëritje vëllazërore për ti shëruar zemrat e sëmura. Apo thuaj se këto janë fjalë të guximshme për demaskimin e pretendentëve.

I shkrova kur fillova të dëgjoj disa zëra të vrazhdët që i shqetësojnë veshët e thirrësve aktivë, që edhe ashtu janë mjaftë të shqetësuar. I kufizojnë lëvizjet e tyre duke i përçmuar dhe ofenduar, ndërsa ambiciet e tyre orvaten ti likuidojnë me kamën e helmuar të fjalëve sharëse. Këta zëra nuk vijnë nga armiku i haptë apo nga mynafiku i njohur. Këta janë zëra të njerëzve që së bashku me të mirët shtyhen me supet e tyre dhe me ta qëndrojnë në të njëjtin istikam, në atë të shërbimit të fesë.

Mirëpo këta tejkalan kufijtë në padrejtësi ndaj vëllezërve të tyre dhe i goditën me shigjetat e tyre të drejtuara gjithandej. Pretendojnë se në çdo gjë ia qëllojnë dhe se e vërteta është nën çallmat e tyre, andaj të gjerën e ngushtuan shumë. Allahut orvaten ti afrohen - me injorancë gjithsesi - duke i shqetësuar vëllezërit e vet duke menduar se kjo ua ngritë autoritetin tek Allahu. Sikur të mos e kishin dëgjuar fjalën e të Dërguarit: "Allahu e pranon vetëm të bukurën." [1]

• Kush e blen gjuhën e kritikuesit dhe e lidhë me rrip?!

Arabët në kohën e injorancës i ndëshkonin poetët ofendues duke ua lidhur gjuhën me rrip të lëkurës, ose u bënin atyre ndonjë të mirë ashtu që e detyronin që të ndalej nga sharjet dhe ofendimet, me një fjalë sikur të ia kishin lidhur gjuhën me atë veprim. Kur erdhi Islami, i Dërguari e aprovoi këtë vep-

rim me rastin e shpërndarjes së presë së luftës së Hunejnit kur tha: “Shkurtojani këtij gjuhën,” dtth. heshteni me dhurata.

Umer b. Hatabi e vazhdoi këtë traditë në rastin e Hutaj’es [2] i cili filloi ta ofendojë pa masë Zuburkan b. Bedër Et-Temimiun, Allahu qoftë i kënaqur me të, me c’rast e shau shumë, por Umeri mendoi se ajo është lëvdatë derisa nuk e pyeti Hassan b. Thabitin se a është duke e sharë apo lavdëruar, e ai i tha: “O prijës i besimdrejtëve, jo që e ka sharë por e ka sakatuar me fjalët:

Lej gjërat e larta, mos udhëto pas tyre,

Dhe rri ulur se ti je ai që ushqehesh dhe vishesh.”

Me këtë rast Umeri e burgosi në Medine, por Hutaj’eh iu lut me fjalët:

Çfarë do të thuash për disa zogj të sapoçelur

Të mbetur vetëm, pa ujë e pa bimë,

Atë që i ushqente e ke futur në një gropë të errët

Andaj fal, mbi ty qoftë shpëtimi i Allahut, o Umer.[3]

Atëherë Umeri e nxori nga burgu dhe ia ndaloi që ti ofendonte dhe fyente njerëzit me poezitë e tij, por ai i ankua se nëse nuk merrem me poezi, familja do të më vdesin nga uria. Umeri me këtë rast, mbrojti nderin e myslimanëve nga ofendimet e këtij me tremijë dërhëm.[4] Për këtë mori besën prej tij dhe ai nuk ofendoi askënd me poezinë e tij derisa nuk vdiq Umeri.

Kush do të mbrojë sot nderin e dijetarëve dhe thirrësve nga ofenduesi i cili është barrikaduar në shpellën e pasivëve që fytyrat e tyre i kanë shmangur nga dhimbjet e umetit dhe thonë: Sa i mirë ky ujë i ftohtë për tu freskuar dhe për të pirë. Sa herë që kalon kah një grup i thirrësve, ai e zgjedhë viktimën e vet e gjuan me një raketë etiketash të hidhura që lansohet nga goja e tij me shpej-

tësi të madhe sikur del shigjeta matanë ca-kut, pastaj e lë atë në mes të rrugës duke thënë: Largoni pengesën nga rruga sepse kjo është prej degëve të imanit. [5]

• Mes fshehjes së krimeve të mëkatarëve dhe “demaskimit” të thirrësve

Zemra pikëllohet dhe shpirti ngushtohet nga pamjet e një devotshmërie shume të zbehtë dhe të tejdukshme, i zoti i së cilës jeton në një rreth shumë të ngushtë të praktikimit formal të mësimave islame. Ai sillet vërdallë në këtë vorbull duke mos pasur rast që imani i tij të depërtojë thellë në zemrën e tij dhe të reflektojë me moral të lartë dhe sjellje të çiltër. Të këstillëve ua drejtoi i Dërguari, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thirrjen: “O ju që (pretendoni se) besuat me gjuhët tuaja, ndërsa imani akoma nuk ka depërtuar në zemrat tuaja, mos i përgojoni myslimanët dhe mos hulumtoni në të metat e tyre.” [6]

Njeriu nuk mundet pa u çuditur me Ebu Bekrin kur, sipas asaj që transmeton Abdu-rrezaku, thotë: “Sikur të mos gjeja asgjë për ta mbuluar vjedhësin, zinaxhiun dhe pirësin e alkoolit përveç petkut tim, do ta zhvishja atë e do ti mbuloja me të.” Ndoshta Ibën Hubejre e ka kuptuar mirë këtë thënie të Ebu Bekrit kur ka thënë: “Mundohu t’i mbulosh mëkatarët, sepse paraqitja e mëkateve të tyre është turp për të gjithë myslimanët, e më e rëndësishmja është mbulimi i turpit.” [7]

Një zemër e madhe dhe e mëshirshme si ajo e Ebu Bekrit kishte gjerësi të mjaftueshme për ti strehuar kriminelët, ndërsa në zemrat e disa njerëzve sot nuk ka vend madje as për sukseset e vëllezërve të tyre. Për këtë arsye ata nuk duan tjetër vetëm se të hulumtojnë për të zbuluar të metat e tyre. O Allah, sa çudi e madhe!

Sufjan b. Husajni ishte një herë duke ndenjnjur me ljas b. Muavijen. Në një moment



kaloi afër tyre një njeri, të cilin Sufjani filloi ta përmend për të keq. Ijasi e pyeti: A ke luftuar kundër bizantinëve? Ky i tha: Jo. E pyeti për së dyti: A ke luftuar kundër mongolëve? Ky u përgjigj: Jo. Me këtë rast Ijasi ia dha një leksion të cilin Sufjani nuk e harroi kurrë, me fjalët: Prej teje janë rehat bizantinët dhe mongolët, a nuk do ta lësh rehat vëllain tënd mysliman?! [8]

Edhe dijetari Abdurrahman Abdulhalik, Allahu e ruajt, i demaskon pretendimet e rreme me të cilat kohë të gjatë ngritin zërin disa, gjoja fetarë, duke nëpërkëmbur në këtë mënyrë nderin e thirrësve aktivë. Ai i demaskon ato me fjalën e tij: “Myslimanët vazhdimisht deri në ditët e sotme janë ballafaquar me dukurinë e paraqitjes së atyre të cilët pretendojnë se e ndihmojnë fenë dhe e flasin të vërtetën. Të këtillët i lënë rehat idhujtarët, të shfrenuarit, jobesimtarët dhe ata që promovojnë amorallitet, ndërsa lapsat dhe gjuhët e tyre i kanë angazhuar tek myslimanët. Madje ka prej tyre të atillë që nuk preokupohen me tjetër gjë përveçse me thirrësit në rrugën e Allahut, duke i kritikuar, sharë dhe etiketuar ata. Për disa arsye të këntilla - të cilat ata i shohin si kundërvajtje e ato në të vërtetë nuk janë kundërvajtje - ata e trajtojnë të lejuar nderin e thirrësve, e marrin nëpërkëmbë atë, hulumtojnë sekretet e tyre dhe nuk gjejnë tjetër “vepër të mirë” për të praktikuar përveç përçarjes së tyre, mbushjes së zemrave të njerëzve me urrejtje ndaj tyre dhe orvatjes për t’i larguar njerëzit prej tyre.” [9]

• A “për hir të Allahut” duhet të nëpërkëmbet nderi?!

Dukuria e vrasjes nga zjarri mik nuk është gjë e re, por rrënjët e saj shtrihen deri në kohët e hershme, kur ato i zbuloi muhadithi i këtij umeti Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, e u ngrit për t’i këshilluar ata të cilët i orientuan fokuset e tyre për të gjetur

lëshimet e vëllezërve të tyre, me ç’rast tha: “Dikush prej juve e vëren qimen në syrin e vëllait të vet ndërsa nuk e vëren trungun në syrin e vet.” [10]

Ndërsa Ibnul-Kajimin, Allahu e mëshiroftë, e përshkon ndjenja e çudisë dhe habitës nga pretendentët e devotshmërisë të cilët i zhveshën shpatat e fjalëve të tyre për të copëtuar mishin e vëllezërve duke mos i kursyer madje as të vdekurit. Ai thotë: “Ka shumë njerëz të cilët i sheh se u ruhen të këqijave dhe të ligave, ndërsa gjuha e tyre bën masakër në të gjallët dhe të vdekurit, ndërsa ai aspak nuk vret mendjen se çfarë flet.” [11]

Ibnul-Ethiri në librin e tij “El-Kamil” shënon ngjarjen e vrasjes së halifes së drejtë Uthman b. Affanit me ç’rast shënon: “... ndërsa Amër b. El-Hamak kërcëu mbi gjoksin e Uthmanit derisa akoma kishte frymën e fundit dhe e goditi me thikë nëntë herë, duke thënë: tri të parat janë për hir të Allahut, ndërsa gjashtë të fundit janë për shkak të urrejtjes që kam pasur në zemër ndaj tij. Pastaj deshën t’ia presin kokën por ndërhyjnë gruaja dhe shërbëtorja e Uthmanit duke klithur dhe ata e lanë...”

Thotë dijetari Muhamed Ahmed er-Rashid, Allahu e ruajt, duke komentuar këtë: “Kësisoj armiqtë e Islamit gjithnjë dëshirojnë që të këpusin kokën e xhematit (bashkësisë) dhe t’ia thyejnë brinjët organizimit të tij, ndërsa justifikimi është “për Allahun” si shpreh Ibën el-Hamak. Dhe me këtë klithje “për Allahun” u dëmtuan me mija e mija djem të rinj pjesëmarrës të këtij procesi të përmirësimit në të djeshmen e afërt, u ndaluan shumë njerëz, u zbuluan shumë sekrete dhe u mbushën shumë burgje. Sikur të ishin të sigurtë do të thoshin sikur tha Ibën el-Hamak: “... ndërsa gjashtë të fundit janë për shkak të urrejtjes që kam pasur në zemër ndaj tij.” [12] Kjo madje nuk dallon shumë prej praktikës së disave të cilët sot

llogariten se i takojnë lëvizjes së da'ves. Ndërsa pyetja vazhdon të mbetet: A ishte tërë ajo, vërtetë për Allahun?!

- Mos i harroni të mirat e njëri-tjetrit

Disa sëmundje të fshehta që burojnë nga epshi, zilia, edukata e mangët si dhe dija shumë modeste mund ta bëjë atë që vjen më vonë që të harrojë vlerat e më të hershmit në thirrje në rrugë të Allahut, urdhërim në të mirë dhe ndalim nga e keqja, kohën e kaluar në burgjet e zullumqarëve, këshillat që ia ka drejtuar mëkatarit, librin e dobishëm që e ka shpërndarë, madje edhe vetëm prezantimin e tij në aktivitetet e mirësisë për të rritur numrin e myslimanëve. Ajo që më së tepërmi i bren-gos zemrat e pastra besimtare dhe i irriton shpirtrat e qetësuar janë sjelljet e këqija dhe të pavend të atyre që pretendojnë se kanë dije dhe janë të mirë me rastin e gabimit të dijetari të njohur apo thirrësi të pranuar i cili e ka dëshmuar veten me kohën e gjatë të kaluar në aktivitetin islam. Me këtë rast ata e nëpërkëmbin nderin e tij, i shqyejnë të gjitha mbulesat përreth tij duke i shpallur të pavlefshme të gjitha vlerat e tij, kjo madje duke qenë se të këtyllët akoma nuk janë pjekur as në ide e as në mençuri. Sa e sa "shkurtabi-që" të këtyllë i hasim duke bërë padrejtësi e mizori, duke shpifur akuza kundër personaliteteve që janë simbole të da'ves dhe mendjes së ndritur të cilët për Allahun kanë sakrifikuar çdo gjë të vlefshme që kanë pasur në dorë: kohën, pasurinë dhe gjakun dhe hoqën dorë nga kënaqësitë e kësaj bote në kohën kur këta kritikues ziliqarë bënin gara rreth dynja-së dhe shpejtonin pas mjegullës së epsheve të tyre duke mos u brengosur për asgjë.

Mos ua teproni me qortime, mos paçi baba ju as babai juaj

Ose plotësoni atë që ata kanë plotësuar [13]

Të rinj që nga Kur'ani nuk kanë nxënë përmendësh më tepër se kaptinat e shkur-

tra, dije kanë pak ndërsa të kuptuar edhe më pak, shumë vonë e njohën Allahun, në anën tjetër mendojnë se ata dhe dijetarët plot përvojë të da'ves janë të barabartë. Ata nuk janë të vetëdijshëm se: "Nuk është i barabartë ai prej jush që sakrifikoi para çlirimit dhe luftoi, këta janë në pozita më të larta se ata që sakrifikuan dhe luftuan më pas." (Hadid: 10)

Sejid Kutbi e ka një shpjegim të bukur rreth kësaj pjese të ajetit kur thotë: "Ai që sakrifikon dhe lufton derisa akideja është e persekutuar, ndihmëtarët janë të paktë ndërsa në horizont nuk duket ndonjë shpresë, fuqi apo mirëqenie, nuk është sikur ai që sakrifikon dhe lufton derisa akideja është e siguruar, ndihmëtarët janë të shumtë ndërsa fitorja është e kapshme." [14]

- Metodologji selefite por pak kush kupton

Ku janë ata që pretendojnë se ia duan të mirën fesë, njëkohësisht duke hulumtuar gabimet e thirrësve që mezi presin të hasin në të metat e tyre, ku janë të tillët që të dëgjojnë atë që ka thënë Ibnul-Kajimi duke sqaruar metodologjinë për vlerësimin e njerëzve, me ç'rast thotë: "Prej rregullave të fesë dhe urtësisë është se ai person, të mirat e të cilit janë të shumta dhe të mëdha e që njëkohësisht ka dhënë kontribut të çmuar për Islam-in, atij mund ti mos merret parasysh ajo që i merret parasysh tjetrit dhe atij mund ti falet ajo që nuk mund ti falet tjetrit, sepse gabimi është ndyrësi, ndërsa uji kur arrin sasinë e madhe (kul-letejn) nuk ndotet, gjë që nuk është rasti me ujin e paktë i cili nuk duron as ndyrësinë më të vogël."

Këtë e dëshmon edhe fjala e të Dërguarit që i ka thënë Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të: "Ku e di ti, ndoshta Allahu i ka shikuar pjesëmarrësit e Bedrit dhe u ka thënë: Bëni ç'të doni se ua kam falur." [15] Kjo ishte arsyeja pse nuk e ekzekutoi personin i

cili kishte spiunuar në dëm të tij dhe të myslimanëve, me ç'rast kishte bërë krim të madh, por i Dërguari me këtë rast njoftoi se ai person kishte marrë pjesë në luftën e Bedrit. Prej kësaj kuptohet se të merituarit e ndëshkimit ekziston por arsyeja e mosekzekutimit është pjesëmarrja e atij personi në atë ngjarje të madhe, andaj ai gabim i madh u fal përballë veprave të mira që kishte bërë ai. [16]

Në këtë kontekst janë edhe disa fjalë që meritojnë të shkruhen me ngjyrë ari i ka përmendur Ibnul-Kajimi në librin e tij "l'lamul-muveki'in": "... Ai që ka sadopak njohuri në fe dhe realitet e di padyshim se njeriu i madh i cili në Islam ka kaluar kohë dhe ka lënë gjurmë të mira, i cili në mesin e myslimanëve gëzon autoritet, mundet që i këtillet të gabojë dhe të ketë ndonjë të metë, porse ato i falen, madje mund edhe ta shpërblehet për mundin që ka dhënë, andaj nuk lejohet assesi që ato të meta ti ekspozohen apo të diskutohet dhe cenohet autoriteti i tij në zemrat e myslimanëve." [17]

Para tij e ka sqaruar shumë mirë këtë metodologji selefite Seid b. El-Musejjebi, Allahu e mëshiroftë, duke potencuar nevojën e respektimit të atyre që kanë paraprirë me vepra të mira: "Nuk ka asnjë fisnik, as dijetar, as njeri i mirë e që nuk ka të meta, porse disa njerëzve nuk bën tu përmenden të metat. Ai që ka të mira më shumë se të meta, të metat i falen për shkak të të mirave." [18]

Paramendoje Muhamed b. Sirinin duke të tërhequr në një kënd të xhamisë dhe duke të këshilluar me pëshpëritje: "Do ti bëje padrejtësi vëllait tënd po që se ia përmend atë më të keqen që di për të dhe ia fsheh të mirat" pastaj citon: "...e njerëzve mos ua leni mangut atë që u takon." (Shuara: 183) [19]

Dijetari dhe reformatori i njohur Muhamed b. Abdul-Vehabi ka pasur përjetime të pakëndshme me këtë lloj të armiqve të sukse-

sit që me padurim i presin gabimet dhe rrëshqitjet e të tjerëve, andaj u ka thënë me fjalë shumë të qarta: "...kur të verifikoni se vërtetë kam gabuar shpallenit atë, por nuk i hidhni në ujë të gjitha të mirat për shkak të një gabimi, apo njëqind apo dyqind gabimeve. Unë nuk e konsideroj veten se jam i pagabueshëm." [20]

Sa shumë e prish dëlirësinë dhe pastërtinë e mirësjelljes mënyra e vrazhdët e shpalljes së të vërtetës, mohimit të së keqes dhe refuzimit të gabimit! Nuk e di, të këtillet a kanë pasur rast të dëgjojnë (apo lexojnë) këshillën që Imam Shafiu i ka dhënë shokut dhe nxënësit të vet El-Muzeniut, kur ky i fundit në një rast pat thënë: "Filani është gënjeshtar i madh." Shafiu i tha: "O Ibrahim, vishi pak shprehjet tua me petka të mirësjelljes. Mos thuaj: gënjeshtar i madh, por thuaj: hadithi (transmetimi dhe fjala) i tij nuk është i pranueshëm." [21] Sikur të ishte Imam Shafiu që ti edukonte këta të ngutshmit të cilët zanat të vetin e kanë bërë gabimin e të tjerëve, që nuk perfeksionojnë tjetër pos kritikave dhe etiketimet që u bëjnë vëllezërve të tyre thirrës, dhe me këtë mburren në ndejat e pëshpëritjes dhe çnderimit.

- Mos u bën pjesëmarrës në derdhjen e gjakut të da'ves

Sa e sa artikuj të vërtetë janë shkruar, prapa të cilëve qëndron e pavërteta dhe me to janë larguar me dhjetëra dhe qindra njerëz nga të dëgjuarit e të vërtetës prej filanit.

Sa e sa artikuj të dëmshëm janë shkruar dhe i kanë dekurajuar njerëzit nga librat e autorëve të dëshmuar, e me këtë i kanë privuar nga një hajr i madh.

Sa e sa herë janë mbyllur dyer të hairit si pasojë e gjesteve dhe fjalëve tradhtarë dhe planeve dashakeqe që janë thurur në errësirën e natës.

Sa e sa projekte të da'ves janë ndalur për shkak të ndonjë etikete të pamatur, të lansuar nga arsenali i ndonjë adoleshenti në llogari të bartësve të projektit.

Sa e sa duar të liga janë zgjatur padrejtësisht dhe e kanë varrosur aktivitetin islam për së gjalli qysh në djep.

Sa e sa pranga e pengesa janë vendosur për shkak të shkrimit të lapsit të dikujt, që gjithsesi nuk ka qenë për Allahun.

Dëgjoje thënien e tabi'ut të besueshëm e besnik Ebu Ma'bed El-Xhuhenij, Allahu e mëshiroftë, për ta kuptuar më mirë atë që them: Në një tubim mësimi që u mbajt me qëllim të vetëdijesimit dhe aftësimin të gjeneratës së re të burrave të shtetit islam, që do të sanonin pasojat e fitnes, ligjëroi edhe Abdullah b. Akim (Ebu Ma'bed El-Xhuhenij) dhe me një fjali e pasqyroi tërë përvojën e njerëzve të sinqertë: "Nuk do të marr pjesë në asnjë komplot për derdhjen e gjakut të halifes pas Uthmanit."

Kjo vërtetë ishte një fjalë shumë e rëndë dhe prekëse... Të gjithë u befasuan nga kjo thënie. Të gjithë të pranishmit filluan të shkëmbejnë shikime duke u çuditur çka është duke folur ky njeri i mirë. Çfarë mëkati ka bërë ky plak i dëlirë dhe i pafajshëm i cili kurrë nuk e ka ngritur shpatën e tij kundër Uthmanit? Çfarë ka që e akuzon veten me akuzë të cilën nuk e meriton? Njëri më guximtar e pyeti: "O Ebu Ma'bed, a ke marrë pjesë në atë komplot?" Ky u përgjigj: "Mendoj se të përmendurit e të këqijave të njeriut është pjesëmarrje në komplot për derdhjen e gjakut të tij."

Ai e akuzon veten dhe ia ngarkon një pjesë të përgjegjësisë për gjakun e derdhur të Uthmanit, ngase u bind se ajo që ai kishte menduar se është e vërtetë, u keqpërdor nga një grup keqbërësish deri në atë masë sa që e mbytën halifen Uthman, Allahu qoftë i kënaqur me të. [22]

Shpresoj se e ke kuptuar mesazhin: Mos bashkëvepro për derdhjen e gjakut të da'ves.

Mos bashkëvepro për derdhjen e gjakut të da'ves me fjalë të këqija dhe akuza kundër vëllezërve tu prej të cilave ata janë të pafajshëm.

Mos bashkëvepro për derdhjen e gjakut të da'ves duke i hulmtuar gabimet dhe lëshimet e thirrësve më qëllim të poshtërimit të tyre, vetëm pse nuk pajtohesh me ta në ndonjë detaj.

Mos bashkëvepro për derdhjen e gjakut të da'ves me përgojim apo shpifje në llogari të atyre që i prijnë asaj.

Mos bashkëvepro për derdhjen e gjakut të da'ves duke u dhënë armiqve rast që të përçajnë radhët e myslimanëve.

Mos bashkëvepro për derdhjen e gjakut të da'ves duke e spiunuar vëllain tënd tek zulumqarët apo kundërshtarët e paskrupullt.

- Në vend të përfundimit, vëlla i nderuar

Nëse je prej atyre që i ka mashtruar shejtani ndonjëherë dhe e ke shpërfillur nderin e dijetarëve të devotshëm dhe thirrësve aktivë, strehohu në një xhami të vjetër me zemrën tënde, qaj për mëkatin tënd dhe shpalle teuben tënde të sinqertë pas së cilës nuk do të devijosh kurrë dhe përsërit me përuļje dhe devotshmëri: "O Zoti ynë, na fal neve dhe vëllezërit tanë që na paraprinë me iman dhe në zemrat tona mos le urrejtje për ata që besojnë. Ti o Zoti ynë je i butë dhe i mëshirshëm." (Hashër: 10)

Ndërsa nëse je prej atyre që padrejtësisht e kanë akuzuar dhe i kanë shpifur mos u ndal as për një moment, sepse misioni yt ka shumë nevojë për atë moment, por largohu prej tij duke thënë me zë të dëgjueshëm: "Nëse ti e zgjatë dorën tënde për të më vrarë mua, unë nuk do ta zgjas dorën time për të vrarë ty. Unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve." (Maide: 28)

Mut'ib b. Ferhan El-Kahtani

Përktheu: Ekrem Avdiu  
17.6.2005

#### Shënimet:

[1] Pjesë e hadithit që e shënon Ahmedi në Musned dhe Buhariu e Muslimi në Sahihët e tyre. Shih Sahihul-xhami'is-saghir, 2044, 6152.

[2] Hutaj'eh është Xheruel b. Eus El-Absij i vdekur në vitin 45 sipas hixhretit. Ishte poet i njohur që shquhej për kritikë dhe sharje, saqë thuhet se me poezitë e tij i ka sharë nënën, babin, axhën, dajën dhe veten e vet. Shih: El-bidaje ven-nihajeh, 8/100.

[3] Xhavahirul-edeb, Ahmed el-Hashimij, fq. 395.

[4] Marrë nga libri: "Klasifikimi i njerëzve mes paragjyqimeve dhe bindjes" nga Bekër Ebu Zejd, me pak ndryshim.

[5] Burimi i njëjtë.

[6] Shënon Ahmedi dhe Ebu Davudi, ndërsa El-Albani konsideron se është sahih. Shih: "Sahihul-xhami'is-saghir", hadithi 3078 dhe 7984.

[7] Thënia e Ebu Bekrit dhe ajo e Ibën Hubejres është marrë nga libri "Metodologjia e ehhus-sunetit për vlerësimin e autorëve dhe librave të tyre" të Ahmed b. Abdurrahman Es-Savejanit.

[8] "Metodologjia e Ehhus-sunetit në kritikë dhe gjykim për të tjerët" nga Hisham Ismail Es-Sini, fq. 59.

[9] "Shëmbëlltyrat e mëdha mes shkatërrimit dhe lulëzimit", të autorit Muhammed Musa Sherif, fq. 66.

[10] Thotë El-Albani: ky transmetim është autentik nga Ebu Hurejra. Shih "Sahihul-edebil-mufred", hadithi 460 dhe 592.

[11] "El-xhevabul-kafi", fq. 120.

[12] "El-Avaik", të autorit Muhammed Er-Rashid, fq. 268

[13] Pjesë e poezisë së Hutaj'es, rast i rrallë ku ai lavdëron, "El-bidajeh ven-nihajeh", 8/102.

[14] "Fi dhilalil-Kur'an", 6/3484.

[15] Muslimi: 4550; Buhariu: 2785.

[16] El-Avaik, M. A. Er-Rashid, fq. 139.

[17] "Kava'id fit-te'amuli me'al-'ulema", Abdurrahman El-Luvejhik, fq. 133.

[18] Burimi i njëjtë, fq. 132.

[19] "Insaf ehlis-sunneh", Muhamed Salih el-Alij, fq. 89.

[20] Burimi paraprak, fq. 90.

[21] "Menhexh ehlis-sunneh fi takvimir-rixhal", Ahmed Es-Suvejjan, fq. 40.

[22] "El-Avaik", fq. 156.

## Përrshkrimi i Ditës së Gjykimit

Besimi në Ditën e Kiametit është një nga kushtet themelore të fesë së All-llahut, subhanehu ve teala. Gati nuk ekziston asnjë faqe në Kuran e cila nuk e sinjalizon apo nuk e përmend këtë ditë të madhe. Ky përkujtim i shpeshtë i kësaj dite në Kuran, rrjedh nga ajo se njerëzit e harrojnë atë Ditë si shkak i problemeve të tyre ditore të shumta.

Gjithashtu, All-llahu, subhanehu ve teala, dëshiroi të na përqendrojë vëmendjen në këtë ditë shumë të madhe, të frikshme e të tmerrshme, të trishtueshme dhe definitive për njerëzimin, ndaj edhe i frikëson robërit e Tij me atë Ditë, duke i përshkruar pikërisht ndodhitë e tmerrshme të asaj Dite.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "O ju njerëz, ruajuni dënimit nga Zoti juaj, sepse

dridhja pranë katastrofës së kiametit është një ullahtari e madhe. Atë ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjiri dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, po ata nuk janë të dehur, por dënimi i All-llahut është i ashpër." [Haxh: 1-2].

"Nëse ju mohoni, si do të mbroheni në një ditë që fëmijët do t'i bëjë pleq?" [Muzzemmil: 17].

"Kur dielli të jetë mbështjellur (dhe errësohet), Dhe kur yjet të kenë rënë (e shkapërderdhur), Dhe kur kodrat të kenë udhëtuar (e bërë pluhur në ajër), Dhe kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë, Dhe kur egërsirat të jenë bashkuar (tubuar). Dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakëruar, Dhe kur shpirtat të jenë bashkuar. Dhe kur të

pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, Për çfarë mëkati ato janë mbytur, Dhe kur fletushkat të jenë shpaluar, Dhe kur qielli të jetë hequr, Dhe kur xhehennemi të jetë ndezur fort, Dhe kur xhenneti të jetë afruar, Atëbotë njeriu do ta dijë se çka ka ofruar (të mirë ose të keqe)." [Tekvir: 1-14].

Vërtetë vëllezër, fakti se në Ditën e Kiametit ndodhin gjëra të jashtëzakonshme si çarja e qiellit, rënia e yjeve, vlimi i detërave, ndeshja e planetëve, copëtimi i Tokës, shkulja dhe fluturimi i kodrave, bën që egërsirat të bashkohen, që njerëzit të bëhen si flutura të shpërndara, që secila gjdhënese të braktis fëmijën e vet, që secila shtazënë të dështojë barrën e vet, njerëzit janë symavijosur dhe duken si të dehur, e fëmijëve nga trishitimi i asaj dite u thinjen flokët e bëhen pleq.

All-llahu, subhanehu ve teala, na ruajt nga trishtimi dhe llahtaria e kësaj dite dhe na mundësoftë mos ta arrijmë atë. Pas kiametit, qëndrimin në varr, dhe ndodhive të përmendura do të ngjajë ajo çka All-llahu, subhanehu ve teala, na informon. Israfilu me urdhrin e All-llahut xhel-leshanuhu do të fryjë në Sur (bori) herën e parë, me ç'rast do të vdes gjithë ç'ka në qiej dhe tokë, pos atyre që do All-llahu, subhanehu ve teala,

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur çka ka në qiej dhe çka ka në tokë, përveç atyre që do All-llahu (të mos vdesin), pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur qe, të gjithë ata të ngritur e presin (urdhrin e Zotit)." [Zumer: 68].

E siç pamë Israfilu urdhërohet për të dytën here të fryjë, me ç'rast u kthehet jeta të vdekurve. E kjo është Dita e ringjalljes, kur njerëzve u kthehen shpirtat dhe trupat e tyre sikur që ishin në jetën e kësaj bote.

E për këtë flasin edhe këto ajete: "Ditën që vrullshëm bëhet dridhja. Që pas saj pason tjetra." [Naziati: 6-7].

Përderisa besimtarët e dinë se All-llahu I ngjalli ata, jobesimtarët dhe munafikët do të thonë: "... Po kush na ngjalli (çoi) prej shtretërve tone?" (Ju thuhet): "Ja, kjo është ajo që e ka premtuar Mëshiruesi i Madh, e Pejgamberët e kanë thënë të vërtetën.""

Transmetohet nga Aishja, radijallahu anha, se I dërguari ka thënë: "Në Ditën e gjykimit njerëzit do të ringjallen të zbathur, të zhveshur dhe të pa bërë synet. Unë I thashë: "O I dërguari i All-llahut, e meshkujt dhe femrat bashkë, të shikojnë në njëri-tjetrin?" Tha: "Oj Aishe, gjendja (çështja) do të jetë aq e ashpër saqë askujt nuk i bie ndërmend ta shikojë tjetrin"

Tani, pas ringjallje dhe pas daljes nga varret të gjithë njerëzit do të tubohen në një vend. Thotë All-llahu, subhanehu ve teala: "(Kujto atyre) Ditën, kur do t'i tubojmë të devotshmit (si grigjën e kafshëve të etshme kah burimi)." [Merjem: 85-86].

Hashër është vendtubimi i të gjithë njerëzve në një vend të caktuar, ku do të presin derisa të gjykohen. E në këtë vend të pritjes njerëzit do t'i godas vështirësi e madhe.

Transmetohet se i Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Në Ditën e kiametit Dielli do t'u afrohet njerëzve, kështu që do të vijë në lagësi vetëm një milë, e njerëzit do të jenë në djersë në përshtatshmëri me veprat e tyre. Disa prej tyre do të jenë në djersë gjer te zokthat e këmbës, disa gjer në gjunjë, disa gjer në fyt, e disave do t'ua stërpikë gojën sikur të ishte I frenuar".

Vëllezër, a i keni parë njerëzit kur u ndodh ndonjë fatkeqësi se si kafshojnë gishtin tregues? E tregohet se atë ditë të pritjes së dhënies së gjykimit, njerëzit jo që do të kafshojnë gishtin tregues, jo që do të qajnë nga tmëri, por do ta gëlltisnin dorën e vet gjer tek bërryli, do ta rrjepin lëkurën e tyre, e pabesimtarët do të kërkojnë të mos kishin ekzistuar fare ose të

bëhen dhe, mu ashtu siç thotë I Lartësuar në Kuran: "Ne ua tërhoqëm juve (idhujtarëve) vërejtjen për një dënim të afërt, në ditën kur njeriu (besimtari) shikon se çka I kanë sjellë duart e veta, e jobesimtari thotë: "Ah, sa mire do të ishte për mua sikur të isha dhe ". [Nebe: 40].

Pas kësaj, kur çdo njeri do të vijë para Zotit të vet, do t'u prezantohen të gjithë veprat e tyre dhe vetë do ta lexojnë librin e veprave të tyre.

All-llahu thotë: "E kur të fryhet në sur një e fryme. Dhe të ngrihen toka e kodrat e t'i mëshojnë njëra-tjetrës me një të goditur. Në atë kohë ndodh e vërteta (kiameti). E qielli çahet, pse ai atë ditë është i raskapitur. Dhe engjëjt qëndrojnë në skajet (anët) e tij, e atë ditë tetë (engjëj) e bartin mbi vete Arshin e Zotit tënd. Atë ditë ju do të ekspozoheni (para Zotit), duke mos mbetur fshehtë asnjë sekret juaji." [Hakka: 13-18].

Transmetohet se I Dërguari ka thënë: "Secilit prej juve krijuesi do t'i drejtohet drejtpërdrejt (me të folur-pyetje) pa përkthyes. Do të shikojë nga ana e tij e djathtë, e nuk do të shihet tjetër gjë veçse veprat e tij (të mira). Pastaj do të shikojë nga ana e tij e majtë, e nuk do të shihet tjetër gjë veçse veprat e tij (të këqija). Do të shikojë para vetes e nuk do të shihet tjetër gjë veçse zjarrin (e Xhehenemit)para fytyrës së tij. Andaj, mbrohuni nga zjarri (I Xhehenemit) qoftë edhe me gjysmë hurme, e kush nuk e gjen këtë atëherë me fjalë të mirë."

Ndaj, padyshim se çdonjërit do t'i prezantohen veprat e tij, do t'i prezantohen me anë të librave ku tregohet se ç'kanë vepruar ata në jetën e kësaj bote. A i keni pare nxënësit dhe studentët me dëftesa dhe diploma me nota të mira se si u thonë të tjerëve, ja shikojeni suksesin tim? Ashtu edhe besimtarët, që libri i tyre është përplot me punë të mira, kur kthehen tek familjet e veta u thonë atyre, ja ky është libri im përplot me vepra të mira, lexojeni atë. E mëkatarët kur

do ta gjejnë librin e tyre përplot me mëkate, duke mos i lënë edhe imtësitat më të vogla do të thonë: "Ç'është puna me këtë libër, që s'le gjë të madhe apo të vogël pa e shkruar"

Nëse është njëri nga të shpëtuarit, nga ata që kthehen te familjet e tyre të gëzuar, atij i jepet libri nga ana e djathtë dhe All-llahu, subhanehu ve tealë, do t'ia falë të gjithë mëkatet dhe nuk do ta pyes detalisht. Pastaj do ta shpie në Xhenet dhe nuk do të jetë i ndëshkuar me zjarr. E atij, mëkatet e të cilit janë më të mëdha, libri do t'i jepet nga mbrapa dhe do të jetë i pyetur detajisht për çdo vepër që e ka bërë, të vogël ose të madhe.

All-llahu thotë: "O ti njeri, vërtet ti përpjekesh me një përpjekje të madhe që çon te Zoti yt, e atë (përpjekje) do ta gësh. E përse i përket atij që libri i vet i jepet nga e djathta, Ai do të llogaritet me një llogari të lehtë, Do të kthehet te familja e vet i gëzuar. E përse i përket atij që libri i vet i jepet pas shpinës, Ai do t'i ndjellë vetes shkatërrim, Dhe do të hyjë në zjarr të ndezur fort. Ai ka qenë i gëzuar në familjen e vet, Dhe ka menduar se nuk ka për t'u kthyer. Po, se, vërtet Zoti i tij gjithnjë e ka parë atë." [Inshikak: 6-15].

"Kujt t'i jepet libri i vet nga e djathta e tij, ai do të thotë: "O ju, qe, lexojeni librin tim!" Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time. Dhe ai atëherë është në një jetë të kënaqshme. Në një xhennet të lartë. Pemët e tij i ka krejt afër. (E thuhet) Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë. Ndërkaq, kujt i jepet libri i vet nga e majta e tij, ai thotë: "O i mjeri unë, të mos më jepej fare libri im. Dhe të mos ditsha fare se çka është llogaria ime. Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë) mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja." [Hakka: 19-29].

Për sa i përket llogarisë, All-llahu, subhanehu ve tealë, do ta përkujtojë çdo njeri për çdo gjë që ka bërë në këtë botë, qoftë nga të mirat apo të këqijat dhe se kundër tij do të dëshmojë çdo gjë prej kujt All-llahu, subhanehu ve tealë, kërkon që të dëshmojë. Edhe Toka do të jetë dëshmitare e veprave të njerëzve.

All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme, Dhe të nxjerrë toka atë që ka në brenndinë e saj (barrën nga brenda), Dhe njeriu të thotë: "Ç'ka kjo (që bën këtë dridhje)?" Atë ditë ajo i rrëfen tregimet e veta, Ngase Zoti yt e ka urdhëruar atë. Atë ditë njerëzit shfaqen të ndarë në grupe që të shpërblehen për veprat e tyre. E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë." [sureja Zelzele].

Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a se i Dërguari, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "A e dini se cilat janë lajmet e saj?" As'habët u përgjigjën: "All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dine më së miri" Ai tha: "Lajmet e saj janë, se ajo do të dëshmojë për çdo vepër që kanë bërë në të meshkujt dhe femrat, kështu që do të thotë: "Atë ditë dhe atë ditë ka bërë këtë dhe këtë."

Këto janë pra lajmet e saj. E nga gjërat tjera që duhet të na frikojnë dhe të mendojmë rreth tyre është fakti se gjatë dhënies së llogarisë do të dëshmojnë edhe pjesët e trupit, si: gjuha, këmbët, lëkura dhe të tjera, për çdo gjë që ka punuar njeriu, dhe se armiqtë e All-llahut, subhanehu ve tealë, do të grinden me pjesët e trupit të vet.

"E ditën kur armiqtë e All-llahut tubohen për në zjarr dhe ata janë të rrethuar. E derisa afrohen atij, kundër tyre dëshmojnë: të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë punuar. Ata lëkurave të tyre u thonë: "Përse dëshmuat kundër nesh?" Ato thonë: "All-llahu që çdo

sendi ia ka dhënë të folurit na dha edhe neve, e Ai është që ju krijoi juve herën e parë dhe vetëm te Ai ktheheni". Ju nuk fshiheshit (kur bënit mëkate) se do të dëshmojnë kundër jush të dëgjuarit tuaj, të pamurit tuaj dhe lëkurat tuaja, bile ju menduat se All-llahu nuk di për shumë gjëra që ju i bënit." [Fussilet: 19-22].

Përderisa është kështu puna me armiqtë e All-llahut, subhanehu ve tealë, në ditën e gjykimit All-llahu, subhanehu ve tealë, do të jetë i mëshirshëm ndaj besimtarëve. Muhamedi (sal- All-llahu alejhi ue sel-lem) na informon se All-llahu, subhanehu ve tealë, do të veçohet me robin e Vet, mu'minin dhe do t'ia përkujtojë mëkatet që i ka bërë, e pastaj do t'ia fal ato dhe nuk do ta pyes hollësisht.

Transmetohet se dikush i ka thënë Umerit, radijallahu anhu: "Çka ke dëgjuar nga Resullull-llahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të ketë thënë lidhur me pëshpëritjen e All-llahut, subhanehu ve tealë, me robin e Vet, mu'min, ditën e gjykimit?" Tha: "E kam dëgjuar duke thënë: "Besimtari do t'i afrohet All-llahut derisa Ai e vë Dorën e Vet mbi të, e i thotë: "A e ke bërë këtë dhe këtë?" Ai do të përgjigjet: "Po, e kam bërë." Atëherë do t'i thotë: "A e ke bërë këtë dhe këtë?" Ai do të përgjigjet: "Po, e kam bërë." E pastaj do t'i thotë: "Unë t'i kam fshehur ato në dynja, e sot po ti fali." Pastaj do t'i jepet libri i veprave të mira. E për sa i përket jobesimtarëve, ata do të thirren para të gjithë njerëzve me fjalë: "Këta janë ata që kanë gënjyer për Zotin e tyre, le të jetë mallkimi i All-llahut mbi mizorët."

Pastaj tregohet se Ditën e gjykimit veprat e njerëzve, të mirat dhe të këqijat, do të peshohen (me peshore), në mënyrë që të tregohet drejtësia e All-llahut, subhanehu ve tealë,

All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë,



edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës." [El-Enbija: 47].

Përkritazi me këtë lbën Kajjimi thotë: "A mos vallë nuk beson se veprat e njerëzve ditën e Gjykimit do të vihen në peshore. Kjo do të ndodhë, e nganjëherë do të rëndojë njëra pjatë, e nganjëherë pjata tjetër, siç qëndron në Kur'an. Ajo do të ketë edhe gjuhëzën, të cilën pjatat do ta lëvizin dhe do të shikojnë në të, kjo nuk është imagjinatë, por njëmendësi për atë që ka iman."

Poashtu në Ditën e gjykimit njerëzit do të jenë të shpërblyer apo të ndëshkuar për veprat që i kanë bërë në këtë botë.

"Atë ditë All-llahu ua plotëson shpërblimin e merituar, e ata e dinë se All-llahu është Ai i vërteti, i qarti në drejtësi." [Nur: 24].

E në fund, njerëzit pas dhënies së llogarisë dhe peshimit të veprave, do të nisen kah ura e Siratit, urë e cila është vënë përmbi Xhehenemin. Njerëzit do të kalojnë përmbi të me shpejtësi dhe lehtësi të ndryshme, në varshmëri nga veprat e tyre të mira në këtë botë, disa me shpejtësinë e dritës, disa me shpejtësinë e erës, disa duke vrapuar, derisa nuk kalon besimtari që ka pasur pak punë të mira, i cili me një këmbë do ta bëjë një hap para e me tjetrën do të skalitet, me një dorë do të kapet, e tjetra do t'i shpëtojë, dhe atë do ta përcëllojë zjarri, e kur të kalojë do të thotë: "Qoftë i lavdëruar All-llahu, subhanehu ve tealë, që na shpëtojë prej teje (zjarri) pasi që na tregoi atë. Vërtetë All-llahu, subhanehu ve tealë, neve na ka dhuruar atë që nuk ia ka dhuruar askujt."

E si është ura e Siratit? Pejgamberi, sal-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Atëherë do të vendoset ura Sirat mbi Xhehenemin, e unë, së bashku me umetin tim, do të jem l pari që do ta kaloj. Atë Ditë do të flasim vetëm Pej-

gamberët. Lutja (duaja) e tyre do të jetë "O All-llahi im, shpëto, shpëto!" Mbi urë do të ketë grremça të mëdha, si gjembat e sa'danit. A e keni pare sa'danit?" Po, u përgjigjën ata. "Ja pra, ato janë si gjembat e sa'danit, pos që madhësinë e tyre nuk e di l kush pos All-llahut, subhanehu ve tealë, Ato do t'i rrëmbejnë njerëzit në pajtueshmëri me veprat e tyre të këqija. Ndërmjet tyre do të ketë edhe besimtarë të cilët përshkak të mëkateve të tyre, do të mbesin në to, e do të ketë të tillë të cilët megjithatë do të kalojnë e do të shpëtojnë."

Vëllezër, tregohet se ura e Siratit është më e hollë se qimja e më e mprehtë se shpata, e siç pamë ajo i ka edhe pengesat e saja, i ka kukat e saja. E cilat janë këto kuka? Një nga këta kuka është kuka e namazit. Ata që pritonin në këtë botë të falnin namazin mbi qilimat e kësaj bote, e t'u marte kjo 10 minuta, do ta bëjnë këtë në tmerrin e Xhehenemit me vite e vite të tëra mbi dhe të rrethuar nga zjarri i tij.

E njëjta është edhe me agjërimin edhe me zeqatin. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Betohem në kuqërimin e horizontit pas perëndimit, Dhe në natën dhe çka ajo tubon, Dhe në hënën kur ajo është e plotë. Ju patjetër do të përjetoni gjendje pas gjendje". [Inshikak: 16-19].

E, vërtetë vëllezër këto gjendje dhe situata të cilat duhet t'i përjetojë besimtari janë të vështira. A nuk mendoni rreth llahtarisë së Kiametit, jetës së varrit, pastaj ringjalljes, dhënies së llogarisë, peshimit të veprave, a nuk mendoni se vallë a do t'u rëndohet peshoja e veprave të mira, se vallë a do ta merrni librin e veprave tuaja nga e djathta apo pas shpine, e në fund a do të arrijë ta kalojë urën e Siratit, urën mbi xhehenem, e nëse po, vallë a do të më ndalë ndonjë nga pengesat e saja si kuka e namazit, ajo e agjërimit, e zeqatit etj. Vërtetë janë këto gjendje të rënda, e All-llahu, subhanehu ve tealë, na ruajt dhe na ndihmoftë...

Mustafa Qamili, 24.6.2005

## Madhërimi i All-llahut

Madhërimi i All-llahut nuk mund të vijë në mungesë të njohjes së mjaftueshme të All-llahut. Mënyra kryesore për të arritur deri te njohja e All-llahut është dija mbi Te, mbi Emrat e Tij të bukur dhe Cilësitë e Tija të plota.

Andaj Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka udhëzuar në kahje të saktë kur na ka porositur, duke thënë: "Mendoni mbi krijesat e All-llahut dhe mos mendoni mbi Qenien e Tij e të shkatërroheni". (Hasen, Taberaniu. Shiko: "Es-Sahih", nr. 1788).

### Vlera dijes mbi All-llahun

Vëlla i nderuar, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka urdhëruar të kërkojmë nga All-llahu dije të dobishme dhe të kërkojmë strehim nga dija që nuk ka dobi. Xhabiri, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "kërkoni nga All-llahu dije të dobishme dhe kërkoni strehim nga dija që s'ka dobi". (Hasen, Ibn Maxheja).

Këtë na e mësonte Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, edhe praktikisht duke u lutur vetë: "All-llahu im kërkoj strehim te Ti nga dija që ska dobi, zemra që nuk frikohet, shpirti që nuk ngopet dhe lutja që nuk përgjigjet". (Muslimi).

Dije se dija më e dobishme është dija mbi besimin në All-llahun Një, në këtë hyn edhe besimi në Emrat dhe Cilësitë e All-llahut, sepse "vlera e dijes ndërlihet me vlerën e atij për të cilin mëson, kurse Krijuesi është Qenia më e ndershme për të cilin mund të mësohet, andaj edhe njohja e emrave dhe

cilësive të tija është dija më e vlefshme". ("Ahkamul-Kuran", Ibën Arabi).

Dija e dobishme është dija që i mundëson njeriut ta njeh Zotin e vet, dija që e udhëzon drejt Tij, ta veçon në adhurim, të gëzohet me afrinë e Tij, të turpërohet nga afërsia prej Tij dhe ta adhuron sikurse ta sheh Atë". (Fadlu ilmish-Selefi ala el-Halefi", fq. 67).

Baza e dijes është dija mbi All-llahun, dije e cila shkakton frikë nga Ai, dashurinë e Tij, afrimin me Te, mallëngjimin për Te, pastaj vijon dija mbi dispozitat e All-llahut, atë që e do dhe atë që e urren, qoftë fjalë, vepër, gjendje ose besim. Ai i cili i siguron këto dy dije, dija e tij është e dobishme, fiton dije të dobishme, zemër përkulëse, shpirt të ngopur dhe lutje të pranuar, kurse atij që i kalon kjo dije e dobishme, bie në katër gjërat nga të cilat ka kërkuar strehim Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse dija e tij bëhet dëm për te dhe argument kundër tij, andaj edhe nuk përfiton asgjë prej saj, sepse zemra nuk i frikësohet, nuk i ngopet shpirti me dynja, madje i shtohet kujdesi për dynja dhe nuk i dëgjohet lutja, sepse nuk i zbaton urdhrat e Zotit të vet dhe nuk largohet nga gjërat që e hidhërojnë dhe mllëfosën Atë. Dija për të qenë dije nga e cila përfitojmë duhet të jetë e marrë nga Kur'ani dhe Sunneti, e nëse merret prej vendeve tjera, atëherë ajo nuk është e dobishme as për vete e as për tjerët, madje dëmi prej saj është më i madh se sa dobia". (po aty)

Dija e dobishme udhëzon në dy gjëra:

Një: Njohjen e All-llahut dhe Emrat, Cilësitë dhe Veprat që i meriton, kurse kjo shkakton madhërimin, frikën, dashurinë, shpresën, mbështetjen, dakordimin me caktimin e Tij dhe durimin në sprovat që vijnë nga Ai.

Dy: Njohja e gjërave që i do dhe dakor-dohet me to dhe gjërat që nuk i do dhe i urren, qofshin besime, vepra të dukshëm ose të brendshme, ose fjalë.

Kjo shkakton nxitim në vepra ku qëndron dashuria e All-llahut dhe pëlqimi i Tij dhe largimi nga veprat ku qëndron hidhërimi i All-llahut dhe mllëfi i Tij. Nëse e sjell këtë fryt dija e këtij njeriut, kjo dije është e dobishme, kurse çdo herë që dija është e dobishme forcohet në zemër, atehere zemra i frikësohet All-llahut, i nënshtrohet, e nderon, e madhëron dhe e do. Nëse zemra i frikësohet All-llahut, i përulet dhe i nënshtrohet, shpirti i tij mjaftohet me pak gjë nga dynjaja, ngopet me te, kurse kjo shkakton moslakmi dhe asketizëm në dynja. Çdo gjë kalimtare nuk mbetet, qofte pasuri, autoritet, teprica e jetesës, gjëra që ia pakësojnë hisen e tij në dhuntitë e ahiretit edhe në qoftë se është i ndershëm te All-llahu". (po aty).

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë: "Gjëja më e madhe dhe më meritore për të cilën duhet të bëjnë gara garuesit është ajo gjë që i garanton lumturi njeriut në jetën e kësaj bote dhe në jetën e ahiretit dhe që është udhëzues drejt kësaj lumturie, kurse kjo është dija e dobishme dhe vepra e mirë. Vetëm me to arrihet lumturia dhe vetëm me to vjen shpëtimi, andaj që furnizohet me to, ka fituar, kurse ai që privohet nga këto, ai është i privuar nga çdo e mirë. Këto dy gjëra i ndajnë njerëzit në të mëshiruar dhe në të privuar, sipas tyre dallohen njerëzit në i mirë dhe mëkatar, i devotshëm dhe gabimtar, zullumqar dhe mazllum. Pasiqë dija është shoqërues i veprës dhe agitues i tij, kurse

ndera e saj e përcjell nderin e atij për të cilin flet, atëherë dija më e vlefshme është dija mbi monoteizmin, kurse më e dobishmja dija që flet për dispozitat e veprave të njerëzve. Kurse rruga e vetme për të marrë këto dy drita dhe këto dy dije është burimi për të cilin argumentet e prera tregojnë se është i pagabuar, kurse librat qiellor kanë deklaruar se duhet të pasohen dhe përcjellen, e ai është i vërteti dhe i vërtetuari, i cili nuk flet nga epshi, por nga ajo që i shpallet". (Alamul-Muvekiin", 1/5).

Marrë nga libri: "Sifatullahi el-Varide fil-Kurani ves-Sunneti", fq. 8-10, Alevij Es-Sekaf **Madhërimi i All-llahut**

Sado që do të flasim në këtë ligjëratë, nuk do t'ia arrijmë qëllimit dhe do të mbetemi të mangët. Nuk do të kemi mundësi ta lavdërojmë All-llahun ashtu si meriton. All-llahu ka emrat e bukur dhe cilësitë e plota, andaj edhe ne ia konfirmojmë të gjitha emrat dhe cilësitë ashtu sikur i përkasin madhërisë së Tij: "Ai është krijues i qiejve e i tokës. Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte, edhe nga kafshët krijoi çifte, ashtu që t'ju shumojë. Asnjë send nuk është si Ai; Ai është dëgjuesi, shikuesi". (Shura: 11).

"Ata (mohuesit) nuk e njohën All-llahun sa duhet njohur Atë kur thanë; "All-llahu nuk i shpalli gjë asnjë njeriu!" Thuaj: "Kush e zbriti librin, me të cilin erdhi Musai e që ishte dritë e udhërrëfyes për njerëz, e të cilin ju e bëni të shpërndarë në letra, që disa i prezantoni, kurse shumicën e fshihni. Dhe u mësuar çka nuk e dinit ju as prindërit tuaj? Thuaj: (e zbriti) All-llahu". Mandej lëri ata që luajnë në atë kotësinë e tyre". (El-Enam: 91).

Musai, alejhisselam, i cili i ka folur All-llahut drejtpërsëdrejti, i cili ishte bashkëbiseduesi i All-llahut, pasiqë foli një kohë të gjatë me te, e mori malli të shihet, të shikon në All-llahun dhe kërkoi këtë gjë nga Ai,

duke thënë: "...ai tha: "Zoti im! Ma mundëso pamjen tënde e të shikojë!" (El-Araf: 143).

Dëshiroj të shoh, më ka marr malli të shoh. Ia ktheu All-llahu, subhanehu ve teala, duke i thënë: "Ai (Zoti) i tha: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh,...". Domethënë në këtë dynja. Këtu askush nuk mund ta shoh. Kurse në ahiret e shohin besimtarët, sikurse na ka treguar All-llahu, azze ve xhel-le: "Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë". (El-Kijame: 22- 23).

"Ai (Zoti) i tha: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh,...". Pastaj shiko kushtin të cilin ia dha Musait, alejhisselam: shiko kodrën e madhe, nëse ajo kodër e duron shikimin në Mua, do të më shohësh, e kur All-llahu i shfaqet kodrës, Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, thotë: sa një gisht, kjo kodër e madhe thërrmohet dhe nuk mbetet asgjë.

Kur e pa Musai, alejhisselam, këtë pamje ra në tokë i alivanosur, e kur u kthjell tha:

"E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari i besimtarëve!"

"E kur Musai erdhi në kohën që ia caktuam dhe i foli Zoti i vet, ai tha: "Zoti im! Ma mundëso pamjen tënde e të shikojë!" Ai (Zoti) i tha: "Ti nuk ke mundësi të më shohësh, por shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shohësh Mua". Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (kodrën) thërmi, e Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, tha: "E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari i besimtarëve!"

"Ata (mohuesit) nuk e njohën All-llahun sa duhet njohur ...". (El-Enam: 91).

Gjerësia e mbretërisë së All-llahut, azze ve xhel-le.

Vallë, ai që nuk e fal namazin e ka njohur All-llahun sa duhet dhe ashtu si duhet?

Vallë, ai që ha kamatën e ka njohur All-llahun sa duhet dhe ashtu si duhet?

Bishri, rahimehull-llah, thotë:

"Nëse mendojnë njerëzit në madhërinë e All-llahut, azze ve xhel-le, asnjëherë nuk do të bënin mëkate ndaj Tij".

Sad ibën Bilali thotë:

"Mos shiko vogëlsinë e mëkatit, por shiko ndaj kujt bën mëkat, atëherë e kupton sasinë e mëkatit. Po të dinin njerëzit madhërinë e All-llahut, asnjëherë nuk do të bënin mëkat ndaj All-llahut".

A i shihni këto shtatë qiej dhe mbarë gjithësinë, ne që jemi mbi tokë, sistemi diellor, galaktika, të gjitha këto janë asgjë, një pikë në vasionë. Shkencëtarët gjerësinë e vasionit e matin me vite të dritës. Shikoni sa e madhe është kjo gjithësi për të arritur vetëm te qielli i dynjasë, kurse mes njërit qiell dhe tjetrit ka hapësirë sa për të ecur pesëqind vjet.

Gjithësia dhe kjo galaktikë në krahasim me Kursinë e All-llahut janë si një unazë e hedhur në shkretëtirë. A mund ta paramendosh këtë gjë?!

Sa vlejme ne brenda kësaj unazë? Asgjë!

Pastaj Kursia në krahasim me Arshin e All-llahut është sikur një unazë e hedhur në shkretëtirë. Parafytyro këtë gjë!!

"(E Ai është) Mëshiruesi që mbi Arsh qëndron". (Taha: 5).

E di se çka çyt çdo shpirt, e dëgjon zërin e bubrecit që gjendet në shkëmbin e madh në errësirën e madhe të natës:

"Ata (mohuesit) nuk e njohën All-llahun sa duhet njohur Atë ...". (El-Enam: 91).

Ajeti më i madh ku përshkruhet All-llahu, subhanehu ve teala, është Ajetul-Kursi, ku All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "All-llahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai

është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm".

I Gjallë që nuk vdes. Ekziston vetvetiu dhe tjerët i mban. Për secilën krijesë Ai kujdeset.

"All-llahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi". (El-Bekare: 255).

#### **All-llahu i sheh të gjithë robërit e Vet**

Aisheja, radijall-llahu anha, tregon: Na erdhi një grua për tu ankuar për burrin e saj te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Aisheja, radijall-llahu anha, tregon dhe thotë: mes meje dhe asaj kishte vetëm një pëlhurë të hollë, mirëpo as unë nuk mundesha të dëgjoj zërin e saj, kurse All-llahu, subhanehu ve teala, zbriti ajetet: "Vërtet, All-llahu dëgjoj fjalët e asaj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te All-llahu; prandaj All-llahu e dëgjon bisedën tuaj, All-llahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë". (El-Muxhadele: 1).

Atëherë kur mendon të vetmohesh në mëkate ose të ikësh nga vendi ku të njohin, ose kur ta mbyllësh derën, ose kur ti fikësh dritat, mos mendo se edhe atëherë All-llahu nuk të sheh.

Një poet thotë:

Kur të vetmohesh mos thua se jam vet,  
por thuaj: mbi mua kam kontrollues

Mos llogaritni All-llahun të shkujdesur për  
asnjë çast dhe se ajo që fshihni Ai nuk e di

Kemi kaluar kohën kot, pasha All-llahun,  
derisa na erdhën mëkate pas mëkateve

Ah, sikur të na fal All-llahun atë që ka kaluar dhe na lejon që të pendohe mi.

Kur i dëgjoj këto vargje Imam Ahmedi, e la ndejën e dijes, hyri në dhomën e tij dhe e mbylli derën. Nxënësit e pritën një kohë, mirëpo ai nuk doli. Erdhën te dhoma dëshironin të trokasnin në derë, atëherë e dëgjuan Imam Ahmedin duke i përsëritur ato vargje dhe duke qajtur:

Vehb ibën Munebehi, rahimehull-llah, thotë: "Frikoju All-llahut aq sa ka fuqi Ai ndaj teje".

Zejnul-Abidin, Ali ibën Husjeni, radijall-llahu anhu, kur merrte abdes zverdhej. Pas-taj atij i thonin: pse po zverdhesh kur merr abdes? U përgjigj: a e dini para kujt do të qëndroj?! Do të qëndroj para All-llahut. Do të qëndroj para All-llahut.

Kurse sot ka shumë që hynë në namaz me trup, mirëpo mendja e shëtit tërë botën dhe nuk kupton kur përfundoi namazi.

Ka njerëz që hynë në namaz, kurse zemrën e kanë në dynja, në treg apo te epshet. Ai e dëgjon fjalën e All-llahut:

"Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve! Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!". (El-Fatiha: 2-3).

Mirëpo zemrën e ka në dynja, pse? Sepse:

"Ata nuk e çmuan All-llahun me atë madhësinë që i takon, ndërsa në ditën e kiametit e tërë toka është në grushtin e Tij, e qiejt të mbështjellë në të djathtën (forcën) e Tij. Ai është i pastër nga të metat dhe Ai është i lartë nga çka ata i shoqërojnë!". (Ez-Zumer: 67).

Një djalosh qëndronte në rrugë. Në atë moment kaloi një mbret tiran dhe zullumqar, të cilin e adhuronin njerëzit përpos All-llahut. Ky djalosh ishte i devotshëm. I shihte se si njerëzit i afrohen këtij mbreti tiran dhe zullumqar dhe dëshironin të afrohen për çështje të kësaj dynjaje. I shikoj njerëzit dhe

shikoj këtë mbret, i cili përreth vetes kishte ushtrinë dhe rojën e tij.

Në ato momente pran mbretit kaloi një mizë. I afrohej mbretit dhe i ndalej në fytyrë. Ai e largonte, mirëpo miza sërish kthehej. E njerëzit habiteshin. Çdo herë që e largonte mizën, ajo kthehej prapë në fytyrën e mbretit. Një mizë nuk kishte mundësi ta largonte!

Ky djalosh i devotshëm e shfrytëzoi rastin dhe filloi të lexojë ajetin Kur'anor: "O ju njerëz, ja një shembull, veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuron në vend të All-llahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi edhe i luturi. Ata nuk madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij të vërtetë, që e meriton, All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjyes". (El-Haxh: 73- 74).

Të gjithë njerëzit dëgjonin. All-llahu sjell shembull dhe u thotë njerëzve: dëgjoni këtë shembull.

Ata që u luteni përpos All-llahut ata nuk mund të krijojnë as një mizë. All-llahu ekber! A e shihni këtë shembull në këtë rast?! Ky mbret me këtë ushtri, të gjithë që janë në rruzullin tokësor, teknologjia që kanë zbuluar dhe me të cilën kanë arritur në hënë dhe në thellësitat e tokës, e grimcojnë atomin, këta të gjithë a kanë mundësi të krijojnë një mizë. Kjo është sfida nga All-llahu. Sfidat e parë qenka krijimi i një mize:

".. Vërtet ata që po i adhuron në vend të All-llahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të..".

Kurse sfida e dytë qenka:

"...nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj...".

Nëse miza ua rrëmben ndonjë ushqim ose pije, të gjithë njerëzit që janë mbi tokë nuk mund ta marrin prej saj, sepse miza është insekt dhe kur të hyjë ushqimi në brendësinë e saj menjëherë tretet dhe ndryshohet: "...nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi edhe i luturi. Ata nuk madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij të vërtetë, që e meriton, All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjyes". (El-Haxh: 73- 74).

Në këtë rast të gjithë njerëzit thanë: All-llahu ekber, la ilahe il-lall-llah dhe u larguan nga ky mbret.

#### **Porosi secilit njeri të shkujdesur**

Vëllai dhe motra ime që keni harruar All-llahun! Ti që nuk i zbaton mësimet e Tija! Ti që je dhënë pas epsheve dhe harameve! Ti që je larguar nga Kur'ani! Ti që je larguar nga mbulesa dhe nderi! Ti që je zhytur në mëkate dhe gabime! Deri kur më në këtë gjendje!

Shikoni nuk kemi punë me njerëz në këtë rast, por kemi punë me Zotin e njerëzve, i cili ju është drejtuar njerëzve duke u thënë:

"Ua tërheq vërejtjen me Vetën e Tij". (Ali Imran: 28).

All-llahu ekber! All-llahu ua tërheq vërejtjen njerëzve nga dënimet e Tija, kurse njerëzit akoma vazhdojnë në bredhje dhe shkujdesi.

Disa njerëz nuk kthjellen. A e dini se kur do të kthjellen?! Atëherë kur do tu vijë melekul-meuti te koka, atëherë do ti kujtohet kjo e do të thotë: "E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe". (El-Muminun: 99).

A tani e njihni All-llahun?! A tani e njihni fuqinë e All-llahut?! Tani çka të bëjë: të grumbullon pasuri, të shikon filma, të dëgjojë muzikë, të kënaqet në shtëpinë e tij të

re, ta përqafojnë gruan ose të dashurën e tij, ti puth fëmijët e vet?! Jo, të gjitha këto i harron. E harron tërë dynjanë. Vetëm një gjë e kërkon: "E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!" Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen". (El-Muminun: 100).

Shikoni këtë tregim kuranor

"E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e ta kompensoj atë që lëshova!" Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen. E kur i fryhet surit (herën e dytë), atëherë, në atë ditë nuk do të ketë lidhje familjare mes tyre e as që do të pyesë kush për njëri-tjetrin. E kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprat e mira), ata janë të shpëtuarit. Ndërsa, atyre që u peshojnë lehtë peshojat (veprat e mira), ata janë që humbën vetveten dhe janë në xhehennem përgjithmonë. Zjarri do t'ua djegë atyre fytyrat dhe do të duken shumë të shëmtuar brenda tij. (atyre u thuhet): A nuk u janë lexuar juve ajetet e Mia; e ju nuk i besuat ato? Ata thonë: "O Zoti ynë, ne na patën mundur të këqijat (u dhamë pas epsheve të Dunjasë) dhe si të tillë ishim popull i humbur! Zoti ynë, na nxjerr prej tij, e nëse gabojmë përsëri, atëherë vërtet jemi mizorë!" Ai thotë: "Heshni aty e mos më folni!" Pse një grup prej robërve të Mi thanë: "O Zoti ynë, ne besuam, prandaj na falë dhe na mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!" E ju i patët tallur ata, sa që ajo tallje bëri që të harronin përkujtimin ndaj Meje, madje edhe qeshnit me ta. E Unë sot i shpërbleva ata, për atë që ishin të durueshëm ata janë fitimtarët.

Ti që je i shkujdesur ndaj madhërisë së All-llahut

Një ditë duke qenë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në mesin e shokëve të vet, u thotë: "A dëgjoni atë që dëgjoj edhe unë".

Dëgjoni këtë hadith. Dëshiroj secili prej jush ta parafytyron këtë gjë.

"Rënkon qielli dhe meriton të rënkojë".

Pse, çka paska ndodhur? Çka e rëndoka këtë qiell? Çka ka në te?

"Në çdo vend sa një pëllëmbë ka nga një melek që bën sexhde ose ruku".

All-llahu ekber! Në çdo pesë centimetra nga një melek që i përkulet All-llahut, subhanu ve teala!

Melek të cilët:

"...nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". (Et-Tahrim: 6).

Ata kur do të ringjallen, a e dini se çka do të thonë?

"I lartësuar qofsh o All-llahu, nuk të kemi adhuruar ashtu sikur duhet"! Ata nuk bëjnë mëkate ndaj All-llahut, tërë jetën e kalojnë në adhurime, tërë jeta u kalon në sexhde dhe ruku, në zbatim të urdhërave të All-llahut, nuk i kundërshtojnë urdhërat e Tij, e lavdërojnë All-llahun dhe nuk lodhen, e pastaj thonë: nuk të kemi adhuruar aq sa duhet. A e dini pse?

Sepse ata më shumë se ne e madhërojnë All-llahun.

Disa prej nesh mburren para All-llahut pse i ka falë pesë kohë të namazit! Ato ishin pesëdhjetë namaze dhe u pakësuan në pesë. Ato janë pesë namaze, mirëpo janë pesëdhjetë në peshojë. Mirëpo ne të ngratët sërish mburremi me këto vepra tona, kurse harrojmë se All-llahu është Ai që na ka dhënë dhuntinë më të madhe: "... por nëse

jeni të sinqertë All-llahu juve ju bëri mirë, kur ju udhëzoi për besim". (El-Huxhurat: 17).

A keni dëgjuar ose a keni parë përshkrim të melekut më të mirë, Xhibrilit, alejhisselam. Ai është melek që ka gjashtëqind krahë, secili krah e mbulon horizontin. Paramendoni dhe parafytyroni këtë!

Ky melek me një britmë e shkatroi një vendbanim të plotë.

Me një krah e përmbysi një vendbanim të plotë.

Kjo krijesë e madhe, të cilën e pa Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në Miraxh, në qiellin e shtatë, të lodhur dhe të rraskapitur. A e dini pse? Sepse kur iu afrua Xhibrili All-llahu, iu shtua frika dhe trishtimi: "Ata nuk e çmuuan All-llahun me atë madhësinë që i takon, ndërsa në ditën e kiametit e tërë toka është në grushtin e Tij, e qiejt të mbështjellë në të djathtën (forcën) e Tij. Ai është i pastër nga të metat dhe Ai është i lartë nga çka ata i shoqërojnë!". (Ez-Zumer: 67).

Tërë këto shtatë qiejt të mëdha i palos All-llahu, subhanehu ve teala, ashtu sikurse i palos librat, i cili është:

"Ai (All-llahu) është i pozitës më të lartë, i zoti i Arshit; Ai me urdhrin e vet ia sjell shpirtin (shpalljen) atij që do nga robërit e vet, për t'ua tërhequr vërejtjen ndaj ditës së takimit (të kiametit). Ditës kur ata do të dalin (prej varrezave) në shesh, e All-llahu nuk mund t'i fshihet asgjë gjë e tyre. I kujt është pushteti sot? (bëhet pyetja). I All-llahut, i Atij që është Një, i fuqiptotit (është përgjigjja)!

Të gjithë njerëzit të çveshur dhe këmbëzbathur, All-llahu i mbledh në grushtin e djathtë tokën dhe në të tjetrën qiejt, kurse që të dyja duart All-llahu i ka të djathta dhe u thotë krijesave: Unë jam mbreti, ku janë tiranët? Ku janë mendjemëdhenjtë? Ku janë

ata që tregohen mendjemëdhenj ndaj urdhërave të All-llahut? Kush i përgjigjet, kush guxon ti jep përgjigje All-llahut në këtë ditë?

Ku janë mbretërit e tokës, ku janë sulltanat, ku janë kriminelët, ku janë ata që e anashkalojnë ligjin e All-llahut, ku janë ata që tregohen mendjemëdhenj dhe nuk i bëjnë sexhde All-llahut?

Ditës kur ata do të dalin (prej varrezave) në shesh, e All-llahut nuk mund t'i fshihet asgjë gjë e tyre. I kujt është pushteti sot? (bëhet pyetja). I All-llahut, i Atij që është Një, i fuqiptotit (është përgjigjja)!

#### **Shembuj për neglizhentët**

Është nderë për ty që të zbatosh urdhërat e All-llahut, ti bësh sexhde All-llahut. Sa e sa njerëz në dynja sot janë të privuar nga përkulja para All-llahut? sa njerëz sot nuk e njohin All-llahun? Nuk njohin fe e të udhëzohen me te në dynja?

Ka shumë njerëz të hutuar në këtë dynja, nuk e dinë pse kanë dalur në dynja. Një poet skeptik e shpreh këtë duke thënë:

Kam ardhur, nuk di se nga, mirëpo erdha  
Pashë rrugën para vetes dhe eca  
Nuk e di, nuk e di  
E dëshirova këtë ose e refuzova  
Nuk e di...

Po, është e vërtetë se ky nuk e di nga ka ardhur? Nuk e di se ku është fundi?

"Vërtet ka kaluar një periudhë kohore, që njeriu nuk ekzistonte fare si një diçka i përmendur. Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar për ta sprovuar atë, andaj e bëmë të dëgjojë e të shohë". (El-Insan: 1-2).

Kush e krijoi atë? Pa dyshim se All-llahu.

Nëse i hedhim një shikim botës së civilizuar do të hasim njerëz që kanë arritur titull të doktorit të shkencave, ndoshta edhe është bërë profesor, ka dituri të kësaj bote, mirëpo i përkulet lopës, ose pretendon se nuk ka



zot, ose adhuron epshin e vet. Subhanallah!

Pse, sepse nuk e kanë madhëruar All-llahun, ashtu si duhet.

Pasi që ata: "Edhe atë që dinë nga jeta e kësaj bote, është dije e cekët, por ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit) ata janë plotësisht të verbëruar (të paineresuar)". (Er-Rum: 7).

Në ditën e Kiametit kur grumbullohen të gjithë njerëzit, të parët dhe të fundit, vijnë njerëzit te baba i njerëzimit për të ndërmjetësuar për ta duke i thënë: ti je baba ynë, ti je krijesa e parë, ndërmjetëso të Zoti ynë. Çka do të thotë Ademi, alejhisselam? Çka do të thotë Nuhi, Ibrahim, Musa, Isa, alejhi-musselam? A e dini se çka do të thonë?

Të gjithë ata do të thonë: Zoti jonë sot është hidhëruar aq shumë saqë asnjëherë kështu nuk është hidhëruar. Shkoni te tjerët. Shkoni te Nuhi, të Ibrahim, të Musai, te Isai, shkoni te Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Kurse Muhammedi, alejhisselam, çka thotë? Ai nuk thotë: shkoni te tjerët, por thotë: unë jam për këtë. Shkon te Zoti, xhel-le shanuhu, bie në sexhde, kurse askujt nuk i takon ky vend përpos Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Bie në sexhde, kurse All-llahu e inspiron me llojloj lutjesh dhe falënderimesh, pastaj i thotë All-llahu të dashurit të vet, Muhammedit, alejhisselam: Muhammed! Ngrite kokën, kërko që të jepet dhe ndërmjetëso se pranohet ndërmjetësimi yt. Paramendoni se çka mund të thotë Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në këtë pozitë? A kërkon shpëtim për vete? Për fëmijët dhe dashamirët e tij? Jo, ai thotë: All-llahu im, kujdesu për ummetin tim, kujdesu për ummetin tim, kujdesu për ummetin tim".

Në këtë ditë do të ndodh edhe diçka interesante me ata që nuk kanë ecur rrugës së

Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. All-llahu tregon këtë pamje duke thënë:

"Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!" O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejt, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriu e humb dhe e lë të vetmuar". (El-Furkan: 27- 29).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na tregon: "Secili prej nesh ka me biseduar me Zotin e vet".

A e keni dëgjuar këtë hadith. All-llahu do të flet ty dhe do ti flet secilit njeri. Disa njerëz nga shkaku i besimit të dobët dhe bindjes së ulët mund të thotë: All-llahu do t'i flet mbarë njerëzimit? Po po. A na dëgjon All-llahu të gjithë neve? Nëse secili njeri në rruzullin tokësor i lutet All-llahut, All-llahu e dëgjon lutjen e Tij, madje nëse secili njeri qoftë në lindje ose perëndim gjatë faljes thotë: elhamdulilahi rabil-alemin, All-llahu ia kthen duke thënë: më falënderoj robi im.

Pra, All-llahu, azze ve xhel-le, secilit prej nesh do ti flet edhe atë pa ndërmjetësues, atëherë njeriu do të shikon në të djathtë dhe do të sheh veprat e veta dhe do të shikon në të majtë dhe do ti sheh veprat e veta.

Do të sheh sa namaz ka falur, sa ka folur drejtë, sa ka mashtruar, sa ka respektuar prindërit, sa ka vjedhur, sa ka konsumuar alkool, sa ka nënçmuar njerëz, sa ka urdhëruar në të mirë dhe sa ka ndaluar nga e keqja, a ka shkuar pas epshit ose jo, domethënë të gjitha veprat që i ka bërë në dynja do ti sheh para vetes. All-llahu, subhanehu ve tala, thotë: "Dhe vihet libri (i veprave), e i sheh mëkatarët të frikësuar nga shënimet që janë në të dhe thonë: "Të mjerët ne, ç'është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e

përfshirë?", dhe atë që vepruan e gjejnë të gatshme - prezente, e Zoti yt nuk i bën padrejtë askujt". (El-Kehf: 4).

Mos shiko vogëlsinë e mëkatit, mos thuaj mëkat i vogël, sepse secilin mëkat e regjistron All-llahu. Nëse dikush prej nesh kur është para njerëzve turpërohet dhe nuk bën mëkat, ose kur të është para prindit i vjen turp të bën ndonjë gabim, ose kur të është në mesin e shokëve, para hoxhës, para njerëzve fetar, mirëpo kur të vetmohet, atëherë nuk turpërohet nga All-llahu: "A nuk e di ai se All-llahu e sheh? (Alek: 14).

Ky njeri dhe ky mëkatar a nuk e di se All-llahu e sheh dhe e kontrollon.

Omeri, radijall-llahu anhu, në mëngjes ishte duke ecur rrugëve dhe dëgjoji një grua duke i thënë vajzës së vet: përzije qumështin me ujë. Vajza e vogël ia ktheu: nëna ime, kryetari i muslimanëve, Omer ibën Hatabi ka ndaluar që të përzihet qumështi me ujë. Nëna ia ktheu: Kryetari i muslimanëve tani nuk na sheh. Të gjithë njerëzit e përzien qumështin me ujë, bija ime! Kjo vajzë besimtare i tha nënës së vet: Nëse Omeri nuk na sheh, All-llahu është që na sheh: "...Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave e të mos jetë Ai i katërti; ...". (Muxhadele: 7).

All-llahu na sheh dhe na dëgjon.

O njeri, a ke menduar të kthehesh te All-llahu? Ti që u drejtohesh njerëzve me duart dhe zemrën tënde, pse nuk i kthehesh All-llahut? ktheju All-llahut me sinqeritet?

#### **Kush i përgjigjet nevojtarit?**

Një tregtar udhëtonte nga një vend në një vend tjetër. Me vete e merr edhe një njeri të huaj, i cili kërkon që ta shpien deri në një vend të caktuar. Gjatë rrugës, tregon ky tregtar, hyrëm në një luginë të errët dhe pash aty kafka të njerëzve. U frikova dhe kuptova se diçka nuk është në rregull. Mu drejtua bashkudhëtari im dhe më tha: zbrit

nga kali. I thashë: çka donë? E nxori thikën dhe ma drejtoi mua e më tha: dua të të mbys. Ika prej tij, mirëpo ai më kapi. Pastaj i thash: mere kalin dhe pasurinë dhe lenëm rehat të jetoj. Ai më tha: kali dhe pasuria janë të mijat, mirëpo edhe dua të të mbys. Tha: nëse do të më mbysësh më le që ti fali dy rekate namaz para se të më vrasësh. Tha: falu, mirëpo shkurt.

Tha: fillova namazin dhe nga frika e madhe i harrova suret e Kur'anit. Mu kujtua vetëm një ajet. Cili ishte ai ajet? Ajeti Kur'anor, ku All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "A është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret, duke ia larguar të keqen e juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër pos All-llahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni". (En-Neml: 62).

Tregon tregtari: sa e përfundova namazin, erdhi një kalorës nga mesi i luginës e kishte drejtuar shtizën dhe kur u afrua e goditi njeriun dhe e mbyti. Thashë: subhanall-llah! Kush je ti? Tha: unë jam i dërguari i atij që i përgjigjet nevojtarit, kur ky i lutet Atij.

All-llahu ekber!

Vëlla i nderuar! Motër e respektuar!

A e di se All-llahu i madh e do robin e Tij kur kthehet te Ai?

A e di se All-llahu i madh gëzohet kur i kthehet robi Atij si pendues?

Nëse kalon vite të tëra në mëkate, nëse ngulfatet në mëkate, nëse bën shumë mëkate dhe gabime dhe dëshiron të kthehet te All-llahu, All-llahu e pranon dhe gëzohet me te, sepse: "...All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme". (El-Bekare: 222).

Kush jam unë që të më dojë All-llahu?

Kush jam unë që të gëzohet All-llahu me pendimin tim?

Unë që kam bërë mëkate, e kam ngulfatur veten me mëkate, kohë të gjatë kam bërë mëkate, tani të më dojë All-llahu?!

Po, nëse i kthehesh All-llahu, pendohesh dhe ndien keqardhje për të kaluarën, All-llahu të do ty.

Një njeri nga izraelitët kishte adhurar All-llahun katërdhjet vite. Pastaj katërdhjet vite tjera kishte bërë mëkate ndaj All-llahut. pas këtyre viteve në mëkate kishte dashur të pendohet dhe duke qarë lutej: All-llahu im, të kam adhurar katërdhjet vite, pastaj të kam bërë mëkate katërdhjet vite, vallë e ka

pendim për nëse unë kthehem te Ti? Ndërkohë dëgjoi një zë duke thënë: robi im, na adhurove të afruam, bërë mëkate, kurse ne të dhamë afat, e nëse na kthehesh të pranojmë, sepse: "Nuk ka dyshim se Unë e fal atë që është penduar, që ka besuar, që ka bërë vepra të mira dhe që përqendrohet për në rrugën e drejtë". (Taha: 82).

All-llahun e lusim të na shtojë besimin, të na afroje te Ai, të na shtojë dijen mbi Te, të na i fal mëkatet, gabimet, të na i forcojë këmbët dhe të na ndihmojë kundër zullum-qarëve.

Bekir Halimi,  
17.6.2005

## Në prag të pushimeve verore

Jemi në përfundimin e vitit shkollor dhe në pragun e pushimeve verore. Këto dy etapa nga ky vit, krijojnë një tollovi të madhe në mesin e besimtarëve. Në rastin e parë dita ditës janë duke u shtuar disa dukuri negative, sikurse është tubimi dhe grumbullimi i familjes për të përcjellur maturantët ose semimaturantët në kremtimin e maturave nëpër restorante dhe hotele luksoze. Kjo në vete nuk do të kishte qenë edhe ndonjë gjë negative nëse nuk kuptojmë atë që ndodh gjatë këtyre kremtimeve, siç është veshmbathja lakuriqe, vallëzimi mes vajzave dhe djemve, konsumimi i alkoolit, disa raste edhe e drogave të lehta, keqpërdorimi i nxënëseve, etj.

Aq sa na gëzon përfundimi i vitit shkollor dhe pajisja me dije e njerëzve aq na mërzit dhe na mllëfos përhapja e kësaj dukurie të shëmtuar në mesin e popullit tonë, sepse ne përpos që kemi nevojë për njerëz të shkolluar aq më tepër kemi nevojë për njerëz të

ndershëm dhe me moral, kurse këto fenomene aktivitetet edukativo arsimore i shpijnë në kahje tjetër.

Pjesa e tjetër me të cilën ballafaqohemi gjatë këtyre ditëve është edhe një brengë e re, një planifikim dhe përkujdes për pushimet verore, rekreimet dhe dëfrimet e ndryshme.

Në këtë drejtim kemi dy kategori njerëzish:  
- ata që me padurim i presin këto dy muaj që të jepen pas dëfrimit, argëtimit dhe pushimit.

- Ata që planifikojnë që në mënyrë maksimale të shfrytëzojnë këtë pushim veror për të përfituar përvoja, njohuri dhe dituri të reja.

Si e nënkuptojnë nxënësit pushimin veror  
Dikush pushimin veror e nënkupton si ditë ku flenë deri në mesdite, rrinë natën deri në mëngjes, argëtohet dhe dëfrehet pa ndonjë detyrë dhe obligim konkret.

Dikush pushimin veror e kalon duke punuar në fshat me familjen e tij, me qëllim të

fitimit të ndonjë dinarit, sepse harxhimet e shkollimit janë të mëdha. Edhe pse lodhen me punët në fshat, ata gëzohen sepse janë afër familjes dhe farefisit.

Dikush e shfrytëzon pushimin veror për ti ndihmuar babait të vet në punën që e kryen ai, sidomos nëse është plak dhe i dobësuar.

Tjetri tregon se për të shkuar në pushim duhet para, kurse ai këto nuk i ka, andaj ai që nga fëmijëria nuk di se çka është pushimi, ai di vetëm punë, lodhje dhe rraskapitje.

Si e nënkuptojnë prindërit pushimin veror

Dikush brengoset shumë për fëmijët e tij gjatë pushimeve verore, sepse koha boshe për këtë prind është më e vështirë se sa koha e angazhuar me studime, andaj fëmijëve u ka blerë një kompjuter për të punuar në te dhe për të parë në te ndonjë film interesant dhe për të dëgjuar në te ndonjë kaside, ndonjë ders, apo ndonjë lexim të këndshëm të Kur'anit. U ka siguruar edhe libra të lëmime të ndryshme, të cilat e vetëdijësojnë dhe ia shtojnë kulturën.

Një prind tjetër tregon se si kur ka qenë i ri pushimet verore i ka kaluar në argëtim dhe dëfrim, duke u ikur detyrave dhe obligimeve familjare, madje familja nuk ka arritur ta kenë të pranishëm edhe në sofrën e drekës. Andaj, ky prind, dëshiron ta përmirëson këtë gabim të vetin tek fëmijët e tij, duke ua organizuar fëmijëve të vet kohën e pushimeve verore. Ata afër shtëpisë kanë një klub sportiv, ku e kalojnë një pjesë të madhe të kohës, pas drekës, pushojnë, kurse në mbrëmje ose lexojnë ndonjë gazetë ose revistë, ndonjë libër, ose dëgjojnë ndonjë kasetë, ose shikojnë ndonjë film të dobishëm. Pastaj i nxitë fëmijët që të jenë të pranishëm në xhami dhe në derset që mbahen në xhami. Herë pas here dalin në bjeshkë ose në vizitë të farefisit.

Çka thonë pedagogët për pushimet verore

Pushimet verore dhe argëtimi luan rol shumë të rëndësishëm dhe të rrezikshëm në psikologjinë e nxënësit. Nxënësi duhet të kënaqet gjatë pushimeve verore, të largohet nga brenga e mësimit dhe presioneve psikike dhe nervore. Argëtimi ka kahje dhe shkolle të ndryshme, mirëpo duhet dhënë përparësi argëtimit të qëllimtë, duke e shfrytëzuar argëtimin për lojë, vizita të vendeve historike me qëllim të përfitimit të njohurive historike dhe gjeografike, për kuize të diturisë, aktivitete sportive. Tërë kjo ia hap sytë dhe i shesh botërat e panjohura për te, fiton shokëri të reja, mësohet në bashkëpunim dhe altruizëm, mëson garën për punë të mira dhe të dobishme, mëson leximin dhe fitimin e kulturës së gjerë, etj.

Secila familje nuk ka mundësi ekonomike për të shkuar në pushime verore, mirëpo institucionet edukativo arsimuese duhet të organizojnë aktivitete të ndryshme në objektet e tyre për të kaluar pushimet verore në formën më të mirë. Shkollat duke organizuar kuize të ndryshme të diturisë dhe aktiviteteve të ndryshme, siç është mësimi i zanateve të ndryshme, kurse xhamitë e mëdha kurse për mësimleximin e Kur'anit, mësimin përmendsh të Kur'anit, mësimin përmendsh të haditheve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, organizimi i garave në mësim përmendsh të sureve ose xhuzeve të Kur'anit, dhe në mësimin e haditheve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, organizimi i ligjëratave speciale për të rinjtë dhe të reja dhe në sferat për të cilat kanë më së shumti nevojë.

Klubet sportive të organizojnë kurse për trajnim në sporte të caktuara, të organizohen shëtitje në male, etj.

Edhe gjatë pushimit veror nuk duhet harruar se viti i ardhshëm shkollor vjen shumë shpejtë, andaj një pjesë të kohës nga

pushimet verore duhet rezervuar për përgatitje për vitin e ardhshëm shkollor.

Fëmijët tanë dhe hallkat e Kur'anit

Është koha e fundit kur prindërit duhet ti orientojnë fëmijët e tyre drejt mësimleximit të Fjalës së All-llahut, subhanehu ve teala, Kur'anit Famëmadh.

Fatkeqësisht është bërë një kohë e gjatë që nga kur fëmijët tanë e kanë braktisur mësimin e këtij Libri, kurse nevoja për të është shumë e madhe, edhe në sferën e besimit, edhe në sferën e dijes, edhe në sferën e edukatës, edhe në sferën e raporteve familjare, edhe në sferën e aktiviteteve dhe rezultateve. Domethënë është i rëndësishëm edhe për dynja edhe për ahiret.

Secili Imam i xhamisë, secili thirrës që merret me përhapjen e kësaj feje duhet të organizon së paku gjatë verës kurse verore për mësimleximin e Kur'anit. Me këtë hap i ngjallim xhamijat dhe krijojmë raporte speciale mes fëmijëve dhe Kur'anit dhe mes fëmijëve dhe xhamisë. Ska dyshim se kjo do të le mbresa dhe gjurmë të paharruara në vetëdijen e fëmijëve, ndoshta edhe do të jenë vendimtare për ardhmërinë e tij.

Të nisim nga ky vit një kampanjë për të promovuar kurset e Kur'anit me qëllim të afrimit të njerëzve sa ma afër këtij Libri Fisnik, të cilit nuk i vjen e kota as para e as mbrapa.

Kurset e mësimleximit të Kur'anit nuk duhet të merren vetëm me mësimin e shkronjave të Kur'anit dhe leximin e tij, por edhe të shkohet në drejtim të mësimin të domethënies të fjalëve të All-llahut dhe analizimit të këtyre Fjalëve. Nëse i qasen Kur'anit në këtë formë atje do të gjejnë përgjigje të sakta për çdo gjë për të cilën kanë nevojë në jetën e tyre të dynjasë dhe ahiretit.

Muslimanët e parë e kanë kuptuar këtë, andaj përsëri mësimleximit të Kur'anit janë

përpjekur që edhe ta kuptojnë atë që All-llahu ua ka thënë në këtë Libër.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"E ka disa prej tyre që janë analfabetë, nuk e kuptojnë librin, por jetojnë vetëm në shpresa, duke mos qenë të sigurt". (El-Bekare: 78).

Imam Sheukaniu, rahimehull-llahu, thotë: "Ata nuk dinë asgjë më shumë se sa leximi i Kur'anit pa kuptim dhe analizë".

Abdullah ibën Omeri, radijall-llahu anhu, thotë: "Njeri me vlerë në fillimin e këtij umeti ishte ai që nuk dinte më shumë se një sure, ose diçka të ngjashme me te, mirëpo punonin sipas Kur'anit, kurse fundi i këtij umeti e lexojnë Kur'anin edhe fëmijë edhe i verbëri, mirëpo nuk punojnë sipas tij".

Kurse Abdullah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, thotë: "Neve na vinte rëndë të mësojmë fjalët e Kur'anit, kurse e kishim të lehtë veprimin sipas tij, kurse pas nesh do ta kenë të lehtë mësimin përmendsh të Kur'anit mirëpo do ta kenë të vështirë veprimin sipas tij". (Shiko: "Tefsir Kurtubi", 1/39-40).

Këto tregime dhe të ngjashmet me to na tregojnë se muslimanët e parë kanë qenë shumë ngushtë të lidhur me fjalën e All-llahut, edhe jo vetëm duke u kujdesur për fjalët dhe shkronjat e Kur'anit, mirëpo edhe për kuptimin dhe porositë që dalin nga ky Kur'an. Ndaluni dhe analizoni këtë rast.

Mutalib ibën Abdullahi thotë: Ibën Zubejri, radijall-llahu anhumu, lexoi një ajet. U ndal në këtë ajet dhe tërë natën e kaloi duke e analizuar këtë ajet. Në mëngjes e thirri Ibën Abasin, radijall-llahu anhumu, e i tha: unë mbrëmë kam lexuar një ajet, tërë natën e kam analizuar. Ajeti ishte:

"Dhe shumica e tyre nuk e beson ndryshe All-llahun, vetëm se duke i shoqëruar (zota të tjerë)". (Jusuf: 106).

Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, i tha: mos u mërzi, sepse qëllimi me këtë ajet janë idhujtarët, pastaj ia lexoi ajetin Kur'anor:

"Nëse ti i pyet ata: Kush krijoi qiejt e tokën? Me siguri do të thonë: "All-llahu!" Thuaj: "All-llahut i qoftë lavdërimi!" Por shumica e tyre nuk dinë". (Lukman: 25).

Domethënë ata i besojnë All-llahut si krijues e i bëjnë ortak në adhurime.

Transmeton Imam Maliku në librin e tij El-Muveta se Abdullah ibën Omeri tetë vite e ka mësuar suren El-Bekare.

Kurse tregon se Omerit, radijall-llahu anhu, kjo sure i ka marrë dymbëdhjetë vite.

Andaj na ka dhënë një porosi të madhe Sufjan ibën Ujejne duke na thënë:

"Fillimi i dijes është: dëgjimi, pastaj kup-timi e pastaj futja në kujtesë".

Ahmed ibën Ebil-Havariu thotë:

"Lexoj Kur'anin dhe ndalem të mendoj në një ajet, habitem nga mrekullia e ajetit dhe habitem me hafizlerët. Si ka mundësi të flej-në dhe të merren me dunja, kurse e lexojnë Fjalën e All-llahut! Ata po të kuptonin atë që lexonin, po ta dinin obligimin ndaj Kur'anit, do të kënaqeshin me te, do tu vinte shumë i ëmbël leximi i tij dhe do tu ikte gjumi nga gëzimi për këtë gjë që ua ka dhënë All-llahu". (Letaiful-Mearif, fq. 203).

All-llahun e lusim që Kur'anin të na e bëjë pranverë të zemrës tonë, shërim të gjoksit tonë, të na shtojë dashurinë tonë për te, të bën të dashur në zemrat e fëmijëve tanë. Amin.

#### **Projekte për pushimet verore**

Mbarë shoqëria duhet të angazhohet për formimin e të rinjve, secili nga këndi i vet. Në vazhdim do të ofrojmë disa projekte si shembull se si duhet të angazhohemi gjatë pushimeve verore.

#### **Projektet e adhurimeve**

Këtu hyn shkuarja në Umre për ata që kanë mundësi, mësimi përmendsh i Kur'anit, ose i disa pjesëve nga Kur'ani.

Nëse një i ri e organizon kohën e tij dhe ia bën vetes qëllim që për çdo ditë të mësojë nga pesë ajete nga Kur'ani, atëherë për një javë do të mësojë 35 ajete, kurse për një muaj 140 ajete, kurse për tre muaj 420 ajete, domethënë 4 xhuza e gjysmë. Kjo domethënë se për gjashtë ose shtatë pushime verore mund ta mësosh përmendsh tërë Kur'anin.

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"I thuhet bartësit të Kur'ani në ditën e Kiametit: lexo dhe ngritu ashtu sikurse ke lexuar në dynja, sepse vendi yt do të jetë në ajetin e fundit që e lexon". (Sahih, Ahmedi).

#### **Projekte shkencore**

Në këtë hyn ndeja para hoxhallarëve dhe marrja dije prej tyre. Pjesmarja në kurse të ndryshme mbi mësimet fetare, organizimi i këtyre kurseve, organizimi i tribunave të ndryshme, thirrja e hoxhallarëve nga viset e ndryshme, etj.

Rinia mund të jetë aktiv në këto kurse duke marrë pjesë, duke i shënuar mësimet, duke i incizuar ato, duke u bërë një rezyme, duke i promovuar ato, etj.

Në këto projekte hyn edhe shkrimi i studimeve për problemet delikate me të cilat ballafaqohen muslimanët e vendit tonë, regjistrimi i dukurive negative në shoqëri, përgatitja e statistikave që u duhen hoxhallarëve për të folur mbi ndonjë problem të përhapur në shoqëritë tona, etj.

Kujdes në këtë drejtim që mos të marrish përsipër detyra që janë më të mëdha se niveli yt.

Në këtë sferë hyn edhe pjesmarja në kurse të ndryshme verore, qoftë për të mësuar gjuhën angleze, ose kompjuterin, ose për

organizim të shoqatave joqeveritare, ose kurs për gazetari, ose kurs për elektrikist, ose kurs zanate të ndryshme për të cilat kemi nevojë në dynja dhe ahiret.

Këtu doemos duhet theksuar edhe çështjen e leximit.

Një hoxhë bashkëkohor tregon një rast duke thënë: në një prej pushimeve verore, një djalosh më këshilloj që të lexoi gjatë këtij pushimi veror dhe mi ofroi disa libra. Fillova të lexoj gjatë këtij pushimi veror. Edhe kur shkoja ti ndihmoj babait në duqan, librin e vendova në mes të fletores së shitjes. Në këtë pushim veror lexova gjashtëdhjetë libra. Në fund të pushimeve kur më pyeti ky vëlla se sa kam lexuar këtë verë, kisha frikë mos të më përgënjeshtrohet dhe nuk ia tregova numrin e vërtetë të librave që kisha lexuar. Mirëpo akoma sot e kësaj dite i përjetoj frytet e atij leximi.

Andaj edhe ne i këshillojmë të rinjtë dhe të rejtat që të përgatisin program të leximit dhe të zgjedhin disa libra të cilat do ti lexojnë gjatë këtyre pushimeve verore. Normalisht se në këtë drejtim është që të lexon libra nga tematika të ndryshme me qëllim që mos të mërzitet nga leximi në një temë ose për një çështje.

Fillo me çështjet e besimit, sepse ato janë baza, pastaj mëso rregullat e adhurimeve që ti bësh si duhet, mëso mënyrën e kuptimit të fesë që mos të devijosh, lexo tregime të muslimanëve të parë për të shtuar entuziazmin, e kështu me radhë.

Duhet lexuar aq shumë derisa të bëhemi të mrvuar nga leximi.

Sot fatkeqësisht i shohim jomuslimanët lexojnë shumë ma shumë se muslimanët. Secili prej tyre ka nga një libër në çantën e tij, ose në xhepin e tij, ose në duqanin e tij, ose në vendin ku ai punon, ose kur udhëton. Domethënë ai nuk ndahet nga libri.

Ne fatkeqësisht më shumë kemi durim në biseda të kota dhe me to e kalojmë tërë natën, kurse sapo i lexuam pesë rreshta mërzitemi dhe e mbyllim librin.

Pasha All-llahun nëse njeriu mësohet të lexon dhe gjen libër të përshtatshëm, ai me kalimin e kohës gjenë kënaqësi të madhe në leximin e librit, kënaqësi të cilën nuk mund ta zëvendëson asgjë.

#### **Projekte të thirrjes në fe dhe humanitare**

Pjesmarja në projekte për tua mësuar njerëzve fenë, për tua sqaruar shtyllat e fesë, për të përgatitur programe që ua lehtësojnë njerëzve kuptimin e fesë, në organizimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë për qëllim afrimin e njerëzve me fenë.

Ose pjesmarja në aktivitet të ndryshme humanitare, duke i regjistruar nevojtarët e lagjes, gjendjen sociale të njerëzve të ndryshëm, kontaktin me të pasurit për tu ofruar ndihmë atyreve që e meritojnë, e kështu me radhë.

#### **Projekte shoqërore**

Secili i ri duhet shumë seriozisht të mendon mbi çështjen e martesës, sidomos tani që epshi është shumë aktiv dhe ngacmohet në çdo anë, andaj edhe duhet të bëjë përgatitje edhe psikike edhe fizike për të plotësuar kushtet e martesës.

Kjo vlen edhe për djemtë edhe për vajzat. Secili që dëshiron ta ruan nderin dhe moralin e tij, e vetmja mënyrë është martesa me kohë.

Prej projekteve shoqërore është puna me prindërit, secili me prindin e tij, çfarëdo lloj pune që bën ose projekti që realizon.

Sepse në këtë mënyrë adaptohemi të marrim përsipër përgjegjësi dhe kështu krijohen burrat. Kurse ne sot më së shumti kemi nevojë për krijimin e burrave që do ta marrin përsipër udhëheqjen e këtij populli.

Vizita e farefisit, organizimi i kampeve familjare, ku mblidhen anëtarët e familjes prej vendeve të ndryshme, shihen mes vete, e shfrytëzojnë këtë takim për mësimin e fesë, për ofrimin e përvojave, po edhe për rekreim.

Organizimi i grupeve të djemve për të dalur në vizitë të qyteteve dhe fshatrave tjera me qëllim të thirrjes në fe të All-llahut. Ata me këtë vepër jetojnë në mes të shoqërisë së mirë, e kalojnë kohën në gjëra të dobishme, njihen me njerëz të ndryshëm, njihen me bukuritë natyrore të vendit ku jeton, ua mësojnë njerëzve rregullat kryesore të fesë, e kështu me radhë.

### **Aktivitete të ndryshme**

Organizimi i takimeve në shtëpi, shpërndarja e librit, shpërndarja e kasetave, shpërndarja e fletushkave, etj.

Secilit mund ti bie ndërmend ndonjë ide ose propozim, le të nxiton ta realizon ose t'ia tregon atij që ka mundësi ta realizon. Kryesore është që secili prej nesh të kontribuon që sa ma mirë dhe me sa ma shumë dobi të kalojmë pushimet verore.

E lusim All-llahun që të na mundëson shfrytëzimin racional dhe optimal të kohës në vepra që na afrojnë të All-llahu dhe mëshira e Tij dhe na largojnë nga zjarri dhe dënimi i Tij. Paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij.

Bekir Halimi,  
24.6.2005



## Cilësitë e gjykatësit në islam

Për të zbatuar punën e tij gjykatësi duhet të ketë disa cilësi të cilat i kanë përmendur juristët (الفقهاء) islam: (صفات القاضي)

1. Pjekuria: I mituri nuk mundet të bëhet kadi. Nëse emërohet në postin e kadisë vendimet e tij nuk do të janë detyruese. I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka urdhëruar të kërkojmë strehim te All-llahu nga sundimi i fëmijëve.

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kërkoni strehim tek All-llahu nga sundimi i fëmijëve.” (Transmetoi Ahmedi. Albani këtë hadith e vlerësoi si Hasen).

Duke e pasur parasysh faktin që kërkimi i mbrojtjes prej All-llahut bëhet prej gjërave të dëmshme konkludojmë që emërimi i fëmijës në poste të tilla është i ndaluar. I mituri nuk ka të drejtën e kujdestarisë mbi vetën, atëherë si mundet t'i besohet kujdestaria mbi të tjerët, gjë kjo të cilën e nënkupton posti i gjykatësit.

Kadiu përpos shëndetit në trup dhe mendje duhet të ketë mendjemprehtësi dhe kualitet të lartë në mënyrën e të menduarit. Nuk është kusht që kadiut të jetë i vjetër me moshë. Ai duhet t'i plotëson edhe kushtet e tjera pasi që të plotëson kushtin e parë, të jetë i pjekur (sipas kushteve që i parashih islami gjegjësisht: ejakulimi, dalja e qimeve në vendet e turpshme ose arritja e moshës mbi pesëmbëdhjetë vjeçare)

Halifeja El Me'mun emëroi Jahja ibën Akthemin si kadi të Basrasë kur ai kishte tëmbëdhjetë vjet. Disa njerëz e kritikuan

emërtimin e tij dhe Me'muni i dërgoi një letër duke e pyetur për moshën që duhet ta ketë një kadi? Jahja ia ktheu letrën duke thënë: Unë jam në moshën që e pat Itab ibën Usejdi kur i Dërguari i All-llahut e emëroi në postin e kadisë në Mekke.”

Në të njëjtën kohë mosha më e rritur është gjë e pëlqyer sepse e ngrit dinjitetin dhe prestigjin e gjykatësit. Këto kushte juristët islam i konsiderojnë të dëshirueshme për kadinë.

2. Të jetë me mendje të shëndoshë. Nuk lejohet që njeri i çmendur ose i përkufizuar në aspektin mendor të emërohet në postin e kadiut. Njeriu gjykimi i të cilit dobësohet për shkak të moshës ose sëmundjes nuk ka të drejtë të ushtron në postin e kadisë. Ky kualifikim është i ngjashëm, bile më i rëndësishëm se ai i pjekurisë (moshës). Personi që nuk e plotëson këtë kusht nuk lejohet të emërtohet në këtë post dhe vendimet e tij anulohen.

Juristi El Maverdi thotë: “Ky kusht është i pranuar me konsensus nga juristët myslimanë. Njeriu që nuk është i shëndoshë në aspektin mendor nuk mundet të merret në përgjegjësi ligjore për veprimet e tij. Ai duhet të jetë inteligjent dhe i aftë për të bërë dallimin mes gjërave. Ai (kadiu) nuk guxon të jetë i hutuar dhe neglizhent. Nëse atij i mungon inteligjenca ai nuk do të mund t'i shohë në mënyrë të qartë situatat delikate e as që mund tu jep zgjidhje rasteve problematike.

3. Liria: Kadiu duhet të jetë plotësisht i lirë. Nuk lejohet që në postin e kadisë të emërtohet njeri që është rob pa marrë parasysh statutin e tij / qoftë në procesin e liritimit (المكاتب) apo ai i cili ka ikur prej pronarit (أبق). Personi që nuk e plotëson këtë kusht nuk lejohet të emërtohet në këtë post dhe vendimet e tij anulohen.

Robi, si i tillë, nuk e gëzon lirinë e plotë dhe veprimet e tij janë të përkufizuara me vullnetin e pronarit. Në një situatë të tillë ai nuk mundet të vendoset në postin nga i cili do të udhëheq më çështjet e të lirëve. Veç kësaj posti i kadisë është titull nderi dhe prestigj që ka autoritetin dhe aftësinë të frenon kriminelët dhe të devijuarit. Kjo nuk mund të ndodh nëse kadiu është rob. Të paktën ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Juristi Ibën Hazm lejon emërtimin e robit në postin e kadisë duke e argumentuar me pranimin e dëshmisë që e bën rob. Sipas tij kushtet e kadiut janë të njëjtë me kushtet për pranimin e dëshmisë.

4. Islami: Posti i kadisë është post i autoritetit ligjor me vendime detyruese. Nuk lejohet që një jomuslimani t'i jepet posti i kadisë. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“All-llahu kurrsesi nuk iu mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.” (En Nisa, 141)

Kadiu gjithashtu zbaton ligjet e jurisprudencës islame (الشريعة الإسلامية) që në vete është një rit adhurues që kërkon besimin si kusht për plotësimin e tij. Besimi dhe devotshmëria garantojnë mos devijimin gjatë marrjes së vendimeve. Këtë nuk mund ta bën jomuslimani sepse ai nuk beson në parimet e Islamit. Mosbesimi i tij rrezikon ndodhjen e shkeljes të ligjeve islame, qëllimisht ose me mospërfilljen e tyre. Për këtë kusht nuk ka mospajtim mes juristëve myslimanë.

Sa i përket gjykatësit që do të merret ekskluzivisht me rastet që kanë të bëjnë me jomuslimanët, shumica e juristëve janë të mendimit që edhe ai duhet të jetë musliman, duke e konsideruar kushtin e Islamit të pajtërsueshëm në çdo rast. Juristët e shkollës juridike hanefite lejojnë që jomuslimani të emërohet në postin e gjykatësit që do të ushtron postin e tij në mesin e jomuslimanëve që jetojnë në shtetin Islam. Këtë qëndrim ata e argumentojnë me të drejtën e dëshmisë që e ka jomuslimani në shtetin Islam. Jomuslimani dëshmia e të cilit pranohet ka të drejtën e gjykimit, konstatojnë ata.

5. Gjinia mashkullore. Ky kusht është kualifikim i nevojshëm sipas mendimit të shumicës. Ata nuk e lejojnë që gruaja të emërohet në këtë post. Në rast të emërimit të gruas në këtë post, emëruesi i saj është mëkatar dhe emërimi anulohet. Vendimet e saj nuk pranohen edhe për çështjet për të cilët pranohet dëshmia e saj. Këtë qëndrim ata e argumentojnë me hadithin e të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: “Ka dëshuar populli që ka emëruar grua në postin e kryetarit”

Gjinisë femërore nuk i takojnë postet më të larta udhëheqëse sepse nuk është transmetuar që i dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e as kalifët e drejtë pas tij kanë emëruar ndonjë grua në këto poste. Po të ishte e lejuar një gjë e tillë do të përmendej.

Këtë qëndrim e mbështet edhe nevoja që gjyqtari të tubohet dhe përzihet me burra avokatë, palët në konflikt, dëshmitarë, gjë kjo e cila parimisht nuk është e lejuar për gruan për shkak të fesatit që mund të lind si pasojë e kësaj përzierje.

Juristët e shkollës hanefite lejojnë që gruaja të ushtron postin e kadisë por duke përkufizuar gjykimin saj në çështje që kanë të

bëjnë me krime për të cilët ka dënime të përcaktuara ose dënime që janë e drejtë ekskluzive e kadisë.

Ibën Xherir et-Taberiu gjininë nuk e konsideron kusht në këtë çështje. Sipas mendimit që ai mbanë, nuk ka dallim mes kadisë (gjyqtarit) që jep një vendim fuqplotë ligjor dhe juristit i cili jep mendimin e vet për ndonjë çështje ligjore. Pasiqë kjo e dyta është e lejuar për femrat atëherë dhe posti i kadisë është i lejuar për to. Këtë qëndrim e kanë edhe juristët e shkollës "Dhahirije".

6. Drejtësia (si cilësi morale). Shumica e juristëve këtë cilësi e konsiderojnë kusht për postet me peshë ligjore, poste autoritative. Kjo nënkupton zbatimin e obligimeve fetare, ndershmërinë, personalitet të fortë, largësi prej mëkateve dhe sjelljes së pahijshme, të jetë shembull i sjelljes së mirë në aspektin fetar si dhe konform normave sociale. Nuk lejohet emërtimi i personit të pamoralshëm në këtë post për shkak të besnikërisë e cila është kusht thelbësor për këtë post.

7. Kapacitet (aftësi) për arsyetim juridik. Ai duhet të jetë i aftë të merr ligjin prej burimeve të tij. Duhet të ketë dituri të mjaftueshme të Kur'anit dhe Sunnetit, të ketë aftësi të nxjerr dispozita të përgjithshme dhe të veçanta. Të shpjegon tekstet të paqarta (المتشابه) me tekste të qarta (المحكم) dhe të bëjë dallimin mes dispozitave të deroguar (المنسوخ) dhe deroguesve të tyre (الناسخ). Duhet të bëjë dallimin mes haditheve me vërtetësi dhe fuqi ligjore të padiskutueshme dhe ato që nuk i kanë këto cilësi si dhe të din të vlerëson zinxhirët e transmetuesve (الأسانيد).

Njohja e gjuhës arabe dhe njëzëshmërisë së dijetarëve (الإجماع) (ixhma, konsensusi) ose mospajtimet tyre, janë gjithashtu kushte themelore. Ai duhet të jetë i aftë për analogji në çështjet juridike.

8. Aftësi për perceptim të plotë. Ai duhet të ketë aftësitë e shikimit, dëgjimit dhe të folurit. Sipas shumicës këto janë kushte themelore. Mungesa e këtyre shqisave janë mangësi evidente në procesin gjyqësor që nuk kanë nevojë për shpjegim më të gjerë.

Shëndeti i përgjithshëm është gjë e pëlqyer por nuk është kusht për njeriun që ushtron postin e kadisë. Personi i shëndoshtë dhe pa mangësi të dukshme me siguri është me i përshtatshëm për këtë post. Sipas kësaj, personi i gjymtë, me gjymtyrë të amputuar, me një sy, më vështirësi në të folurin, dëgjimin dhe shikimin mundet të bëhet kadi nëse i posedon kualifikimet e tjera.

Është mirë të përmendim faktin që gjykatësi emërohet në këtë post nga autoritetet më të larta të shtetit dhe kjo ndihmon në rruajtjen e unitetit dhe parandalimin e grindjeve. Sipas kësaj nënkuptohet se posti i gjyqtarit është post politik që i përket autoritetit më të lartë politik. Nëse në një vend nuk ka autoritet politik (udhëheqës që është respektuar nga të gjithë) atëherë dijetarët e vendit emërojnë personin që ata e zgjedhin në postin e kadisë. Nëse më vonë instalohet pushteti politik atëherë ai vendos për fatin e kadisë të emëruar.

Lejohet që jurisdikcioni i kadisë të jetë i përgjithshëm për çdo vend dhe çështje gjyqësore ose të jetë jurisdikcioni i përkufizuar në një territor ose në disa çështje gjyqësore. Kufijtë e jurisdikcionit përcaktohen me kohë, vend dhe llojet e çështjeve gjyqësore.

Zgjedhi dhe përktheu: Talha Kurtishi  
IslamToday.net,  
17.6.2005

## Mësime nga surja El-Fatiha

Mirësitë e sures El-Fatiha janë të shumta , sikurse edhe gjërat që i vënë në pah mirësitë e saj janë të shumta, porse këtu do të përmendim disa prej tyre;

1- Është quajtur me emra të ndryshëm dhe çdo emër mban në veten e tij kuptim të cilin nuk e mbajnë emrat e tjerë, këto emra janë përmendur në Kur'an, Sunnet dhe në fjalët e shokëve të Pejgamberit sala All-llahu alejhi ue selem, si p, sh:

a- Nëna e Kur'anit: është quajtur me këtë emër sepse është përfshirë në të, në mënyrë të përgjithshme ajo çka ka përfshirë Kur'ani në mënyrë të shtjelluar, dijetari Ibën El-Kaj-jim, All-llahu e mëshiroftë, ka thënë: Kush e kupton këtë sure dhe qëllimet e saj, ka shpëtuar prej të kotës, dyshimeve dhe bidateve.

b- Baza e Kur'anit: është transmetuar ky emër prej Ibën Abasit, radija All-llahu anhu, dhe s'ka dyshim se surja El-Fatiha është baza e besimit (akides) dhe e gjithë mirësisë.

c- Shërim: sikurse është transmetuar nga Ebu Se'id El-Hudri, radija All-llahu anhu, se pejgamberi, sala All-llahu alejhi ue selem, e ka quajtur me këtë emër.

2- Është surja më e mirë dhe më madhështore në Kur'an, sikurse është përmendur në hadithin e saktë të cilin e ka transmetuar imam Ahmedi dhe El-Buhari, All-llahu i mëshiroftë, se Ebu Se'id El-Mual-la, radija All-llahu anhu, ka thënë: Isha duke u falur dhe më thirri i dërguari i All-llahut, sala All-llahu alejhi ue selem, nuk iu përgjigja derisa përfundova namazin, më pas i erdha të dërguarit të All-llahut, sala All-llahu alejhi ue selem, dhe më tha: "Ç'farë të pengoi të vije?" thashë: O i dërguari All-llahut isha duke u falur. Tha: " A nuk ka thënë All-llahu:

{O ju të cilët keni besuar përgjigjuni All-llahut dhe të dërguarit nëse ju thërret në çka u gjallëron} (jetën e zemrës dhe të shpirtit) më pas më tha: " Do të të mësoj suren më madhështore në Kur'an para se të dalësh prej xhamisë" më kapi për dore e kur deshi të dilte prej xhamisë i thashë: O i dërguari All-llahut ti më the: "Do të të mësoj suren më madhështore në Kur'an" tha: "Po, El-hamdu lil-lahi Rab-bil alemin, ajo është Shtatë ajetshja dhe Kur'ani i Madhëruar i cili më është dhënë mua".

3- Ajo është dritë e zbritur prej një porte prej portave të qiellit, e cila nuk është hapur vetëm se ditën kur ka zbritur kjo sure, bashkë me një melek (engjëll) i cili nuk ka zbritur prej qiellit kurrë, sikurse ka transmetuar imam Muslimi, nga Ibën Abas, radija All-llahu anhu, se ka thënë: Duke ndenjuri i dërguari i All-llahut, sala All-llahu alejhi ue selem, bashkë me Xhibrilin, dëgjoji zërin e një porte sipër tij, Xhibrili e ngriti shikimin e tij në qiell dhe tha: "Kjo është një portë që u hap prej portave të qiellit, nuk është hapur kurrë dhe një melek zbriti prej saj që nuk ka zbritur kurrë". Ai erdhi tek Pejgamberi, sala All-llahu alejhi ue selem, i dha selam dhe tha: "Përgëzohu me dy drita që të janë dhënë, nuk i janë dhënë asnjë Pejgamberi para teje: Hapja e Librit dhe mbyllëset e sures Bekare, nuk ke për të lexuar prej tyre ndonjë fjalë, vetëm se do të të jepet"

- Leximi i sures El-Fatiha në formën më të plotë, arrihet me tre gjëra:

a- Leximi i saktë sipas rregullave të leximit të Kur'anit.

b- Kuptimi i përmbajtjes dhe argumenteve të kësaj sureje.

c- Praktikimi i saktë dhe zbatimi i argumenteve dhe përbajtjes së kësaj sureje.

4- Duhet që muslimani gjatë leximit të kësaj sureje të përqendrohet në të si edhe gjatë leximit të gjithë Kur'anit dhe ta dijë se po lut All-llahun e Madhëruar, sikurse ka thënë dijetari Muhamed ibën Abdul Uah-hab, All-llahu e mëshiroftë: Meditova në lutjet e transmetuara prej të Dërguarit të All-llahut, sala All-llahu alejhi ue selem, dhe gjeta më madhështoren e tyre ti lutesh All-llahut të të udhëzoj, e kjo lutje ndodhet në suren El-Fatiha.

#### Mësimet e El-Fatihësë

1- Argumentimi i saj mbi teuhidin, shtyllat dhe llojet e tij.

"Falënderimi i takon All-llahut Zotit të botrave" botërat janë ç'do gjë përveç All-llahut, ky ajet është argument mbi teuhidin rububijeh.

"Mëshiruesi Mëshirëbërësi" dy emra prej emrave të All-llahut dhe emrat e All-llahut janë të gjitha të bukura, në këtë ajet ka argument mbi teuhidin esmau ue sifat (emrave dhe cilësive).

"Vetëm Ty të adhurojmë ..." ka thënë Ibën Abasi, radija All-llahu anhuma: "All-llahu, Posedues i adhurimit". Pra vetëm Ai e meriton të adhurohet, askush tjetër përveç Tij. Ky ajet është argument mbi teuhidin uluhijeh (e adhurimit).

Kush mediton në hapjen e Kur'anit dhe në mbylljen e tij do të shohë qartë se ai është hapur me tre llojet e teuhidit dhe është mbyllur po me tre llojet e teuhidit, ka thënë All-llahu i Madhëruar në suren En-Nas: "Thuaj, mbrohem me Zotin e njerëzve" argument mbi teuhidin rububijeh. "Sunduesin e njerëzve" argument mbi teuhidin esmau ue sifat. "Të adhurouarin e njerëzve" argument mbi teuhidin uluhijeh.

- Çdo adhurim ka nevojë për tre shtylla të cilat duhet të gjenden në zemrën e besimtarit:

1-Dashuria e All-llahut të Madhëruar.

2-Shpresimi tek shpërblimi i Tij.

3-Frika prej dënimit të Tij.

Të gjitha këto shtylla janë përmbledhur në fjalën e All-llahut të Madhëruar: "Të tillët (zotat) që këta po lusin (përveç All-llahut), vetë ata (zotat e tyre) kërkojnë afrim (tek All-llahu), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij. Vërtet dënimi i Tij është për t'iu ruajtur".

Kanë thënë selefët (të parët tanë): Kush e adhuron All-llahun vetëm me dashuri është zindik (1), ndërsa kush e adhuron All-llahun vetëm me shpresë është murxhi-ij (2), ndërsa kush e adhuron All-llahun vetëm me frikë është kharihi(3) dhe kush e adhuron All-llahun me dashuri, shpresë dhe frikë është besimtar.

- Këto tre shtylla të cilat e kanë vendin në zemër i ka përmbledhur surja El-Fatiha:

1- Dashuria; në fjalën e All-llahut të Madhëruar: "Falënderimi i takon vetëm All-llahu Zotit të botrave" kanë thanë dijetarët: Falënderimi është: Lëvdata mbi All-llahun e Madhëruar me dashuri, ndërsa nëse është pa dashuri nuk quhet falënderim, por quhet lavdërim.

2- Shpresa; në fjalën e All-llahut të Madhëruar: "Mëshiruesi Mëshirëbërësi" kush mediton në këtë ajet, patjetër që do të lëvizi në zemrën e tij shpresa (ose, ndjenja e shpresës) sikurse ka thënë All-llahu i Madhëruar: "Dhe shpresojmë tek mëshira e Tij".

3- Frika; në fjalën e All-llahut të Madhëruar: "Sunduesi i ditës së shpërblimit" kush mediton në këtë ajet do të lëvizi në zemrën e tij frika ndaj ditës së gjykimit.

Dhe mbas këtyre tre ajeteve ka ardhur fjala e All-llahut të Madhëruar: "Vetëm Ty te adhurojmë..." ky është edhe qëllimi kryesor dhe nuk është përmendur ky qëllim vetëm

se pas pohimit të këtyre shtyllave që u përmendën.

- Po ashtu kjo sure ka përfshirë dy kush-tet e pranimit të punëve, të cilat janë:

1- Sinqeriteti i adhurimit për All-llahun e Madhëruar, pa i bërë shok (ortak) Atij askënd, kjo në fjalën e All-llahut të Madhëruar: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë" kjo formë fjalie argumenton mbi kufizimin e adhurimit vetëm ndaj Allahut, adhurimi i cili nuk i takon vetëm se All-llahut të Madhëruar, po kështu edhe kërkitimi i ndihmës.

2- Ndjekja e Pejgamberit sala All-llahu alejhi ue selem, në fjalën e All-llahut të Madhëruar: "Na udhëzo në rrugën e drejtë" dhe rruga e drejtë nuk është vetëm se rruga e Pejgamberit, sala All-llahu alejhi ue selem, sikurse i ka thënë All-llahu i Madhëruar Pejgamberit alejhi selam: "Me të vërtetë ti udhëzon në rrugën e drejtë".

Kanë thënë dijetarët rreth fjalës së All-llahut të Madhëruar: "Na udhëzo në rrugën e drejtë" kjo është lutje dhe shpresë, duhet që robi mbas kësaj lutjeje të përdori të gjitha shkaqet që i mundësojnë të njihet me këtë rrugë të drejtë dhe më pas ta ndjek atë (pasojë) dhe ta praktikojë këtë rrugë të drejtë, sikurse ka thënë Pejgamberi, sala All-llahu alejhi ue selem: "Kujdesu (jepi rëndësi) ndaj asaj që të bën dobi dhe kërko ndihmën e All-llahut".

Bidatet nëse do të ishin prej rrugës së drejtë do ti kishte sqaruar ato Pejgamberi, sala All-llahu alejhi ue selem. Prandaj cili është qëndrimi i bidatçinjve karshi këtij ajeti? Kush mediton në këtë ajet do të nguli thellë në zemrën e tij sinqeritetin ndaj All-llahut në adhurim dhe pasimin e Pejgamberit sala All-llahu alejhi ue selem.

- Qartësimi i vlerës dhe gradës së duasë (lutjes), dukë vënë në pah se duaja është

çelës i çdo të mire, sikurse e kanë vënë në dukje këtë pikë dijetarët.

Njeriu edhe nëse e njëj rrugën e drejtë nuk ka mundësi ta ndjekë atë dhe të përqendrohet mbi të derisa ti vijë vdekja, vetëm nëse e udhëzon për tek ajo dhe i jep sukses Zoti i botrave. Prandaj duhet me patjetër që robi të kthehet tek All-llahu i Madhëruar me lutje dhe ta ndjejë veten të nevojshëm për këtë gjë, sikurse duhet ditur se Pejgamberi, sala All-llahu alejhi ue selem, gjithmonë i lutej dhe i kërkonte All-llahut ta udhëzonte dhe ta përqendronte mbi rrugën e drejtë.

- Kjo sure e lidh robin me All-llahun e Madhëruar dhe në të mëson edukatën e lutjes, sepse në këtë sure është paraprirë lutja me lavde mbi All-llahun e Madhëruar, sikurse ka transmetuar Pejgamberi sala All-llahu alejhi ue selem prej Zotit të tij në hadithin kudsij se All-llahu i Madhëruar ka thënë: "E ndava namazin (ka për qëllim suren El-Fatiha) mes Meje dhe robi Tim në dy gjysma dhe i jap robit Tim çka kërkon, kur thotë robi: "Falënderimi i takon vetëm All-llahut Zotit të botrave" thotë All-llahu: "Më falënderoi robi Im" kur thotë: "Mëshiruesi Mëshirbërësi" thotë All-llahu: "Më lëvdoi robi Im" kur thotë: "Sunduesi i ditës së shpërblimit" thotë All-llahu: "Më madhëroi robi Im" kur thotë: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë" thotë All-llahu: "Kjo është mes Meje dhe robit Tim dhe Unë i jap robi Tim çka kërkon" kur thotë: "Na udhëzo në rrugën e drejtë në rrugën e atyre të cilët i begatove me të mira, jo në rrugën e të hidhëruarve prej tyre dhe as të humburve" thotë All-llahu: "Kjo është për robin Tim dhe i jap robit Tim çka kërkon" transmeton imam Muslimi. Dijetari i Islamit Muhamed ibën Abdul-Uahhab, All-llahu e mëshiroftë, ka thënë: Tre ajete e gjysmë janë falënderim për

All-llahun, lëvdatë dhe madhështim për Të dhe tre e gjysmë janë lutje".

Dijetari i shquar Ibën El-Kaj-jim, All-llahu e mëshiroftë, duke na tërhequr vëmendjen në një kuptim madhështor ka thënë: Në çdo herë që lexon suren El-Fatiha përfiton tre herë që të të thërrasë All-llahu i Madhëruar "robi lm".

- Prej mësimëve të kësaj sureje janë; besimi në ditën e gjykimit, pejgamberët, caktimi i All-llahut (kaderi), njohja e robit Zotin e tij, njohja e robit vlerën e vetes së tij, etj, porse po mjaftohemi me kaq sa përmendëm dhe falënderimi i takon All-llahut Zotit të botrave, paqja dhe bekimet e Tij qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen e tij dhe mbi gjithë shokët e tij.

Profesor Doktor Abdurr-Rraz-zak ibën Abdul Muhsin El-Ab-bad

Përktheu:

Ebu Hudhejfe El-Medenij

Shënime të përkthyesit:

Ky material është përmbledhje e ligjëratës me të njëjtin titull, e mbajtur nga shejhu jonë, Profesor Doktor Abdurr-Rraz-zak ibën Abdul Muhsin El-Ab-bad, All-llahu e ruajt dhe i dhëntë sukses. Profesor në Universitetin Islamik, në Medine.

1-Zindik: më shpesh që gjendet përdorimi i kësaj shprehjeje në fjalën e dijetarëve, kur flitet për kokat e bidatit, ndërsa disa dijetarë e kanë përdorur në vend të fjalës Munafik dhe është thënë rreth tij; ai që hyn në fe për të prishur në të. Në pranimin e pendimit të tij ka dy mendime dijetarësh, por vepra e Ebu Bekrit tregon se i pranohet duke qenë nën mbikëqyrje, sesi do të jetë puna e tij pas pendimit.

2-Murxhi-ij: është ai person që thotë se gjynahet nuk e dëmtojnë personin përderisa është besimtar dhe se ai është i barabartë në besim me Xhibriilin alejhi selam dhe Ebu Bekrin, besimi nuk shtohet dhe as nuk pakësohet dhe se punët e mira nuk janë prej besimit (imantit).

3-Kharixhij: është ai që thotë se kush bën një gjynah prej gjynaheve të mëdhaja del nga feja dhe është i përhershëm në zjarrin e xhehenemit nëse nuk pendohet, ose del kryengritje kundër prijësve (pushtetarëve) musliman, për shkak të prishjes që kanë ata dhe padrejtësisë që bëhet prej tyre.

24.6.2005

## Qypi me lira

Transmetohet nga Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: Një njeri e ka blerë një truall, por duke punuar e ka gjetur një qyp me ari. Pastaj shkoi te shitësi i trollit dhe i tha merre arin, se unë e kam blerë vetëm trollin e jo edhe arin. Shitësi tha unë ta kam shitur trollin dhe çka ka në te. Pasi që nuk ranë në dakord në asnjë mënyrë atëherë shkuan te një njeri i mençur që të gjykojë mes tyre. Pasi ia treguan rastin ai i pyeti a keni fëmijë? Njëri tha unë kam një djalë, e tjetri tha unë kam një vajzë e ai tha: Kurorëzoni ata dy e le ta gëzojnë këtë pasuri. (shih. Sahihul Buhari 6/375, si dhe Muslim nr.1721.)

Çka nënkuptojmë nga ky hadith:

1- Kryerja e amanetit është e detyrë e patjetërsueshme duke u bazuar në ajetin kur'anor: " Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre .." (en-Nisa, 58)

2- (kanaa) është depo e cila nuk humbet. Por, ajo i kthehet me të mira pronarit të saj.

3- Për çdo problem duhet që të gjykojmë me Kur'an dhe sunet, pa mos shkuar në organet shtetërore që nuk gjykojnë sipas Kur'anit dhe sunetit të Muhamedit, alejhis-selam.

Për këtë Allahu, subhanehu ve teala, thotë: 'Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtroni atë te Allahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari ..'

4- Kush është i kënaqur me atë që ia ka dhënë Allahu ai është më pasaniku prej njerëzve duke u bazuar në fjalët e të Dërguarit të Allahut, ku thotë: Pajtohu me atë që ta ka dhënë Allahu do të jesh më pasaniku prej njerëzve (transmeton Ahmedi) si dhe hadithi tjetër ku thotë: Nuk është pasanik ai që ka shumë tokë. Por pasanik është ai i që ka zemrën e pasur. (Buhari dhe Muslimi )

5- Risku është i caktuar. Ai doemos do të arrijë tek ty në kohë dhe shumë të caktuar. Muhammedi, alejhis-selam, thotë: "Nëse biri i Ademit ik prej riskut siç ik prej vdekjes do ta arrij atë sikur që e arrin vdekja ." hadithin e ka vërtetuar ibën Hibani, ndërsa Albani e vlerëson hasen në silsiletus-sahiha)

6- Muslimani duhet që të kënaqet me atë që është hallall e ta lërë atë që është e ndaluar, dhe të kapet për shkaqet që janë për të arritur deri te risku, dhe ta dijë se vepra e mirë do ta bëjë atë të kënaqur në këtë botë dhe në botën tjetër. Muhamedi, alejhis-selam, thotë: "Frikohuni Allahut dhe kërkoni riskun në mënyrë më të mirë " (Albani e vlerëson sahih)

7- Gjykimi i drejtë i pajton të dy palët që gjykohen.

8- Mos me i lakmu gjërat që nuk janë për njeriun.

Muhamed Xhemil Zejno

Përktheu: Enver Azizi

Marrë nga: Mexhmuatu resailit-tevxhihat el islamije  
1.7.2005



## Sukseset dhe arritjet e grave të para muslimane

Sahabijet (gratë e para muslimane) ishin gra të ndershme të cilat ishin bashkëkohëse të Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ato ishin të pastra, virtytshme dhe ishin të nderuara gjatë jetës së Pejgamberit Muhammed, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Sukseset dhe influenca e tyre gjendet gati në çdo sferë të asaj periudhe monumentale në historinë e botës, kur i tërë njerëzimi u ndryshua përgjithmonë. Ato ishin aktive në fe ashtu edhe në politikë, guximtare në luftë sa dhe po aq thirrëse të palodhura i mësimëve islame në kohëra paqejë. Këto gra të ndershme mund të gjendeshin në fushë beteja midis rangjeve të atyre që merrnin pjesë në xhihad. Ata mund të gjenden në arenën politike, në fushën e edukimit, në kopshtet e juris-pundencës islame, në interpretimin e Sheriatit, në tregti dhe biznes, në agrikulturë, në mjekësi dhe infermieri. Shkurtimisht nuk ka asnjë sferë që ato nuk përvetësuan nga intelekti i tyre, urtësia e tyre dhe karakteri i fortë i tyre.

Midis shumë shërbimeve që dikush mëson në islam është lufta në fushëbetejë. Ka pak, nëse ka ndonjë, shembull të tillë zellshmërie, përkushtimi, insistimi dhe guximi që mund të gjendet në histori. Kur jobesimtarët sulmuan muslimanët gjatë luftës së Uhudit, vetëm disa ndjekës të devotshëm qëndruan të luftojnë me të dërguarin e Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Në këtë etapë kritike sahabija Ummi Ammara, radijallahu anha, e mbuloi me trupin e saj dhe e përçori armikun me

shpatën e saj gjithashtu me shigjetën dhe shtizat e saja. Kur Kaniah zuri pozicion për tek Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ajo mori barrën e sulmit të tij. Ajo kishte një plagë të thellë në shpatullën e saj, dhe ajo vazhdoi ta sulmojë atë me shpatën e saj. Por edhe ai u kthye në mbrojtje dhe ajo nuk mund ta dëmtonte mburojën e tij. Kundër Musejmetul Kedh'dhabit ajo luftoi me aq guxim sa që ajo pësoi dymbëdhjetë plagë dhe humbi një krah.

Në luftën e Ahzabit, sahabija Safija, radijallahu anha, shfaqti një strategji të shkëlqyeshme në përballimin e sulmit çifut dhe vrau njërin nga çifutët në dyluftim. Në luftën e Hunejnit Umm Selim, radijallahu anha doli për ta sulmuar armikun me shpatën e saj.

Në luftën e Jermukut, Esma bint Ebu Bekër, Umm Abban, Umm Hakim, Havla, Hind dhe Nëna e besimtarëve Xhuvëjrija, radijallahu anhunne, treguan një guxim të jashtëzakonshëm. Esma bint Jezid, radijallahu anha vrau nëntë ushtarë armiq. Në vitin 28 hixhri, Umm Haram, radijallahu anha mori pjesë në luftën e Qipros.

Nëna e besimtarëve Aisha, Umm Selim dhe Umm Selit,, radijallahu anhunne, ishin midis atyre që ishin të famshme për mjekimin e plagëve.

Sahabijet zakonisht e shoqëronin Resulullahun, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në ekspeditat ushtarake dhe morën pjesë në luftërat në tokë dhe det. Përkrah pjesëmarrjes aktive në luftë, kishte shumë shërbime që

sahabijet kryenin, si dhënia e ndihmës mjekësore ushtarëve, duke mjekuar plagët dhe duke furnizuar me ushqime dhe ujë të plagosurit dhe të eturit. Ndiemon duke i dhënë atyre shtiza, duke i mjekuar dhe ndihmuar në mënyrë të përgjithshme moralin e ushtrisë. Ata gjithashtu ndihmonin të mbanin dëshmorët dhe të plagosurit për kthim në Medine. Umm Atije, radijallahu anha, mori pjesë në shtatë luftëra dhe luftoi gjatë sundimit të halifit Omar el-Faruk, radijallahu anhu, gratë dhe fëmijët ndihmonin të varrosnin të vdekurit.

Ata e përhapën mesazhin e fesë së re dhe përmes shembullit konvertuan shumë jobesimtarë në islam. Ishte Fatima bint Hattab, radijallahu anha e cila konvertoi vëllain e saj Omer ibën Hatab, radijallahu anhu, i cili u bë një nga besimtarët më të guximshëm nga sahabet e Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ishte Umm Selim, radijallahu anha e cila e influenoi Ebu Talhan, radijallahu anhu të pranonte islamin dhe ishte Umm Hakim, radijallahu anha, e cila e bindi të shoqin e saj, Ikrimen të pranojë islamin. Umm Sherek, radijallahu anha, më mënyrë shumë diskrete punoi midis grave të fiseve Kurejshe për të përhap islamin.

Një tjetër aspekt i punës së davetit ishte mbrojtja e fesë në formën e saj të pastër, duke e mbrojtur atë nga modifikimet, papastërtia dhe bidatet që mund të hynin për shkak të praktikave kulturore dhe tradicionale (po ashtu edhe njerëzve të prishur të cilët shpiknin hadithe ose krijonin gjëra të reja në fe). Kjo ishte një punë shumë e rëndësishme për të ruajtur pastërtinë e islamit që u krye nga shumë sahabije, më e famshmja ndër to është Aisha, radijallahu anha. Në vitin 35 hixhri, kur halifi Othman, radijallahu anhu, ra dëshmorë dhe kishte kaos dhe konfuzion mbi cilin do të binte udhëheqja,

ishte ajo që solli bashkimin në rragjet e muslimanëve duke i influencuar muslimanët e Basrasë dhe Mekës.

Prija në namaze dhe thirrja e Ezanit, ose lkameti është një tjetër aspekt i jetës fetare. Megjithëse gratë nuk mund t'i prijnë burrave, ato mund të veprojnë kështu me grumbujt e grave. Shumë gra bashkëkohohase të Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e kanë kryer këtë detyrë shumë mirë. Aisha, Umm Selim, Umm Varaka dhe Sa'da bint Kema-mah, radijallahu anhunne, ishin disa më të shquarat nga këto. Në fakt, Umm Varaka, radijallahu anha, e ktheu shtëpinë e saj në vend faljeje për gratë, Ezani u bënte nga një muezin për xhematin e grave dhe Umm Varaka, radijallahu anha, kryente detyrën e Imamit në prirjen e faljeve.

Sahabijet luajtën një rol të rëndësishëm gjithashtu edhe në politikë. Halifi Omar, radijallahu anhu, e vlerësoi aq shumë Shifah bint Abdullah, radijallahu anha. Inteligjencën e saj politike dhe pikëpamjet ashtu që shpesh konsultohej me të. Ai shpesh i jepte asaj përgjegjësinë e mbarëvajtjes së punëve të shtetit porsa i përket tregtisë dhe biznesit. Përpara Hixhretit të Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, jobesimtarët dëshironin të bënin një rrethim shtëpisë së tij, Rukuejha bint Seifi, radijallahu anha, e paralajmëroi atë. Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, pastaj në mënyrë të fshehtë u largua nga Meka, duke e lënë Aliun, radijallahu anhu të flinte në vend të tij. Të drejta shumë të gjëra politike i u janë të garantuara grave në islam. Një grua madje ka të drejtën e dhënies strehim të një armiku, nëse ajo dëshiron kështu. Ebu Daudi transmeton që Umm Hani, radijallahu anha, motra e Aliut, radijallahu anhu, i dha strehë një armiku dhe Resulullahu, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Nëse i ke garantuar siguri dhe strehim dikujt, atëherë ne qëndrojmë me ty”.

Ky është ligji islam që Imami ose lideri duhet të marrë garancinë që ofrohet nga një grua.

Ka subjekte të ndryshme, një të kuptuar të të cilit janë shumë themelore për një dije islame dhe parimeve të saja. Kira't, interpretimi dhe komentimi, Sheriati, Fikhu, studimi i hadithit, të gjitha këto janë aspekte politike të studimeve islame. Shumë gra sahabije ishin eksperte në këto fusha. Aisha e ka memorizuar Kur'anin ashtu siç bëri edhe Hafsa, Umm Selmah, Umm Varaka, radijallahu anhunne. Hind bint Asid, Umm Hisham bin Harithah, Zeidah bint Hejan, Umm Sa'ad bint Sa'ad, radijallahu anhunne, të gjitha dinin pjesë nga Kur'ani përmendësh. Më vonë jepnin ligjërata mbi Kur'anin. Në interpretimin shumë delikat të hadithit, të gjitha ishin eksperte, por Aishah dhe Umm Selma, radijallahu anhum, ishin të veçanta më interpretimin dhe komentimin e haditheve. Aisha transmetoi 2,210 hadithe dhe më pas Umm Selma me 378 hadithe.

Aisha, radijallahu anha, ishte një eksperte mbi interpretimin dhe komentimin e hadithit përshkak të shoqërimit të ngushtë me Resulullahun, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Shumë prej librit të Tefsirit në Sahih Muslim përbajnë transmetime nga ajo.

Gjithashtu Esmā bint Ebu Bekër (motra e Aishes), Umm Atijah, Umm hani dhe Fatimah bint Kajs, radijallahu anhunne, kishin një dituri të gjerë të hadithit.

Në jurisprudencën islame ose fikhun e Aisha-s, radijallahu anha mund të mbushen volume të tëra. E njëjta gjë mund të thuhet për verdiktet e regjistruara të Umm Selmës.

Verdiktet (fetvatë) e Sefija-s, Hafsas, Umm Habibas, Xhujerias, Fatimes, Umm Sherek, Umm Atije, Esmā bint Ebu Bekër, Lejla bint

Hajf, Havla bint Tujeit, Ummi Darda, Athika bint Zeid, Sehla bint Sulejl, Fatimah bint Kajs, Zejneb bint Xhahsh, Umm Selma, Umm Ejan, Umm Jusuf mund të mbushnin volume të tëra.

Aisha, radijallahu anha, ishte gjithashtu e përgatitur në ligjet e trashëgimisë dhe shumë sahabe të famshëm dhe të nderuar u konsultuan me të mbi pikat më delikate të ligjit.

Krahas të qënurit mjeshtre të ligjit islam dhe pikave kyçe të fikut, sahabijet kishin aftësi dhe përvojë në degë të tjera të dijes. Asma bint Jezid bin Seken, radijallahu anha, ishte një eksperte në oratori ose ligjërimit, Esmā bint Umeis, ishte e famshme për interpretimin e saj të ëndrrave. Disa sahabije ishin të dalluara për aftësitë e tyre në mjekësi dhe kirurgji. Eslamije Umm Matta, Umm Habshe, Hanan bint Xhahsh, Muathah, Ammeimah, Umm Ziad, Rabie bint Muauath, Umm Atijah, Umm Selim, radijallahu anhunne, ishin disa prej tyre, të mirënjohura për përvojën e tyre. Tenda e Rufejde Eslamijes, radijallahu anha, u rregullua si një sallë kirurgjike me të gjitha instrumentet e nevojshme, e cila ishte e lokalizuar afër xhamisë së Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në Medina. Artet nuk u nënvlerësuan aspak. Disa nga poetet me të dalluara ishin, Sa'adi, Sefija, Atika bint Zaid, Hind bint Athathah, Umm Eiman, Kabashah bint Rafia, Ummamah Meridia, Hind bint Harith, Zeineb bint Auam Azdi, Mejmunah dhe Rukejah, radijallahu anhunne. Një libër i vargjeve nga Hansa, radijallahu anha, më e mira nga të gjitha, tani më është publikuar.

Sahabijet gjithashtu merreshin me praktika ose aftësi mbijetuese siç ne i njohim ato sot. Agrikultura, biznesi, tregtia, shkrimi, industria e pëlhurave, prodhimi dhe stili i veshjeve, të gjitha këto janë të përmendura

në Musned (koleksioni i haditheve) të Imam Ahmedit. Agrikultura nuk ishte edhe aq e njohur por praktikohet në vende rurale si në Medina, veçanërisht nga gratë e ensarëve . Midis muhaxhirëve, Esma, gjithashtu merrej me bujqësi. Koha para ardhjes së Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishte e njohur si koha e analfabetizmit por disa nga këto gra të ndershme ishin shumë të edukuara dhe të afta në artet e pendës dhe kaligrafisë. Shifa bint Abdullah, radijallahu anha, mësoi të lexonte dhe të shkruante madje edhe në kohën e injorancës dhe ishte shumë e njohur për aftësitë e saja në këtë art. Hafsa, Umm Khulthum bint Ukbah dhe Kerime Mikdad, radijallahu anhone, ishin të gjitha analfabete. Aisha dhe Umm Selma, radijallahu anhuma nuk mund të shkruanin por dinin të lexonin. Të dyja ishin të begatuara me memorje të jashtëzakonshme dhe përshkak të afërsisë me Resulullahun, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ato transmetuan shumë hadithe. Disa nga sahabijet gjitha-

shtu drejtonin biznese. Hatixheja, radijallahu anha ishte një tregtare shumë e sukseshme dhe dërgonte karvanë në vende të ndryshme. Havla, Melika, Thekafije dhe bint Faharije, radijallahu anhone, merreshin me tregtimin e parfumeve orientale të njohura si Itar. Savda, radijallahu anha, drejtonte një industri të përpunimit të pëlhurave. Vjzat e ensarëve shkruanin vargje dhe poema për rastet festive dhe i këndonin. Sipas hadithit të transmetuar nga Fri'ah bint Ma'auth, radijallahu anha, ata i recitonin poemat e tyre në prezencën e Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i cili pëlqente aftësitë e tyre në poema dhe poezi.

Ummi Selma, radijallahun anha, recitonte Kur'an me Texhvid, e cila ishte një aftësi e vështirë por edhe shumë e pëlqyer.

Kështu që nuk ka sferë aktiviteti, shoqërore dhe kulturore, e cila nuk është influencuar dhe e ndihmuar nga prezenca e këtyre zonjave të mëdha. Allahu i begatofte shpirtrat e tyre.

Mahmud Ahmed Gadanfar,  
Përktheu: Ammar Ardit Kraja  
10.6.2005

## Përzierja mes burrave dhe grave

Termet "përzierje" dhe "ngjeshje" janë të përdorura vazhdimisht në diskutimet mbi subjektin e marrëdhënies meshkuj-gra në islam por këto terma nuk u përdorën në kohën kur u shpall Kur'ani. Për këtë arsye, ne nuk mund të gjejmë referenca direkte në Kur'an dhe Sunnet që të thonë: "përzierja e lirë midis burrave dhe grave është e pajlejuar". Megjithatë, kjo nuk do të thotë që një sjellje e tillë është e lejueshme ose që

islami ka dështuar ta trajtojë çështjen. Islami e ka trajtuar në detaje marrëdhëniet midis burrave dhe grave në mënyrën më precize dhe me terma ekzakte. Islami ka vendosur udhëzime të qarta për të treguar sesi burrat dhe gratë duhet të sillen me njëri-tjetrin. Nga e gjitha kjo, nuk ka më dyshim se Islami e ndalon përzierjen e lirë të burrave dhe grave.

Nëse ne shikojmë në çdo varg të Kur'anit në kërkim të një dëshmie direkte që e ndalon një fëmijë për të rrahur prindërit e tij, ne kurrë nuk do ta gjejmë. Nuk është aty. Megjithatë, Kur'ani thotë: "Mos i thuaj atyre as "uff"". A mundet që një person i arsyeshëm pasi e dëgjon këtë varg e pastaj të thotë që është e lejueshme për një djalë të rrahë nënën dhe babain e tij?

Po kështu, islami e ka ndaluar një grua që të parfumohet kur ajo kalon pranë burrave. E ka ndaluar atë t'i kërcasë këmbët e saja në tokë kur ajo ecën. A mundet ndonjëri, pasi i konsideron këto dhe shumë gjykime të tjera, të supozojë se gratë dhe burrat janë të lejuar të përzihen dhe të ngjeshjen lirisht me njëri-tjetrin?

Tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit janë të kufizuara në numër. Nëse ne do të abstenojmë nga ndalimi i çdogjjeje që nuk është në mënyrë direkte e thënë me fjalë në tekste, ne do të refuzonim vlefshmërinë e arsyetimit analog në ligjin islam. Kjo do të linte çështje të panumërta të jetës pa një gjykim ligjor islam. Kjo do t'i shqyente ligjit islam një nga cilësitë më të mëdha, e cila është aplikimi i tij mbi të gjitha kohërat dhe rrethanat.

Ajo që është e qartë nga tekstet është që islami nuk i lejon burrat dhe gratë për ta takuar njëri-tjetrin kudo dhe sido që të duan. Ai ka vendosur rregulla të qarta dhe kufizime mbi të tilla sjellje dhe i ka përkufizuar limitet e bashkëveprimit midis burrave dhe grave. Më tepër se kjo, Islami i ka mbyllur të gjitha dyert që çojnë në ngacmime dhe fitne.

Kur ne i shohim të gjitha ligjet që kanë lidhje me marrëdhëniet midis burrave dhe grave në islam, ne jemi të detyruar të vijmë tek përfundimi që islami ndalon çdo përzierje midis gjinive, e që mund të ofrojnë edhe mundësinë më të pakët për të rënë në ngacmime. Dijetarët e islamit përmes historisë e

kanë kuptuar këtë fakt plotësisht. Ne mund ta shohim të evidentuar në shkrimet e juristëve të mëdhenj:

Serahsi shkruan: "Gjykatësi duhet t'i gjykojë gratë në ehte pa burrat përderisa njerëzit janë të prirur për tu grumbulluar në gjykatë. Është krejtësisht e qartë që përzierja midis burrave dhe grave nën të tilla kushte nga grumbullimi çon në ngacmime dhe të tjera rrjedhoja shkatërruese". [el-Mebsut (16/80)]

Nevevi shkruan: "Ibën Mundhiri dhe të tjerë mbajnë mendimin që është një çështje ku ka konsensus që gratë nuk janë të obliguara për të marrë pjesë në faljet e xhumave. Megjithatë, argumenti i tij sepse kjo çon rreth përzierjes së grave dhe burrave nuk është korrekt. Pjesëmarrja e grave në faljet e xhumave nuk sjell domosdoshmërisht një përzierje të tillë përderisa gratë qëndrojnë prapa burrave". [el-Maxhmu (4/350)]

Nevevi shkruan: "Një ndër bidatet e ulëta që disa injorant janë të angazhuar sot është ndriçimi i qirave mbi malin e Arafatit në natën e nëntë. Kjo sjellje është tepër e ç'udhëzuar dhe është plotë shkuarje-vajtje të gabuara siç është përzierja midis burrave dhe grave". [el-Mexhmu (8/140)]

Në librin e titulluar el-Fevakih el-Davani, gjendet një diskutim se kur është e lejuar për të refuzuar një ftesë tek një dasmë. Thuhet: "Një ftesë mund të refuzohet nëse ka gabime të qarta në dasmë, si përzierja midis burrave dhe grave". [el-Thamar el-Dani (2/322)]

Kur dijetarët paralajmërojnë kundër përzierjes midis burrave dhe grave, ata nuk janë duke folur vetëm rreth prezencës së burrave dhe grave së bashku në të njëjtin vend. Kjo është diçka që nuk është e ndaluar përfundimisht nga ligji islam. Burrat dhe gratë që grumbullohen në të njëjtin vend në kohën e

Pejgamberit, salallahu alejhis ve sel-lem, në xhami dhe treg. Ata ecnin në të njëjtat rrugë dhe vende publike.

Prezenca e vetme e burrave dhe grave në të njëjtën zonë nuk është një shkak i madh për ngacmim. Do të ishte gabim për ta trajtuar këtë si përzierje të palejuar përderisa arsyeja për ndalimin e përzierjes së lirë nuk ekziston në rrethana të tilla. Nëse dikush do t'i ndalonte burrat dhe gratë nga frekuentimi i të njëjtit vend publik nën pretekstin e pengimit të ngacmimeve, kjo do t'i çonte çështjet në një ekstrem dhe do të impononte një kufizim i cili është panevojë i ashpër. Një politikë e tillë është megjithatë jonatyrale dhe do të impononte vështirësi shumë të mëdha mbi jetët e njerëzve.

Në të njëjtën kohë, ka rrethana që askush nuk mund t'i kundërshtojë që janë raste të përzierjes së palejuar. Kjo do të përfshijë situatat ku gratë dhe burrat janë të grumbulluar aq shumë sa që ka një rrezik për të pasur një kontakt fizik. E njëjtë me këtë do të jetë rasti ku gratë dhe burrat të cilët nuk janë të afërt të cilët ulen afër njëri-tjetrit. Në të tilla situata, dëshirat ndizen dhe ngacmimet janë më të mëdha dhe gjëra të këqija ndodhin, ashtu siç është parë aty dhe atje në shkollat dhe ngjarjet shoqërore dhe publike, të përziera.

E njëjta mund të thuhet për çdo takim të përsëritur midis burrave dhe grave. Takimet e përsëritura thyejnë barrierat midis burrave dhe grave dhe lejojnë një marrëdhënie që të zhvillohet midis tyre.

Ne nuk mund t'i krahasojmë situatat si këto me prezencën e burrave dhe grave në dyqane dhe vende të tjera publike, veçanërisht kur gratë shoqërohen nga familjarët e tyre. Në raste të tilla, nuk ka intimitet, s'ka grumbullime, dhe nuk ka arsye për dyshime. Pengimi i grave nga vendet publike që fre-

kuentohen nga burrat në mënyrë që të pengohet ngacmimi do t'i çonte gjërat në një ekstrem.

Një grua është e urdhëruar në Islam të mos i afrohet burrave. Ajo, megjithatë, nuk është e ndaluar për të shkuar në ato vende ku ka burra, deri sa ajo nuk i afrohet atyre ose nuk e vendos veten në një pozitë ku ajo është vetëm me ata.

Nuk ka dyshim që legjislacioni parandalues është një pjesë e rëndësishme e ligjit islam. Ka shumë gjykime në islam që janë parandaluese në natyrë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ne mund të nxjerrim ligje kundër çdo mundësie për të rënë në gabim që ne mund të mendojmë. Veprimi në këtë mënyrë do të ishte në kundërshtim me tolerancën islame dhe lehtësinë e aplikimit. Do të vinte një barrë shumë të madhe mbi besimtarët.

Njerëzit mund të ndryshojnë në nivelin e përzierjes që është e ndaluar. Ne megjithatë mund të vendosim afërsisht limitet e sakta të shikuara të ligjeve islame që kanë lidhje me marrëdhëniet midis njerëzve dhe grave. Tekstet e shenjta ofrojnë fakte të bollshme porsa i përket mënyrës sesi gratë dhe burrat mund të takohen me njëri-tjetrin, sesi gratë duhet të vishen dhe sesi ato duhet të sillen kur ato dalin nga shtëpia dhe shumë çështje të tjera. Do të jetë e pamundshme për përzierje të lirë midis burrave dhe grave nëse ligji islam aplikohet në mënyrë korrekte.

Gjenden fakte të bollshme që tregojnë se gratë dhe burrat nuk duhet të përzihen lirisht. Ne vetëm do të përmendim disa prej tyre:

1. Allahu thotë: "E kur kërkoni prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkoni pas perdes, kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre". [el-Ahzab: 53] Gratë të cilat dalin jashtë të pambuluara në

shoqërinë e njerëzve janë padiskutim duke dhunuar rëndë urdhrin e dhënë më lart në këtë varg kur'anor.

2. Është e ndaluar për burrat që të bashkohen me gratë në një vend në mungesë të të paktën të njërit nga të afërmit e saj meshkuj. Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, i ka ndaluar burrat dhe gratë nga të qenurit së bashku. Ai ka thënë: “Kurrë nuk ka një njeri vetëm me një grua përveç që shejtani të jetë i treti me ta”.

Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, gjithashtu ka thënë: “Mos hyni në shoqërinë e grave”. Një njeri pastaj e pyeti: “Si është puna me të vëllanë e të shoqit? Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, ju përgjigj: “Vëllai i të shoqit është vdekje (rrezik sa edhe vdekja)”.

Ky hadith thekson rëndësinë e të qënurit i kujdesshëm ndaj vëllezërve (nga ana e burrave) përderisa ata kanë më shumë mundësi për të qenë vetëm me gruan dhe ta shohin atë në atë mënyrë që të tjerët nuk e kanë mundësinë.

Takimi i fshehtë midis një burri dhe një gruaje të pashoqëruar është një nga format me serioze të përzjerjes që mund të ndodh midis sekseve. Ngacmimet janë më të këqijat kur njerëzit e dinë që ata janë të fshehur nga sytë e njerëzve të tjerë.

Ibën Dakik el-Id ka thënë të mëposhtmen: “Ne duhet të marrim në konsideratë nëse të shkuarit në një vend e një burri sjell një situatë ku ai është vetëm me gruan. Nëse ndodh kështu, atëherë nuk lejohet për atë të shkojë atje”. [2/181]

Kjo pikë është bërë e qartë nga Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, kur ai ka thënë: “Asnjë burrë nuk duhet të hyjë në prezencën e një gruaje pas kësaj dite përderisa ai është i shoqëruar nga një apo disa burra të tjerë”. [Sahih Muslimi]

3. Ka shumë fakte të shumta që gratë nuk duhet të japin duart burrave me të cilët nuk janë të afërt.

Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, asnjëherë nuk i ka dhënë dorën një gruaje e cila nuk ka qenë e afërt me të. Umejmah bin Rakikah ka thënë: “Unë erdha tek Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, me një grup të grave nga Medina për tu betuar për Islam. Gratë e informuan të dërguarin e Allahut, salallahu alejhis ua selam, që ata dëshironin të betoheshin tek ai. Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, ka thënë: “Unë nuk ja jap dorën grave. Mënyra sesi unë pranoi betimin nga një grua është e njëjtë siç është me njëqind gra”. [El-Mu-uata, Sunan el-Tirmidhi, Sunan el-Nesai dhe Sunan Ibën Maxhe]

Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, ka thënë gjithashtu: “Është më mirë për një nga ju për të shpuar kokën e tij sesa të prekë dorën e një gruaje të huaj”. [El-Mundhiri përmend që të gjithë transmetuesit të këtij hadithi janë të besueshëm. El-Albani e klasifikon si një hadith të mirë në Gajati el-Maram (nr. 403)]

4. Kur'ani qartësisht i ndalon gratë për ta përdredhur zërin kur flasim me burrat. Allahu thotë: “O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse keni kujdes e ruheni, andaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thuani fjalë të matura”. [Surah el-Ahzab: 32]

5. Ka fakte që gruaja nuk duhet të ulet me një të huaj ndërsa është e parfumosur. Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, ka thënë: “Secila grua e cila vë parfum e pastaj del dhe kalon pranë disa burrave që kështu ata ta ndiejnë erën e saj është një lloj zinaje”. [Musned Ahmed, Sunan el-Tirmidhi, Sunan

Abu Davud dhe Sunan el-Nesai me një zingjir transmetimi të mirë]

6. Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, ka thënë: “Rreshtat më të mirë në falje për burrin është rreshti i parë dhe më i keq është i fundit dhe më i miri për gratë është i fundit dhe më i keq është i pari”. [Sahih Muslimi]

Nëse kjo këshillë i jepet burrave dhe grave kur ata janë në gjendjen e tyre më të pastër dhe të angazhuar në falje, kuptoni si duhet ata të sillen në situata tjera të ndryshme.

Ibën Abbasi transmeton që ai ka falur një nga faljet e bajramit me Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam. Ai na informon që Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, u fal dhe mbajti një hutbe, pastaj ai shkoi tek gratë dhe mbajti një hutbe të veçantë për to, duke i kritikuar ata dhe duke i inkurajuar ata për të dhënë në bamirësi”. [Sahih el-Buhari]

Ibën Haxheri shkruan këtë në lidhje me hadithin: “Fakti që ai shkoi tek gratë në veçanti tregon që gratë ishin të grumbulluara në veçanti nga burrat dhe nuk ishin të përzier me ta”. [Feth el-Bari (2/466)]

7. Njëherë Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, pa burra dhe gra të përzier bashkë në rrugë në nisjen e tyre nga xhamia. Ai i ka thënë grave: “Ndaluni pak. Ju nuk duhet të ecni në mes të rrugës. Ju duhet të ecni anash”. Transmetuesi i hadithit ka komentuar që pas asaj kohe, gratë do t'i ngjesheshin aq afër ndërtesave sa që veshjet e tyre ngandonjëherë do të fërkonin muret”. [Sunan Ebu Davud me një zingjir transmetimi të mirë]

Ibën Omeri ka transmetuar që Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, ka thënë për njëherë nga dyert e xhamisë: “Ne duhet ta lëmë këtë derë veç për gratë”. Ibën Omeri, derisa vdiq, kurrë nuk hyri përmes asaj dere. [Sunan Ebu Davud me një zingjir transme-

timi të mirë. El-Albani ka thënë: “Ky hadith është autentik sipas kushteve të vendosura nga Buhari dhe Muslimi]

Ummu Selame ka thënë: “Kur Pejgamberi, salallahu alejhis ua selam, mbaronte faljen, gratë do të çoheshin për tu larguar. Ai pastaj do të priste pak përpara se të ngrihej. Ibën Shahab ka thënë: “Unë besoi që ai priti për pak për t'i dhënë mundësi grave për të dalë para burrave”. [Sahih el-Buhari]

Ibën Haxheri ka thënë: “Në hadith, ne shohim që nuk është e pëlqyeshme për burrat dhe gratë për tu përzier në rrugë. Sa më shumë atëherë, një përzierje e tillë duhet të shmanget brenda shtëpive”. [Feth el-Bari (2/336)]

8. Është e transmetuar që kur gratë në kohën e Pejgamberit, salallahu alejhis ua selam, nuk rrotulloheshin rreth Kabes përkrah burrave. Aisha (radijallahu anha) rrotullohej rreth Kabes në distancë të largët nga burrat dhe i shmangej përzierjes me ata. Një herë një grua i tha asaj të shkonte përpara me atë kështu që ata mund ta preknin qoshen e Kabes. Aisha refuzoi të vepronte në këtë mënyrë”. [Sahih el-Buhari]

Një nga shërbëtoret e Aishes erdhi tek ajo dhe i tha: “O nëna e besimtarëve, unë shkoja rreth Kabes shtatë herë dhe e preka qoshen dy apo tre herë”.

Aisha ju përgjigj: “Allahu mos ta shpërbleftë sepse je shtyrë përmes burrave. Do të kishte qenë e mjaftueshme për ty të thojë: “Allahu Ekber” kur të kaloje pranë”. [Musnad el-Shafi'i]

Gjenden dy gjëra që kjo na tregon ne. Së pari, Aisha nuk hezitoi të rrotullohej rreth Kabes kur kishte burra rreth e rrotull, as që ajo nuk ndaloi gratë të veprojnë në këtë mënyrë. Ajo vetëm frenohej ndaj grumbullimit të burrave dhe grave dhe përzierjes me ta dhe kjo është çfarë ajo i ndaloi ato të



bënin. Kjo na tregon ne termat më të qarta që vetëm prezenca e burrave dhe grave në të njëjtin vetëm nuk është e ndaluar.

Së dyti, përzierja dhe kontakti midis burrave dhe grave që rrotullohen rreth Qabes që ndodh në mënyrë të pashmangshme gjatë haxhit nën kushtet e sotme të grumbullimit nuk mund të përdoret si argument që një përzierje është përgjithësisht e lejuar. Së pari, praktika e njerëzve nuk përbën ndonjë lloj fakti në ligjin islam. Së dyti, çfarë është duke ndodhur sot gjatë haxhit është e pashmangshme. Është e lejuar nga nevojshmëria dhe nuk mund të bëhet një parim i përgjithshëm për vendet dhe rrethanat. Do të ishte e pafrytshme për ne të përiqeshim dhe të kërkonim që gratë t'i shmangeshin kontaktit me burrat ndërsa rrotullohen rreth Kabes gjatë haxhit. Do të jetë në mënyrë të barabartë e pamundshme për t'i kërkuar atyre që ta vonojnë rrotullimet e tyre derisa grumbujt të largohen, veçanërisht përderisa gratë në haxh janë gjithmonë të shoqëruara nga të tjerët të cilët kanë ardhur me to të cilët nuk mund të detyrohen të presin rrotull.

Do të ishte thjeshtë një mashtrim për cilindo që të përdorë këto rrethana të

jashtëzakonshme për të debatuar që gratë dhe burrat janë të lejuar të përzihen nën rrethana ku nuk ekziston nevoja. Është thjeshtë e pabazë për t'i çuar çështjet në ekstrem dhe të deklarojmë se vetëm prezenca e burrave dhe grave në një vend është një përzierje e palejueshme.

Ne do ta përmbyllim duke përmendur pak vargje nga Kur'ani. Allahu ka thënë: "As mos ju afro zinasë (kurvërisë)". Në këtë varg, Allahu nuk thotë "Mos bëj zina (kurvëri)" por na tregon që të mos i afrohem. Kjo do të thotë që çdo gjë që çon në joshjen e një personi për të rënë në zina (kurvëri) është e palejueshme.

Më tepër ndaj kësaj, Allahu thotë: "Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haremit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtarëve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme". [Nur: 30-31]

Kjo na tregon sesi burrat dhe gratë duhet të sillen.

Përktheu: Ammar Ardit Kraja  
Sami el-Mexhid,  
24.6.2005

## Gratë dhe urdhërimi për mirë dhe ndalimi i të keqes

Disa njerëz e kufizojnë përgjegjësinë e urdhërimit për mirë dhe ndalimit të së keqes te roli i burrave dhe e bëjnë pak të rëndësishme efektin e përmbushjes së kësaj detyre nga ana e grave. Shumë tekste janë shpallur për të treguar përgjegjësinë e

grave për të urdhëruar për mirë dhe për të ndaluar nga e keqja, rëndësia e grave në këtë aspekt bëhet e dukshme në shumë mënyra.

Përgjegjësia për përmbushjen e detyrës së urdhërimit për mirë dhe ndalimit nga e

keqja bëhet e dukshme që kjo përgjegjësi qartësisht i aplikohet grave.

1. Faktet e teksteve porsa i përket detyrës së urdhërimit për mirë dhe ndalimit të së keqes.

Shumë tekste nga Kur'ani fisnik dhe suneti autentik kanë treguar detyrën e urdhërimit për mirë dhe ndalimit të së keqes. Gjuha e përdorur në shumë tekste, megjithëse është mashkullore, gjithashtu përmban dhe i aplikohet edhe gjinisë femërore siç është shpjeguar nga dijetarët, Allahu i mëshiroftë. Për shembull, Imam Ibën Kajjim el-Xhevziye ka thënë: “Është e vendosur në zakonin e ligdhënësit që nëse një gjykim është bërë në formën mashkullore dhe nuk është i shoqëruar me një formë femërore, atëherë i aplikohet të dyve edhe burrave edhe grave, sepse gjinia mashkullore është më dominante sesa gjinia femërore kur përmenden së bashku, ashtu siç është thënia e Tij: “...dhe dëshmitarët nuk duhet të refuzojnë kur ata të thirren...”

Dhe thënia e Tij: “O ju të cilët besoni! Agjërimi është bërë i obligueshëm për ju”.

2. Tekstet të cilat qartësisht provojnë përgjegjësinë e grave për të urdhëruar për mirë dhe për të ndaluar nga e keqja.

Ka tekste në Kur'anin e nderuar dhe hadithin autentik të cilat provojnë përgjegjësinë e grave për të urdhëruar për mirë dhe për të ndaluar të keqen. Midis këtyre teksteve janë:

1. Thënia e Allahut: “O ju gra të Profetit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse ju i kushtoheni (Allahu) atëherë mos i zburoni fjalët tuaja, që ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre të mos lëvizin nga dëshirat por flitni në një mënyrë të ndershme”.

Një nga komentatorët e respektuar të Kur'anit, Abdullah Ibën Abbas ka thënë rreth shpjegimit të thënies së Allahut “por flitni në

një mënyrë të ndershme”: “Ai (Allahu) i ka urdhëruar ato të urdhërojnë për mirë dhe të ndalojnë nga e keqja”. [6]

Askush nuk duhet të mendojë që ky urdhër është specifik për nënat e besimtarëve (gratë e Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem) ashtu siç ju është drejtuar në këtë varg kur'anor sepse megjithëse ata janë ato që ju u është drejtuar nga ky varg kur'anor, pjesa tjetër e grave muslimane janë të nënkuptuara gjithashtu.

Porsa i përket kësaj, Imam Ebu Bekër el-Xhasas ka thënë: “Të gjitha këto çështje janë çështje me të cilat Allahu i ka tërheqë vëmendjen grave të Pejgamberit, si nder për ato, dhe pjesa e tjetër e grave besimtare është e nënkuptuar”.

2. Thënia e Allahut: “Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë. Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhennete nën të cilët rrjedhin lumenj, në të to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhennetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtimi i madh”. [et-Teube:71-72]

Allahu, subhanehu ve teala përmendi pesë attribute, midis tyre përmeshja e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit të së keqes dhe e bëri të qartë premtimin e Tij për një shpërbtim të madh për ata të cilët e kanë këtë cilësi dhe Allahu e bëri të qartë që femrat besimtare mund të arrijnë këtë cilësi ashtu si munden edhe meshkujt...

Imam Ibën en-Nuhas ed-Dimashki ka thënë: “Në thënien e Allahut “...dhe besimtare..”

Është një fakt që urdhërimi për mirë dhe ndalimi i të keqes është i obligueshëm mbi gratë në të njëjtën mënyrë siç është e obliguar mbi burrat, nëse ata janë të aftë.

1. Imam Buhari dhe Imam Muslimi kanë transmetuar nga Abdullah Ibën Omer që i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Me të vërtetë a nuk jeni ju të gjithë rojtarë? Dhe secili prej jush është përgjegjës për tufën e tij. Kështu lideri i cili është në autoritet mbi njerëzit është një rojtarë dhe ai është i përgjegjshëm për tufën e tij dhe një njeri është rojtarë mbi anëtarët e tjerë të familjes së tij dhe ai është përgjegjës për tufën e tij dhe gruaja është rojtare mbi anëtarët e familjes së burrit të saj dhe fëmijët e tij dhe ajo është përgjegjëse për ata dhe roli i burrit është rojtarë mbi pasurinë e pronarit të tij dhe për gjegjës për të. Me të vërtetë, ju të gjithë jeni rojtarë dhe të gjithë ju jeni të përgjegjshëm për tufën tuaj”.

Imam el-Hatabi ka thënë: “Kuptimi i “rojtarit” këtu është mbrojtës dhe një të cilit i besohet të gjithë ata që janë nën të, i cili i urdhëron ata me këshilla/ udhëzim dhe i paralajmëron ata nga tradhtia ose shpërdorimi i asaj që ju është besuar atyre”.

Kështu rrethanat e një gruaje si rojtare tregojnë që ajo mund të ndërmarrë detyrën e urdhërimit për mirë dhe ndalimit të së keqes kur e mira është e neglizhuar ose kur e keqja ndodh midis atyre të cilëve ajo është përgjegjëse.

Gruaja do të pyetet, ashtu siç do të pyeten të gjithë rojtarët, rreth kësaj në ditën e Gjykimit, ashtu siç është thënë në një hadith: “..ajo është përgjegjëse për ata” dhe në hadithin e transmetuar nga Enesi: “Me të vërtetë, Allahu do të pyesë çdo rojtarë rreth asaj për të cilën Ai e ka bërë rojtarë, në qoftë se ai i ka mbrojtur apo i ka neglizhuar”.

Dhe në hadithin e Ebu Hurejres: “Çdo rojtarë do të pyetet në ditën e gjykimit, nëse ai e ka kryer apo jo urdhrin e Allahut apo a e ka neglizhuar atë”.

Si rezultat është e obligueshme mbi gruan muslimane ashtu siç është e obligueshme për të tjerët të cilët janë përgjegjës, të përgatisin për këtë pyetje një përgjigje, duke përmbyshur çfarë Allahu e ka urdhëruar atë përpara ditës në të cilën nuk do ta ndihmojë trishtimi e as keqardhja.

Përktheu: Ammar Ardit Kraja  
Marrë nga: islaam.net  
1.7.2005

## Imam Ibën Shihab Ez Zuhri

Emri i plotë: Quhet Muhammed ibën Muslim ibën Ubejdullah ibën Abdullah ibën Harith ibën Zehre Ebu Bekr El Kureshi, Ez Zuhri, El Medeni dijetari i Medinës që banoi edhe në tokat Shamit.

Ka lindur në vitin 56 H (në disa burime përmenden vitet 50 H dhe 51 H) në Medine. Fakti që ka lindur në periudhën e artë të dijës i ndihmoi të përfiton nga shumë as'habë dhe shumë tabi'inë.

Prej tyre do t'i përmendim:

Ibën Umerin, Enes ibën Malikun, Sehl ibën Sa'din, Es Saib Ibën Jezidi, Ebu Tufejl ibën Vathile, të gjithë shokë të të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, All-lahu qoftë i kënaqur me ta.

Ka përfituar edhe prej Se'id ibën El Musejjebit të cilin e ka shoqëruar tetë vjet, si dhe prej Alkame ibën Vekkasit, Urve ibën Zubejrit, Ebu Idris El Haulanit, Salim Ibën Abdullahit, Ebu Seleme ibën Abdur Rahmanit, Ubejdullah ibën Abdil-lah ibën Utbe, El Kasim ibën Muhammedit, El Harixhe ibën Zejdit dhe shumë tjerë.

Lëvdatat e dijetarëve për të:

El Lejth ibën Sa'di: Nuk kam parë dijetarë më të përkryer se Ibën Shihabi. Kur lexonte hadithe do thoje nuk din asgjë përveç haditheve, e njëjta ndodhte dh kur fliste për arabët dhe fiset tyre, për Kur'anin dhe këshillat.

Sufjan ibën Ujejne: Ibën Zuhriu ishte më i dituri i Medinës.

Omer ibën Abdul Aziz: Askush si Zuhriu nuk i recitonte hadithet.

Amër ibën Dinari: Dërrhemët nuk kishin vlerë për të.

Ahmed ibën Hanbel: Senedet dhe hadithet e Zuhriut janë më të mirët.

Jahja ibën Se'id: Nuk ka mbetur dijetarë me dije si Zuhriu.

Ejjub Es Sihtijani: Nuk kam parë njeri më të ditur se Zuhriu. I thanë as Hasan El Basriu? Tha: Më i dituri është Zuhriu. Të njëjtën fjalë tre herë e ka përsëritur edhe Shuajb ibën Ebi Hamze.

Ishte det i dijës tha S'id ibën Abdul Azizi.

Malik ibën Enes: Ibën Shihabi nuk kishte konkurrent në dije.

Ali ibën El Medini: Katër veta jepnin fetva: El Hakemi, Hammadi, Katadeja dhe Zuhriu. Zuhriu ishte më i dituri prej tyre.

Dijen e Se'id ibën El Musejjebit, Urves dhe Ubejdullah ibën Abdullah e tuboi Ibën Shihabi.

Malik ibën Enes: Kur vinte Ibën Shihabi në Medine grumbulloheshim para shtëpisë së tij.

Salih ibën Kejsani rrëfen: Kërkonim dije unë dhe Zuhriu dhe ai më tha: eja t'i shënojmë hadithet e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-leme dhe ashtu e bëmë. Kur më tha t'i shënojmë fjalët e as'habëve unë nuk pranova, ndërkohë që ai vazhdoi punën. Ai korri sukses e unë humba.

Malik ibën Enes: Ishte më bujari në mesin tonë.

Disa fjalë të Zuhriut:

Ka thënë:

“Të kapurit për sunet është shpëtim.”

“Përsëritja e hadithit është më vështirë se bartja e gurëve.”

“Shejtanët kanë hise në tubimin që zgjatë.”

“Njerëzit nuk do të pranojnë fjalën dijetarit që nuk punon me dijen e tij si dhe punën e atij që nuk din.”

“Besimi në kaderin është boshti i besimit në All-llahun. Ai që njëson All-llahun dhe nuk beson në kader e ka anuluar besimin e tij.”

“Transmetimi i hadithit pa sened është si”kur hipja mbi kulm pa shkallë.”

“Senedi (transmetimi i hadithit duke i përmendur zinxhirin e transmetuesve) është veçori dalluese e Ummetit Islam.”

Nga ky det i dijes përfituan shumë dijetarë si:

El Ata ibën Ebi Rebah, Umer ibën Abdul Aziz, Amër ibën Dinar, Katade ibën Di’ame, Zejd ibën Eslem, Ejjub Es Shtijani, Ebu Zinadi, Ibën Xhurejxh, El Euzai, Malik ibën Enes, Sufjan ibën Ujejne, Ibën Is’hak dhe shumë tjerë.

Ndërroi jetë në vitin 123 H (në disa burime në vitin 124 H ose 125 H) All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjerë.

Përshtati: Talha Kurtishi

Mexhdi Arefat,

10.6.2005

## Salih ibën Abdul Aziz Alu Shejh

Konsiderohet një prej dijetarëve më të dalluar të kohës tonë. Librat dhe ligjëratat e tij janë të vlerësuara shumë mirë në mesin e dijetarëve si dhe në mesin e popullit në përgjithësi. Shkrimet e tij dallohen me qartësi, analizë të thellë si dhe janë kombinim i mrekullueshëm i librave të vjetra me shpjegim që përshtatet me konotacionet bashkohore. Ai që lexon ose dëgjon librat e tij bindet në vërtetësinë e këtyre fjalëve.

Quhet Salih ibën Abdul Aziz ibën Muhammed ibën Ibrahim Alu Shejh dhe rrjedh nga familja e njohur e dijetarit Muhammed ibën Abdul Vehhab.

Ka lindur në vitin 1378 H (1959 G) në familje e cila dallohej me dije dhe devotshmëri. Babai i tij, Abdul Aziz, ishte dijetar në kohë që gjyshi i tij al-lameja Muhammed ibën Ibrahim, për të cilin kemi shkruar më herët në Albislam, ishte kryemyftiu i Arabisë

Saudite dhe dijetari më i dalluar në atë kohë.

Etapat e shkollimit i mbaroi në qytetin e Rijadit. Deshi që fillimisht të studion inxhinierinë që më vonë të transferohet në universitetin Imam Muhammed ibën Su’ud, në të cilin diplomoi në fakultetin e Da’ves dhe bazave të fesë.

Krahas studimit zyrtar merrte pjesë në tubimet e dijes siç janë tubimet e dijetarëve: Abdul Aziz ibën Muhammed, Abdul Aziz ibën Murshid, Abdull-llah ibën Akil, Abdullah ibën Gudejjan, Salih El Etrem, Hammad El Ensari dhe Isma’il El Ensari.

Talenti i rrallë me të cilën dallohej, lidhjet me dijetarët e mëdhenj, leximi i vazhdueshëm dhe hulumtimi ishin faktorët me të rëndësishëm në formimin e tij shkencor. Kërkimin i dijes ai e vazhdoi edhe jashtë Saudisë, në Tunizi, Marok, Pakistan dhe Indi.

Veprimtarinë e tij në fushën e thirrjes e zhvillon në shumë rrafshë, në universitetet, në xhami dhe në fushën e publikimit.

Librat e tij dhe audio publikimet janë nga më të dalluarat.

Prej librave që i shkroi do t'i përmendim:

- Et Tekmil lima fate tahrixhuhu min Irva'il Galil (Plotësimi i mangësive në librin Irvaul Galil)

- Meusuatu El Kutub Es Sitte (Redaktura e gjashtë librave bazë të Sunnetit)

- Et Temhid fi Sherh Kitabit Teuhid (Temhid-shpjegim i Kitab Teuhid)

- Hitabun ila El Garb - Ru'jetun min Es Su'udijje (Letër drejtuar perëndimit - Vizioni i Arabisë Saudite) dhe tjera.

Prej vitit 1420 H punon si ministër për Çështje Islame, Vakëfe, Thirrje dhe Udhëzim i Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe është anëtarë i Këshillit Suprem për Çështje Islame në Saudi.

Kryeson mbikëqyrjen e punës së Kompleksit "Mbreti Fehd" për botimin e Mus'hafit si dhe punën e Shoqatave që merren me mësimin e Kur'anit.

Është anëtar në udhëheqësit e lartë të shumë shoqatave joqeveritare dhe humanitare.

All-llahu e ruajt shejhun tonë duke e angazhuar në shërbim të fesë. Amin

Shënimet u morën nga: faqja zyrtare e ministrisë për Çështje Islame, Vakëfe, Thirrje dhe Udhëzim të Mbretërisë së Arabisë Saudite:

<http://www.al-islam.com/>

Përktheu dhe përshtati: Talha Kurtishi

17.6.2005

## Imam Hammad ibën Zejd El Ezdi

Al-lameja, Hafidhi i besueshëm, muhadithi i kohës në të cilën jetoi, njeriu për besnikërinë e të cilit dëshmojnë gjithë autorët e librave bazë të hadithit të cilët u mbështetën në autoritetin e tij, autoritet i pamohueshëm.

Abdur Rahman ibën Mehdi duke i përcaktuar imamët e kohës tha: Imamë të botës në kohën e tyre ishin: Sufjan Eth Theuriu në Kufe, Maliku në Hixhaz, El Euzaiu në Sham dhe Hammad i Basra.

Quhet Hammad ibën Zejd ibën Dirhem Ebu Isma'il El Ezdi Es Sixhistani El Basri El Ezrek Ed Darir, robi i liruar i fisit Al Xherir ibën Hazim. Gjyshi i tij Dirhem është me prejardhje prej Sixhistanit që banoi në Basra.

Ka lindur në vitin 89 H (717 G) në Basra. Duke qenë njëri prej gjeneratave të dalluar

Hammadi pati fatin të mëson nga shumë dijetarë të këtyre periudhave të bekuara. Nga ky varg i gjatë do t'i përmendim: Enes ibën Sirin-in, Amër ibën Dinar-in, Thabit El Bunani-n, Ejjub Es Sihtijani-n, Abdul Aziz ibën Suhejb-in, Asim ibën Ebi Nexhud-in, Amir ibën Abdul Vahid El Ahvel-in, Muhamedin birin e Vasiut, Mensur ibën Mu'temir-in, Davud ibën Ebi Hind-in, Junus ibën Ubejd-in, Ebu Hazim El A'rexh-in dhe shumë tjerë.

Për pozitën që e pat ky dijetar flasin mjaft fjalët miradije e bashkëkohanikëve të tij si dhe fjalët e dijetarëve pas tij:

Jahja ibën Me'ini thotë: Nuk kam parë dijetar me kujtesë më të fortë se Hammadi.

Ahmed ibën Hanbel: Hammad ibën Zejdi është një prej imamëve të myslimanëve i dalluar me fe. Për mua ai është më i dashur se Hammad ibën Seleme.

Abdur Rahman ibën Mehdi: Nuk kam parë njeri që më mirë e njihje Sunnetin dhe hadithin. Këtë e thotë njeri i cili është takuar me shumë dijetarë të hadithit dhe vetë është dijetar i madh në shumë lëmi të shkencës.

Sufjan Eth Theuri: Dijetari i Basrasë pas Shu'bes është Ezreku (Hammadi).

Ahmed ibën Abdullah El Ixhli: Hammad ibën Zejdi ishte i besueshëm. Numri i haditheve që i transmetoi është 4000. I dinte përmendsh dhe nuk i kishte të shënuara në libër.

Ibën El Mubareku për të i thuri këto vargje:

O ti që kërkon dije

eja te Hammad ibën Zejdi

Dhe merr butësi dhe dije pastaj

shënoje që të mos e harrosh

Muhammed ibën Isa Et Tabba' ka thënë: Nuk kam parë njeri më të mençur se Hammadi.

Kur Jezid ibën Harun e pyeti: A janë përmendur në Kur'an dijetarët e hadithit u përgjigj: Po. Lexoje ajetin: "...E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t'u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen)." (Et Tevbe, 122)

Kur Hammadi ndërroi jetë Jezid ibën Zurejji' tha: Sot vdiq i zgjedhuri i muslimanëve.

Abdur Rahman ibën Mehdi: Askush nuk ishte më i ditur se Hammadi. As Sufjani e as Maliku.

Dhehebiu kështu e përshkruante: Hammad ibën Zejd është njëri prej imamëve të selefit dhe njëri prej dijetarëve me kujtesë të fortë, i drejti, që pak gabonte. Nuk di ndonjë dijetarë të ketë kundërshtuar këtë qëndrim.

Ebu Usame: Kur takohesha me ta thosha (në vete) Edukatës familjare që e ka ia bashkëngjiti fikhun e Omer-it, radijall-llahu anhu.

Në besimin e tij pasonte rrugën e të parëve tanë.

Nga ky imam i dijës përfituan shumë nxënës të dijës nga mesi i të cilëve do t'i përmendim:

Ibrahim ibën Ebi Able, Sufjan esh Shu'be (që ishin edhe mësuesit e tij), Abdul Varith ibën Se'id, Abdur Rahman ibën Mehdi, Abdullah ibën El Mubarek, Musedded, Sulejman ibën Harb, Ubejdullah El Kavariri, Ali ibën El Medini, Kutejbe ibën Se'id, Ibrahim ibën Jusuf El Belhi, Davud ibën Amër Ed Dabbi, Muhammed ibën Nadr El Mirvezi etj.

Ndërroi jetë në muajin Ramazan të vitit 179 H (795 G). All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjerë.

Përshtati: Talha Kurtishi

Burimi kryesor: Sijer A'lam En Nubela, vëll.7, fq.456-462  
24.6.2005

## Ibrahim ibën Ed'hemi

Imami i devotshëm, prijësi i asketëve, njohësi i mirë i All-llahut, subhanehu ve teala, njeriu këshillat e të cilit edhe sot zbusin zemrat e besimtarëve duke i ndihmuar që ta njohin sa më mirë All-lahun.

Quket Ibrahim ibën Ed'hem ibën Mensur ibën Jezid ibën Xhabir Ebu Is'hak El ixhli (sipas disa autorëve Et Temimi) me prejar-dhje prej Horasanit dhe pastaj banor i Shamit. Ka lindur diku rreth vitit 100 H në kohën e gjeneratave të bekuara fat ky që i mundësoi të mëson nga shumë dijetarë të gjeneratave të dalluara nga mesi i të cilëve do t'i përmendim:

Muhammed ibën Zijad El Xhumehi, Ebu Is'hak Es Sebi'i, Mensur ibën El Mu'temir, Malik ibën Dinar, Sulejman El A'mesh, Ibën Axhlan, Mukatil ibën Hajan etj.

Ibrahim Ibën Ed'hem i cili ishte një djalë i ri i përciptë që mendonte vetëm si të zbavitet. Një ditë u ndesh me një plak i cili e morri freun e kalit të tij dhe me një zë qortues i tha "Ibrahim a është kjo për të cilën je krijuar ose je urdhëruar që të bësh këtë?" Fjalët e plakut gjetën rrugën për në zemrën e Ibrahimit. Që nga ky moment ai u betua se do të jetonte për qëllimin e krijimit meqë All-llahu, subhanehu ve teala, thotë në Kur'anin famëlartë "Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë".

Abdur Rahman ibën Mehdi ka thënë: E pyeta Ibën El Mubarekun prej cilit ka dëgjuar Ibrahim ibën Ed'hemi? Më tha: Ka dëgjuar prej shumë njerëz. Ishte njeri me vlerë, nga pamja e jashtme nuk dallohej me ndonjë adhurim të veçantë. Nuk hante me njerëz

dhe atëherë kur ulej me ta ishte i fundit që fillonte me ushqim...

Sufjani Eth Theuri shoku i tij kështu e përshkruante: Ibrahimin e përngjasonin me Ibrahimin, alejhi selam. Po të ishte prej gjeneratës së as'habëve do të ishte prej të dalluarve.

Ishte i modest dhe mjaftohej me ushqim të thjeshtë bukë dhe vaj ulliri. Thoshte Kam frikë se All-llahu, subhanehu ve teala, nuk do të më shpërblen për lërjen e ushqimit të mirë sepse unë me të vërtetë nuk e dua.

Kur punonte i recitonte këto fjalë:

Merre All-llahun për mik dhe lëri njerëzit anësh.

Robat e tij ishin të thjeshta, agjëronte edhe gjatë udhëtimit, natën nuk flinte mendonte shumë, paratë që i fitonte me punë nuk i prekte me dorë...

Kur ulej me Ibrahim Ed'hemin Sufjani fliste shumë pak.

Thoshte: Nuk është i sinqertë robi që dëshiron të jetë i njohur. Imam Dhehebiu duke i komentuar këto fjalë tha: Ndodhë që robi i sinqertë të sprovohet me popullaritet dhe kur t'i përmenden këto fjalë ai nuk i refuzon e as që e arsyeton vetën dhe thotë: All-llahu e mëshiroftë njeriun që mi tregon mangësitë. Atë nuk e mashtron vetja...

Ka thënë: Mbreti i padrejtë është i njëjtë me vjedhësin, dijetari jo i devotshëm është i njëjtë me ujkun, ai që e nënshtron vetën para tjetërkujt përpos All-llahut është si qeni.

Vepra e mirë është shkëlqim në fytyrë, dritë në zemër, gjerësi në furnizim, fuqi në



trup dhe dashuri në mesin e njerëzve në kohë që mëkati nxin fytyrën, errëson zemrën, dobëson trupin, pakëson furnizimin dhe shkakton urrejtje tek njerëzit.

Ka thënë: Hymë te një ibadetçi i sëmurë. Atë e gjetëm duke shikuar këmbët dhe duke qarë. I thamë: Pse po qanë? Tha: Qaj këto këmbë që nuk janë pluhurosor në rrugë të All-llahut. Qau një tjetër. I thamë atij: Pse po qanë? Tha: Po qaj filan ditën, të cilën nuk e kam aqjëruar dhe filan natën, në të cilën nuk kam falë namaz.

U pyet një ditë nga dikush për shkakun e mospërgjigjes së lutjeve dhe ai i tha: “Ju e njohët Allahun dhe nuk i bindeni Atij. E njohët pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve selleme, dhe nuk ecni me mësimet e tij. E njohët Kur`anin dhe nuk punoni me të. Hani nga mirësitë e Allahut të Madhëruar dhe nuk e falënderoni Atë për to. E besuat xhenetin dhe nuk punoni për ta fituar atë. I varrosni të vdekurit dhe harroni se edhe ju një ditë do të ktheheni aty. I latë pas dore të metat tuaja dhe u morët me të metat e të tjerëve”.

Në një natë të ftohtë u ndal me shokët e tij pranë një xhami të braktisur dhe të gjithë u shtrinë për të fjetur përpos Ibrahimit i cili me trupin e tij e mbyllte derën që t'i mbron shokët nga ftohti.

Gëzimi më mi madh për shokët e tij ishte çasti kur Ibrahim ibën Ed'hemi pranonte diç nga malli i tyre.

Ibën Rexhebi thotë: Shembulli i haxhxit të pranuar është haxhxi i Ibrahimit dhe shokut të tij me të cilin udhëtuan prej Horasanit deri në Mekke. Pas haxhxit ai u largua nga pasuria dhe fama që e pati, zgjodhi jetën modeste duke u vetmuar për të adhuruar All-llahun, subhanehu ve teala. U pajtua me furnizimin e pakët që e fitonte duke punuar gjatë korrijeve dhe duke ruajtur kopshtet.

Një njeri iu drejtua Ibrahimit duke e pyetur: Epshi im më shtyn drejtë mëkatis, më këshillo me këshillë që do të më bën dobi?

Tha: Kur të thërret epshi drejtë mëkatis mos e respekto ose bëre mëkatin me këto pesë kushte:

Bëre mëkatin në një vend në të cilin nuk të sheh askush.

Mos e bë mëkatin mbi tokën e All-llahut, subhanehu ve teala,

Mos ha nga furnizimi me të cilin të ka furnizuar,

Kur të vijjnë melekët për të të marr shpirtin mos shko me to

Atëherë kur në ditën e Gjykimit të parashtrohen mëkatet që i ke bërë mohoi ato.

Nëse nuk mundesh t'i plotësosh këto kushte mos i afro mëkateve.

Nxënësit e tij ishin: Sufjan Eth Theuriu, Shekik El Belhi, Muhammed ibën Jusuf El Ferjabi, El Euzaiu dhe shumë tjerë.

Ndërroi jetë në vitin 162 H. All-lahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjerë.

Talha Kurtishi,  
1.7.2005

## Pyetje dhe përgjigje

**Tema:** Tefsir

**Numri:** 1195    **Data:** 3.7.2005

**Pyetje:** Tefsiri i ajeteve 106-108 të sures El-Hud?

**Përgjigje:** Disa njerëz më kanë pyetur rreth kuptimit të ajetit 107 dhe 108 nga sureja Hud për shkak se u ka paraqitur dilema kuptimi i këtij ajeti. Si përgjigje e kësaj ua paraqesim tefsirin e këtij ajeti duke u mbështetur në disa libra nga lëmia e tefsirit.

Në fillim po ua paraqesim ajetet dhe përkthimin e kuptimit të tyre, e pastaj e sjellim edhe komentimin e dijetarëve.

"E për sa u përket atyre fatkëqinjëve, ata janë në zjarr, aty ata kanë dihatje, kërkamzë të vështirë (në frymëmarrje). Aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt, vërtet Zoti yt punon çka dëshiron. E për sa u përket atyre fatmirëve, ata janë në xhennet përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt (All-llahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur". (Hud: 106- 108).

Ibën Kethiri, rahimehull-llah, duke e komentuar ajetin 108 thotë: "Pasuesit e pejgamberëve vendbanim të tyre e kanë xhennetin ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Kurse ky përjashtim që është bërë në këtë ajet është për të treguar se qëndrimi i tyre përgjithmonë në begatitë e xhennetit nuk është detyrë obligative në vete, por është e lidhur me Vullnetin e All-llahut dhe Atij i takon falënderimi për këtë dhunti, andaj inspirohen lavdërim dhe falënderim, ashtu sikurse inspirohen frymëmarrje.

Muxhahidi, Ibën Abasi, Ebul-Alije dhe të tjerët kanë thënë: All-llahu ka përmendur fjalën: "shpërblim të pakëputur" për mos të kupton gabimisht dikush se begatitë e xhennetit përfundojnë, ose se ndodh diçka, por ka përcaktuar përhershmeri dhe mospërfundim, ashtu sikurse ka treguar se edhe denimi i banorëve të xhehenemit në xhehenem është i përhershëm dhe ka të bëjë me Vullnetin e All-llahut, sepse ai me Drejtësinë dhe Urtësinë e Tij i ka denuar, andaj ka thënë: "E punon atë që dëshiron". (El-Buruxh: 16). Dhe: "Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten". (El-Enbija: 23).

Këtu All-llahu i ka qetësuar zemrat dhe e ka përcaktuar qëllimin duke thënë: "... (All-llahu ju dhuron) shpërblim të pakëputur".

Transmeton Buhariu dhe Muslimi se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Do të silltet vdekja në formën e dashit të majmë dhe do të therret mes xhennetit dhe xhehenemit e pastaj do të thuhet: o ju banorë të xhennetit, përhershmeri pa vdekje dhe o ju banor të zjarrit përhershmeri pa vdekje". Transmeton Buhariu nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Do tu thuhet: o ju banor të xhennetit do të jetoni dhe nuk do të vdisni asnjëherë, do të jeni të rinjë dhe nuk do të plakeni, do të jeni të shëndoshë dhe nuk do të sëmureni dhe do të jetoni në begati dhe nuk do të keni aspak vështirësi". (2/442)

---

Sadiu, rahimehull-llah, thotë: Begatitë e përhershme që ua ka dhënë All-llahu dhe kënaqësitë e larta, janë të përhershme dhe nuk ndërpriten asnjëherë. E lusim All-llahun Bujar që me dhuntitë e Tij të na bëjë prej tyre. (f. 346).

Kurse Imam Ibën Xhevziu në tefsirin e tij "Zadul-Mesir", 4/ 158-162 flet më gjërësisht mbi këtë problematikë që shfaqet në shikim të parë nga ky ajet dhe tregon mendimet e ndryshme të dijetarëve. Ai mes tjerash thotë: "Ibën Kutejbe dhe Ibën El-Enbariu thonë: arabët për fjalën Ebed- përgjithmonë, kanë shumë shprehje. Ata thonë: nuk e bëj këtë përderisa ka ditë dhe natë, ose sa ka qiej dhe tokë, ose sa ka ushqim (për deven) dhe qumësht. Duke menduar ata se këto gjëra nuk ndryshohen, All-llahu u ka folur në gjuhën që ata e përdorin...".

Imam Shevkaniu në tefsirin e tij "Fet'hul-Kadir", 2/734 duke e komentuar pjesën e ajetit: "... përveç atë çka do Zoti yt..." tregon një fjalë të Ibën Abasit, radijall-llahu anhu, i cili ka thënë: "All-llahu do që mosbesimtarët të jenë përgjithmonë në xhehenem, kurse besimtarët përgjithmonë në xhennet".

Imam Kurtubiu, rahimehull-llah, i tregon njëmbëdhjetë aspekte të kuptimit të këtij ajeti, duke arritur në konkluzë se aspak nuk është qëllimi i ajetit përkohshmëria e dënimit ose e kënaqësisë. (shiko: "Xhamiu Ahkmail-Kuran", 9/85-88).

Pasi që i shfletova edhe disa libra tjerë të tefsirit, nuk vërejtja sqarim tjetër përpos kësaj që kemi thënë deri tani. All-llahu e di më së miri qëllimin e asaj që Ai e ka thënë.

Bekir Halimi  
3.7.2005

## Obligueshmëria e përvetësimit të shkencës së hadithit

Në shumë libra dhe revista islame jemi duke parë se si njerëzit shkruajnë hadithe të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe ato i ngritin deri sa edhe dhe ia përshkruajnë Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, duke mos përmendur aty përmbledhjet e librave të hadithit (prej të cilave i nxjerrin ato hadithe). Përveç kësaj ata deklarojnë prerë dhe i mveshin hadithe, deri edhe te Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kurse hadithi mund të jetë i dobët [daif] ose i trilluar [mevdu], e disa prej tyre marrin guximin për të komentuar dhe shpjeguar këto hadithe. Ka të atillë që argumentojnë me të tilla fakte, për të cilat të gjithë dijetarët e spikatur kanë vlerësuar se janë të pavlera, për të kundërshtuar diçka, sipas mendimit të tij, kurse ajo gjë është e futur në islam, sikurse ka ndodhur në numrat e fundit të revistës - Mexhele et-temedun el-islami 19/529-530.

**Deri te të nderuarit dhe të respektuarit ligjërues [hatiba], vaiza, hoxhallarë dhe të tjerë, dua që tua them këto fjalë si këshillë [nasihah] dhe përkujtim:**

Nuk i lejohet një muslimani që t'ia mvesh një hadith Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, përderisa nuk e vërteton se hadithi është i vërtetë [sahih] sipas rregullave të dijetarëve të hadithit. Argument për këtë është thënia e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi

ve sel-lem: "keni kujdes, mos flitni nga unë pos atë që dini, se kush gënjen qëllimisht për mua le të pregadisë një vend për vete në Zjarr." Transmeton Ibën Ebi shejbe me sened të vërtetë-shih-"Fejdul kadir".

Kurse vërtetimi i një hadithi i ka dy rrugë:

E para: Ai i cili hulumton hadithe duhet të shiqon senedin e hadithit dhe transmetuesit e tij, pastaj gjykon në bazë të rregullave të shkencës së hadithit, se a është hadithi i vërtetë [sahih] apo i dobët [daif], duke mos imituar ndonjë imam të veçantë në vërtetësinë e hadithit apo në dobësinë e tij. Kjo punë në ditët e sodit është e rrallë, nuk do mund të gjesh përpos disa individë, për fat të keq.

E dyta: Të bazohet në librat që ka veçuar autori me hadithe sahih sikurse dy Sahihet [buhari dhe muslim], dhe të tjera,ose në thëniet e redaktorëve të hadithit nga dijetarët e hadithit, sikurse Imam Ahmedi, Ibën Meini, Ebu Hatimi, Er-Razi dhe të tjerë nga dijetarët e hershëm, dhe si Nevevi, Dhehebi, Zejlai, Eskalani dhe të tjerë nga dijetarët e mëvonshëm. Kjo është rruga më e lehtë për atë i cili dëshiron të vërtetën [hakun]. Por ka nevojë për kontribut, dhe konsultim të librave si dhe hulumtim të thellë të hadithit, kjo është prej gjërave të patjetërsueshme, dhe nuk i takon dikujt të largohet prej kësaj pune nëse ka dert dhe gajle fenë e tij, dhe

është i kujdesshëm që mos të hy në fenë tonë ajo që nuk është prej saj.

Mu për këtë thotë dijetari i shquar, El-fakih Ibën Haxher El-Hejthemi në librin e tij El-Fetava Elmedenije fq. 32: Është pyetur, Allahu e mëshiroftë, për një ligjërues [hatib] i cili ligjëron në hutbe, në çdo ditë xhumaje dhe transmeton hadithe të shumta, dhe nuk i sqaron nxjerrjen e haditheve nga i ka marrë e as transmetuesin se kush është, çfarë obligimi ka ky njeri?

Thotë: Sa i takon hadithet që i përmendë në ligjërimin e tij në hutbe duke mos përmendur dhe sqaruar transmetuesit dhe nga i ka marrur hadithet ose kush e ka përmendur, lejohet por me kusht (shart) që të jetë nga njohësit e hadithit ose të merr hadithe nga njohësit e hadithit, ose të merr hadithe

nga libri ku autori është nga dijetarët e hadithit. E nëse transmeton prej librave autori i të cilave nuk është njohës i hadithit nuk i lejohet të ligjëron (hutbe). Nëse vepron atëherë dënohet me dënim të rreptë. Ky është halli i shumicës së ligjëruesve (hatibave) të cilët pa u siguruar përmendin hadithe dhe i mësojnë pa e vërtetuar saktësinë e tyre. Për atë shkak udhëheqësit e muslimanëve obligohen t'i ndalojnë ata (hatibat) reptësisht nga ligjërimi i këtillë.

Pastaj thotë: Ligjëruesi (hatibi) duhet të sqaron senedin në transmetimin e tij. Nëse senedi është i vërtetë (sahih) nuk kundërshtohet, nëse jo atëherë kundërshtohet bile i lejohet insitucionit fetar ta shkarkon nga detyra (vazifeja) për ta ndaluar nga marrja e guximit të këtillë pa të drejtë.

Muhammed Nasirud-din Albani  
përktheu: Fatmir Zaimi  
marrë nga libri: Mekalat el-Albani  
pregaditur nga: Nuruddin Talib  
Rijad, 2001  
7.7.2005

## 24. Këshilla

Transmeton Ebu Rukaje Temim ibën Eus Eddarij se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Feja është këshillë. Thamë për cilin? U përgjigj: Për Allahun, për Librin e Tij, Pejgamberin e tij, prijësit e muslimanëve dhe masën e gjerë.”

Allahu, subhanehu ve teala, duke na lajmëruar për Lutin, alejhi selam, thotë: “Dhe unë jam këshillues besnik për ju”

Ky është një hadith madhështor, mbi të ndërtohet Feja Islame siç do të përmendim më vonë. Kuptimi i fjalës “feja është këshillë” është: Këshilla është shtylla e fesë.

Hattabij, rahimehull-llah, ka thënë: Fjala ‘nesiha’ (këshillë) është shprehje me të cilën kihen për qëllim disa gjëra, prej tyre: t’ia duash të mirën atij që e këshillon. Kuptimi esencial i kësaj fjale është: “hulus” (pastrim). Thuhet: nesahtul asel” - e kam pastruar mjaltin. Pra kuptimi i fjalës: feja është këshillë (nasiha) për Allahun është: besimi i drejtë në njëshmërinë e Tij dhe sinqeriteti në adhurimin ndaj Tij. Kurse fjala “këshillë për librin e Tij” d.m.th. të besosh në këtë libër dhe të vepros sipas mësimëve që përmban ai. Fjala “këshillë për Pejgamberin e Tij” d.m.th. të besosh në pejgamberinë e tij dhe ta dëgjosh atë kur urdhëron apo ndalon. “Këshillë për masën e gjerë” d.m.th. udhëzimi i tyre kah gjërat që ju bëjnë dobi.

Ebu Amër ibën Salahi ka thënë: “nasiha’ (këshilla) është fjalë përmbledhëse që nënkupton: këshilluesi t’ia ofron të këshilluarit të gjitha aspektet e të mirës me zemër dhe vepër. Këshilla për Allahun e ka kuptimin: besimi në njëshmërinë e Tij dhe cilësimi i Tij me cilësi të përsosura dhe të larta si dhe mohimi i gjërave të kundërta që nuk i përkojnë madhërisë së Tij. Poashtu nënkuptohet largimi nga mëkatet dhe dëgjimi i urdhrave të Tij. Të duash dhe të urresh për hir të Allahut, të luftosh atë që mohon besimin në Te si dhe të thërrasësh dhe të nxisësh në tërë këtë.

“Këshilla për librin e Tij” nënkupton: të besosh në të, ta madhërosh, të mohosh mangësitë nga ai, ta lexosh drejtë, t’i respektosh urdhrat dhe ndalesat e tij, të kuptosh shkencat dhe shembujt që përmenden në të, të meditosh rreth ajeteve, të thërrasësh në të si dhe ta mbros nga shtrembërimi dhe shpifjet e të devijuarve.

“Këshilla për Pejgamberin” është e afërme me atë të librit, d.m.th. ta besosh atë dhe shpalljen që e ka sjellur ai, ta madhërosh, ta respektosh, të ecish në rrugën e tij, të ngjallësh sunnetin, të përhapësh dijen e tij, të armiqësosh armiqët e tij, të miqësosh miqtë e tij. Të stolisesh me virtytet e tij, të edukohesh me edukatën e tij si dhe të duash familjen dhe shokët e tij.

“Këshilla për prijësit e muslimanëve” donë të thotë: t’i ndihmosh ata kur janë në të drejtë, t’i respektosh, t’ua përkujtosh të vërtetën, t’ua tërheqësh vërejtjen me butësi, të largohesh nga konflikti me ta si dhe të lutesh për ta që Allahu, subhanehu ve teala, t’i drejtojë.

“Këshilla për masën e gjerë” nënkupton: udhëzimi i tyre kah ajo që ju bën dobi, mësimi i tyre në çështjet e fesë dhe dunjasë, fshehja e të metave të tyre, ndihma kundër armiqve të tyre, mbrojtja e tyre, të mos tradhtohen as të mos ua kenë zili, të duash për ta atë që donë për vetvete si dhe të urresh për ta atë që urren për vetvete.

Fudajl ibën ljadi ka thënë: Te ne, njerëzit nuk janë ngritur me falje dhe agjërim të shumtë porse me bujari shpirtërore, zemër të shëndoshë dhe këshillë ndaj ummetit.

Është pyetur Abdullah ibën Mubareku: cila është puna më e mirë? Ka thënë: Këshilla për hirrë të Allahut.

Ma'meri ka thënë: këshillues më i madh për ty është ai që më së tepërmi i frikohet Allahut për ty.

Selefi kur dëshironte të këshilloj ndokënd e këshillonte fshehurazi ashtu që disa prej tyre thonin: Kush këshillon vëllain e tij fshehurazi ai vërtetë e ka këshilluar, kurse ai që e këshillon në praninë e njerëzve ai në realitet e ka qortuar.

Fudajl ibën ljadi gjithashtu ka thënë: Besimtari ua fsheh të tjerëve të metat dhe këshillon kurse i degjeneruari i zbulon të metat dhe shëmtton.

Imam shafiu, rahimehull-llah, ka thënë: Kush e këshillon vëllain e tij fshehurazi ai vërtetë e ka këshilluar dhe zbuluar e ai që bën këtë haptazi ai në realitet ia ka zbuluar të metat dhe e ka shëmtuar.

Imam Muslimi transmeton se Xheriri, radijall-llahu anhu, urdhëroi shërbëtorin e tij që t'ia blej një at. Ai ia bleu për 300 dirhem. Erdhi shërbëtori së bashku me blerësin e atit te Xheriri për t'i marrë të hollat prej tij. Xheriri i tha pronarit të atit: ati yt është më i mirë se 300 dirhem a mund që të ma shesësh për 400? Pronari i tha: Këtë ti e vendos. Pastaj i tha përsëri: Ati yt është më i mirë se 400 dirhem a mund që të ma shesësh për 500, dhe vazhdoi kështu deri sa ia ofroi 800 dirhem dhe e bleu me këtë shumë. Më pas u pyet për këtë e ai tha: Unë i kam dhënë besën Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, se do të këshilloj çdo musliman.

Gjithashtu Xheriri i thoshte shokut të tij: Dije se atë që e marr prej teje është më e mirë se ajo që ta jap unë, prandaj zgjedh!

**Ahmed Muadh Hakkij**

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: Katërdhjet hadithe mbi moralin, NuN, Shkup, 2005)